



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

---

# RAPORTI I GJELBËR 2017



Dhjetor, 2017

# Raporti i Gjellbër i Kosovës 2017

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë 2017

## Fjala hyrëse

Bujqësia dhe zhvillimi rural janë ndër sektorët më të rëndësishëm, që kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë. Këta sektorë sjellin mundësi të mëdha për Kosovën dhe qytetarët e saj që të zbusin varfërinë duke krijuar vende të reja të punës dhe mjedis të favorshëm për të gjithë qytetarët e veçmas për ata që jetojnë në zonat rurale.

Përmes strategjive dhe politikave zhvillimore, ne si Ministri jemi të përqëndruar që të inkurajojmë prodhimtarinë bujqësore, të nxisim fermerët dhe të krijojmë mundësi të reja për ta. Përveç kësaj, këto strategji dhe politika do të ndihmojnë në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve tona natyrore.

Ky është edicioni i 5<sup>të</sup> i Raportit të Gjelbër, i publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i cili tregon situatën aktuale të bujqësisë në Republikën e Kosovës. Unë jam shumë i lumtur, të njoftoj për publikimin e këtij raporti i cili thekson progresin e bërë në sektorin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Megjithatë, përpara na presin shumë sfida që i kemi paraqitur në këtë raport, që së bashku me ekspertët, partnerët dhe investitorët tanë përmes një strategjie gjithëpërfshirëse, do të mundohemi që të zbusim këto sfida dhe të arrimë rezultate pozitive.

Unë personalisht çmoj përpjekjen e çdo individi që ka marr pjesë në procesin e mbledhjes, përditësimit dhe analizës së këtij raporti, duke sjellë kështu një dokument me vlerë si Raporti i Gjelbër. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të bujqësisë dhe të bëjmë përpjekje që ky sektor të jetë më i suksesshmi drejt zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Nenad Rikalo



Ministër

# Hyrja

Raporti i Gjelbër është publikim vjetor i cili paraqet një vështrim të detajuar dhe gjithëpërfshirës në sektorin e bujqësisë. Është me rëndësi të ceket se ky raport, shërben si udhëzues i strategjisë zhvillimore dhe politikave të sektorit tonë. Veç kësaj, rezultatet e këtij raporti na ndihmojnë të bëjmë ndryshime në lidhje me investimet dhe bujqësinë në tërësi.

Ky është edicioni i 5<sup>të</sup> i Raportit të Gjelbër, i cili është përgatitur falë bashkëpunimit të ndërmjetëm në mes departamenteve dhe agjencive të MBPZHR-së, si dhe organizatave të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare. Gjithashtu, edhe Komitetit Drejtues luan një rol të rëndësishëm dhe siguron se ky publikim është gjithëpërfshirës dhe i paanshëm, po ashtu ndihmon edhe në ndarjen e përgjegjësive në krijimin e këtij raporti dhe në angazhimet e departamenteve dhe agjencive tona.

Raporti është punuar nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore përbërë nga (Skender Bajrami, Belgin Dabiqaj, Shkëlqim Duraku, Delvina Hana, Adelina Maksuti, Edona Mekuli, Shqipe Tërshnjaku dhe Hakile Xhaferi,) koordinuar nga drejtori i departamentit Ekrem Gjokaj dhe mbështetur nga Sekretari i Përgjithshëm Kapllan Halimi. Veçmas, shfrytëzojmë rastin të vlerësojmë të gjithë ata që kontribuan dhe na mbështetën, duke shkëmbyer informacione me vlerë për finalizimin e Raportit të Gjelbër 2017.

Raporti i Gjelbër synon që çdo vit raportojë, përmirësime të dukshme që janë bërë në prodhimtarinë dhe praktikën e prodhimit, shumëllojshmërinë e produkteve dhe sfera të tjera relevante. Është e rëndësishme për ne, që të sjellim rezultate pozitive në lidhje me nivelin e konsumit të produkteve vendore dhe eksportit, me fokus të veçantë në përforcimin e ekonomisë vendore, zbutjen e varfërisë, mirëqenjes sociale, punësimit, balanci tregtarë si dhe të kemi zhvillim të qëndrueshëm.

Ne do të punojmë vazhdimisht që të sjellim dhe përtërijmë informatat, me qëllim që ky publikim të jetë sa më i dobishëm për publikun. Gjithashtu inkurajojmë të gjithë ata që janë të përfshirë ose kanë për qëllim të marrin pjesë në sektorin e bujqësisë.

Ekrem Gjokaj, PhD, Editor



Drejtor i Departamentit për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore

# Tabela e përmbajtjes

Fjala hyrëse.....	2
Hyrja .....	3
Tabela e përmbajtjes.....	4
Lista e tabelave.....	7
Lista e figurave.....	11
Lista e shkurtesave.....	14
<b>1 Burimet dhe inputet .....</b>	<b>16</b>
1.1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik .....	16
1.1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik.....	20
1.1.2 Puna dhe punësimi.....	22
Përdorimi i tokës.....	23
1.2 Llogaritë ekonomike dhe çmimet e inputeve në bujqësi.....	26
1.3 Struktura e fermës .....	31
1.4 Bizneset bujqësore-Agroindustria .....	34
<b>2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij .....</b>	<b>43</b>
2.1 BPV në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë.....	43
2.2 Drithërat.....	46
2.3 Perimet .....	48
2.4 Pemët dhe oreshat.....	53
2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra .....	63
2.6 Kulturat industriale.....	64
2.7 Materiali fidanor.....	65
2.8 Ujitja e tokës bujqësore .....	66
2.9 Gjedhët.....	67
2.10 Dhentë dhe dhitë.....	70
2.11 Derrat dhe kafshët tjera të fermës .....	71
2.12 Shpeztaria .....	72

2.13	<i>Bletaria</i> .....	73
<b>3</b>	<b>Pylltaria</b> .....	<b>74</b>
<b>4</b>	<b>Konsumi, tregtia dhe çmimet e tregut</b> .....	<b>81</b>
4.1	<i>Trendet e konsumit</i> .....	81
4.2	<i>Tregtia</i> .....	84
4.2.1	Tregtia me vendet e CEFTA-s .....	89
4.2.2	Tregtia me vendet e BE-së .....	94
4.2.3	Tregtia me vendet e tjera .....	98
4.2.4	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve(1-24) .....	100
4.2.5	Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24) .....	103
4.3	<i>Çmimet në zinxhirin e vlerës</i> .....	105
4.4	<i>Siguria dhe cilësia e ushqimit</i> .....	109
4.4.1	Siguria e ushqimit .....	109
4.4.2	Analizat e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve .....	112
4.4.3	Legjislacione për veterinën dhe funksionimin e tregut .....	118
4.5	<i>Emetimi i gazrave serrë në Kosovë</i> .....	119
4.5.1	Emetimet nga sektori i bujqësisë .....	119
<b>5</b>	<b>Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural</b> .....	<b>125</b>
5.1	<i>Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve</i> .....	125
5.2	<i>Pagesat direkte/subvencionet</i> .....	130
5.2.1	Pagesat direkte për kulturat bujqësore .....	130
5.2.2	Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht .....	141
5.2.3	Mbështetja e inputeve në bujqësi .....	152
5.3	<i>Sigurimet në fushën e bujqësisë</i> .....	158
5.4	<i>Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive</i> .....	161
5.4.1	Ristrukturimi i potencialit fizik .....	164
5.4.2	Zhvillimi i sektorit të përpunimit .....	167
5.5	<i>Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve</i> .....	169
5.5.1	Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor .....	169
5.5.2	Grupet lokale të veprimit .....	172
5.5.3	Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor .....	173
5.5.4	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve .....	174
5.5.5	Ujitja e tokave bujqësore .....	175

5.6	<i>Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare .....</i>	176
<b>6</b>	<b>Shtojcat .....</b>	<b>180</b>
6.1	<i>Lista e ligjeve dhe akteve ligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural .....</i>	180
6.1.1	<i>Legjislacioni kombëtar në fuqi .....</i>	180
6.1.2	<i>Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2016 .....</i>	180
6.2	<i>Statistikat mbi çmimet .....</i>	182
6.3	<i>Statistikat krahasuese .....</i>	184

## Lista e tabelave

Tabela 1:	Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale (në '000 €) .....	17
Tabela 2:	Bruto produkti vendor me çmime aktuale 2010-2016, (në mil €) .....	18
Tabela 3:	Bilanci i pagesave (jo kumulative), në mil. €.....	19
Tabela 4:	Indikatorët kryesorë të tregut të punës sipas variablave, viti dhe gjinia .....	22
Tabela 5:	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2016, (ha) .....	24
Tabela 6:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2010-2016, (2010=100) .....	30
Tabela 7:	Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2016.....	31
Tabela 8:	Madhësia e fermave sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2014/2016.....	33
Tabela 9:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike.....	35
Tabela 10:	Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2011-2016 .....	36
Tabela 11:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari, 2016 .....	39
Tabela 12:	Llogaritë ekonomike për bujqësi me çmime aktuale, në mil. € .....	45
Tabela 13:	Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave, 2010-2016 .....	46
Tabela 14:	Bilanci i furnizimit për grurin, 2010-2016.....	47
Tabela 15:	Bilanci i furnizimit për misrin, 2010-2016.....	48
Tabela 16:	Sipërfaqja me perime, 2010 - 2016 .....	49
Tabela 17:	Prodhimtaria e perimeve, 2010 - 2016.....	50
Tabela 18:	Bilanci i furnizimit për domaten, 2010-2016 .....	51
Tabela 19:	Bilanci i furnizimit për specin, 2010-2016.....	52
Tabela 20:	Bilanci i furnizimit për pataten, 2010-2016.....	53
Tabela 21:	Sipërfaqja me pemë, 2010 - 2016.....	54
Tabela 22:	Prodhimtaria me pemë, 2010 - 2016 .....	55
Tabela 23:	Bilanci i furnizimit për mollën, 2010-2016.....	56
Tabela 24:	Bilanci i furnizimit për kumbullën, 2010-2016.....	57
Tabela 25:	Bilanci i furnizimit për dredhëzën, 2010-2016 .....	58
Tabela 26:	Bilanci i furnizimit për rrush tryeze, 2010-2016.....	59
Tabela 27:	Varietetet e rrushit të tryezës 2016 .....	60
Tabela 28:	Varietetet e rrushit të verës 2016 .....	61
Tabela 29:	Prodhimi i verës 2011-2016 .....	61
Tabela 30:	Prodhimi i verës sipas kompanive në vitin 2016.....	62
Tabela 31:	Analizat fiziko - kimike të verës për vitet 2013 - 2016.....	63
Tabela 32:	Sipërfaqja, prodhimtaria, rendimenti i kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra, 2010-2016 .....	64
Tabela 33:	Sipërfaqja dhe prodhimtaria e kulturave industriale, 2015-2016 .....	64
Tabela 34:	Prodhimi i fidanëve të pemëve me nënshartesa gjenerative dhe vegetative për vitet 2006-2016.....	66
Tabela 35:	Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2016 .....	67
Tabela 36:	Fondi dhe struktura e gjedhëve, 2010-2016.....	68



Tabela 37:	Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2010-2016.....	69
Tabela 38:	Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2010-2016.....	70
Tabela 39:	Numri i dheneve dhe dhive, 2010-2016.....	71
Tabela 40:	Bilanci i furnizimit për mishin e dheneve dhe dhive, 2010-2015.....	71
Tabela 41:	Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2010-2016.....	72
Tabela 42:	Numri i shpezëve dhe vezëve 2010-2016, në 1000 krerë.....	73
Tabela 43:	Numri i koshereve të bletëve, 2010-2016.....	73
Tabela 44:	Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit (ha).....	74
Tabela 45:	Planet menaxhuese 2016.....	75
Tabela 46:	Plani i shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore 2016 në m <sup>3</sup> .....	75
Tabela 47:	Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore 2016 në m <sup>3</sup> .....	75
Tabela 48:	Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore 2016 sipas DK.....	76
Tabela 49:	Plani i shfrytëzimit të pyjeve në pronën private 2016 në m <sup>3</sup> .....	76
Tabela 50:	Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve në pronën private 2016.....	77
Tabela 51:	Kallëzimet apo fletëparaqitjet e ngritura për Janar - Dhjetor 2016.....	77
Tabela 52:	Paraqitja e materialit drunorë të konfiskuar nga prerësit e paligjshëm.....	78
Tabela 53:	Paraqitja e rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqet pyjore të përfshira në vitin 2016.....	78
Tabela 54:	Mirëmbajtja e pyllëzimeve 2016.....	79
Tabela 55:	Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2009-2016.....	81
Tabela 56:	Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit, 2009 – 2016 në( % ).....	82
Tabela 57:	Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë, 2009– 2016 (%).....	82
Tabela 58:	Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë në %.....	83
Tabela 59:	Shtëpitë/Banesat nën hipotekë në vitin 2014-2016,në %.....	84
Tabela 60:	Eksporti/Importi i përgjithshëm, në 1000 €.....	85
Tabela 61:	Pjesëmarrja e Eksportit-Importit të produkteve bujqësore, në 1000 €.....	86
Tabela 62:	Eksport-Importi i produkteve bujqësore (1-24), në 1000€.....	88
Tabela 63:	Eksport-Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në 1000€.....	89
Tabela 64:	Eksporti i prodhimeve bujqësore në vendet CEFTA-s, në1000 €.....	92
Tabela 65:	Importi i prodhimeve bujqësore nga vendet CEFTA-s, në1000 €.....	93
Tabela 66:	Pjesëmarrja e vendeve të CEFTA-s në Eksport/Import(%) në 2016, në 1000 €.....	94
Tabela 67:	Eksporti-Importi i prodhimeve bujqësore me vendet e BE-së, në 1000 €.....	95
Tabela 68:	Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e BE-së, në 1000 €.....	96
Tabela 69:	Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së, në 1000 €.....	97
Tabela 70:	Shkëmbimi tregtar i Kosovës në vitin 2016.....	98
Tabela 71:	Eksporti i produkteve bujqësore 2010-2016, në 1000 €.....	102
Tabela 72:	Importi i produkteve bujqësore 2010-2016, në 1000 €.....	104
Tabela 73:	Çmimet mesatare vjetore të disa prodhimeve bujqësore 2010-2016 (€/kg).....	106
Tabela 74:	Vlerat e njësisive të importit të disa prodhimeve bujqësore 2010-2016 (€/kg).....	106
Tabela 75:	Çmimet mesatare vjetore të shitjes me shumicë (€/kg).....	107

Tabela 76:	Çmimet mesatare vjetore të shitjes me pakicë (€/kg).....	108
Tabela 77:	Krahasimi i çmimeve të disa prodhimeve në Kosovë me disa vende të BE-së, 2016 (€/kg) .....	108
Tabela 78:	Llojet e analizave të kryera në laboratorët e IBK-së për vitet 2015/2016 .....	112
Tabela 79:	Marrja e mostrave në sektorë për vitet 2015/2016 .....	113
Tabela 80:	Analizat e egzaminimit të mostrave për vitin 2016 .....	113
Tabela 81:	Analizat e kryera për sektorin e bakteriologjisë për vitin 2016 .....	114
Tabela 82:	Mostrat e arritura për vitet 2015/2016.....	116
Tabela 83:	Mostrat e testuara për vitet 2015/2016 .....	116
Tabela 84:	Analizat e qumështit në bazë të aparaturave për vitet 2015/2016.....	116
Tabela 85:	Pagesat direkte 2012-2016.....	128
Tabela 86:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2012-2016 .....	131
Tabela 87:	Pagesat direkte për grurë sipas regjionit, në vitin 2016.....	132
Tabela 88:	Pagesa direkte për farë gruri sipas regjionit, në vitin 2016 .....	133
Tabela 89:	Pagesa direkte për misër sipas regjionit, në vitin 2016.....	134
Tabela 90:	Pagesa direkte për elb sipas regjionit, në vitin 2016 .....	135
Tabela 91:	Pagesa direkte për thekër sipas regjionit, në vitin 2016.....	136
Tabela 92:	Pagesa direkte për vreshta sipas regjionit, në vitin 2016.....	137
Tabela 93:	Pagesat direkte për luledielli sipas regjionit, në vitin 2016 .....	138
Tabela 94:	Pagesat direkte për perime në fushë të hapur sipas regjionit, në vitin 2016.....	139
Tabela 95:	Pagesat direkte për pemishte ekzistuese sipas regjionit, në vitin 2016 .....	140
Tabela 96:	Pagesat direkte për bujqësi organike sipas regjionit, në vitin 2016.....	141
Tabela 97:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2012-2016 .....	142
Tabela 98:	Pagesat direkte për lopë qumështore sipas regjionit, në vitin 2016 .....	143
Tabela 99:	Pagesat direkte për dele sipas regjionit, në vitin 2016 .....	144
Tabela 100:	Pagesat direkte për dhi sipas regjionit, në vitin 2016.....	145
Tabela 101:	Pagesat direkte për dosa sipas regjionit, në vitin 2016 .....	146
Tabela 102:	Pagesat direkte për bletë sipas regjionit, në vitin 2016 .....	147
Tabela 103:	Pagesat direkte për pula vojse sipas regjionit, në vitin 2016.....	148
Tabela 104:	Pagesat direkte për thëllëza sipas regjionit, në vitin 2016 .....	149
Tabela 105:	Pagesat direkte për qumësht sipas cilësisë në regjione, në vitin 2016 .....	150
Tabela 106:	Pagesa direkte për therje të raportuara të gjedhit në vitin 2016 .....	151
Tabela 107:	Pagesat direkte për fidane sipas regjionit, në vitin 2016 .....	152
Tabela 108:	Agrokreditë 2010-2016 .....	154
Tabela 109:	Identifikimi i dëmeve në bujqësi sipas viteve:.....	160
Tabela 110:	Buxheti i paraparë i PZHR për vitin 2016.....	162
Tabela 111:	Numri i aplikacioneve dhe vlera e miratuar në €, PZHR për vitin 2016 .....	163
Tabela 112:	Tabela krahasuese mbi vlerën e aplikuar për vitet 2012-2016 .....	164
Tabela 113:	Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për masën 101 .....	167
Tabela 114:	Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për masën 103 .....	169

Tabela 115:	Numri i pjesëmarrësve në trajnime .....	170
Tabela 116:	Numri i fermerve të trajnuar sipas gjinisë.....	171
Tabela 117:	Fondet e planifikuara për zbatimin e nën masave për vitin 2016 .....	172
Tabela 118:	Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për masën 302 .....	175
Tabela 119:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2010, €/kg.....	182
Tabela 120:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2011, €/kg.....	182
Tabela 121:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2012, €/kg.....	182
Tabela 122:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2013, €/kg.....	183
Tabela 123:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2014, €/kg.....	183
Tabela 124:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2015, €/kg.....	183
Tabela 125:	Çmimet në zinxhirin e vlerës 2016, €/kg.....	184
Tabela 126:	Popullsia në vendet kandidatë dhe ato kandidatë potenciale sipas viteve .....	184
Tabela 127:	Numri i vizitorëve të jashtëm në regjionet e Kosovës sipas regjionet .....	184

## Lista e figurave

Figura 1:	Indikatorët kryesorë të tregut të punës sipas variablave, gjithsej (%).....	23
Figura 2:	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, 2016 (ha) .....	25
Figura 3:	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, 2016 (%) .....	26
Figura 4:	Konsumi i ndërmjetëm, prodhimi i industrisë bujqësore dhe vlera e shtuar bruto, në mil. € .....	27
Figura 5:	Konsumi i ndërmjetëm i bujqësisë në vitin 2016 (%) .....	27
Figura 6:	Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2016.....	28
Figura 7:	Numri i ekonomive bujqësore sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2016.....	32
Figura 8:	Madhësia e fermave sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2014/2016.....	33
Figura 9:	Numri i ekonomive sipas madhësisë së sipërfaqes së tokës së punueshme 2014/2016 .....	34
Figura 10:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike.....	35
Figura 11:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari (%), ndaj aktiviteteve tjera ekonomike, në vitin 2016.....	36
Figura 12:	Qarkullimi monetar i ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari, 2011-2016 .....	37
Figura 13:	Numri i të punësuarve në agro biznese për vitet 2011-2016.....	37
Figura 14:	Numri i bizneseve aktive per vitet, 2011-2016.....	38
Figura 15:	Numri i të punësuarve në vitin 2016.....	39
Figura 16:	Numri i bizneseve aktive në vitin 2016 .....	40
Figura 17:	Pjesëmarrja e qarkullimit të bizneseve sipas regjioneve, 2016(%).....	41
Figura 18:	Numri i të punësuarve në bazë të regjioneve, 2016 (%) .....	41
Figura 19:	Numri i aktiviteteve të regjistruara në regjione , 2016 (%).....	42
Figura 20:	Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës) .....	74
Figura 21:	Pronësia në vitin 2014 -2016, sipas gjinisë,në %.....	84
Figura 22:	Eksporti/Importi i përgjithshëm, në 1000 €.....	86
Figura 23:	Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm, në 1000 €.....	87
Figura 24:	Pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm, në 1000 €.....	87
Figura 25:	Eksport-Importi i produkteve bujqësore (1-24) në, 1000€.....	88
Figura 26:	Shkëmbimi tregtar me vendet e CEFTA-s, në 1000 €.....	90
Figura 27:	Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, në 1000 € .....	90
Figura 28:	Importi i produkteve bujqësore nga vendet e CEFTA-s, në 1000 €.....	91
Figura 29:	Eksporti i prodhimeve bujqësore në vendet CEFTA-s, në 1000 € .....	92
Figura 30:	Importi i prodhimeve bujqësore nga vendet CEFTA-s, në 1000 € .....	93
Figura 31:	Eksporti-Importi i prodhimeve bujqësore me vendet e BE-së, në 1000 €.....	95
Figura 32:	Shpërndarja e eksportit brenda vendeve të BE-së në vitin 2016.....	96
Figura 33:	Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së, në vitin 2016, 2015, në 1000 €.....	97
Figura 34:	Shpërndarja e importit brenda vendeve të BE-së në vitin 2016 (%).....	98
Figura 35:	Shkëmbimi tregtar i Kosovës në vitin 2016.....	99

Figura 36:	Eksporti i produkteve bujqësore(1-24) për vitin 2016 (%).....	99
Figura 37:	Importi i produkteve bujqësore (1-24) për vitin 2016(%).....	100
Figura 38:	Eksporti i produkteve bujqësore për vitin 2016, në 1000 €.....	100
Figura 39:	Produktet më shumë të eksportuara për vitin 2016 (1000€).....	102
Figura 40:	Importi i produkteve bujqësore për vitin 2016, në 1000 €.....	103
Figura 41:	Produktet më shumë të importuara për vitin 2016 (000 €).....	105
Figura 42:	Plani i survejancës aktive për vitin 2016.....	115
Figura 43:	Testet për vitet 2015/2016, në baza mujore.....	115
Figura 44:	Burimet kryesore të emetimeve të GS në sektorin e bujqësisë (%).....	120
Figura 45:	Temperaturat mesatare vjetore në Prishtinë, 2002-2016.....	123
Figura 46:	Të reshurat në Prishtinë (mm), 2002-2016.....	123
Figura 47:	Numri mesatar i ditëve me shi dhe borë në Prishtinë, 2002-2016.....	124
Figura 48:	Pagesat direkte 2012-2016, në 1000 €.....	128
Figura 49:	Pagesat direkte sipas sektorëve 2012-2016, në mil. €.....	129
Figura 50:	Pagesa direkte për grurë 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar për grurë sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	132
Figura 51:	Pagesat direkte për farë gruri 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar për farë gruri sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	133
Figura 52:	Pagesat direkte për misër 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me misër sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	134
Figura 53:	Sipërfaqja e subvencionuar me elb sipas regjionit, në vitin 2016.....	135
Figura 54:	Sipërfaqja e subvencionuar me thekër sipas regjionit, në vitin 2016.....	136
Figura 55:	Pagesat direkte për vreshta 2013-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me vreshta sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	137
Figura 56:	Pagesat direkte për luledielli 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me luledielli sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	138
Figura 57:	Pagesa direkte për perime në fushë të hapur 2014-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me perime në fushë të hapur sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	139
Figura 58:	Pagesa direkte për pemishte ekzistuese 2015-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me pemishte ekzistuese sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	140
Figura 59:	Sipërfaqja e subvencionuar me kultura organike sipas regjionit, në vitin 2016.....	141
Figura 60:	Pagesat direkte për lopë qumështore 2012-2016, në 1000 € (majtas); Numri i lopëve qumështore të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	143
Figura 61:	Pagesat direkte për dele dhe dhi 2012-2016, në 1000 €.....	144
Figura 62:	Numri i deleve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (majtas); Numri i dhive të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	145
Figura 63:	Pagesat direkte për dosa 2014-2016, në 1000 € (majtas); Numri i dosave të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	146

Figura 64:	Pagesat direkte për bletë 2012-2016, në 1000 € (majtas); Numri i koshereve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas) .....	147
Figura 65:	Pagesat direkte për pula vojse 2013-2016, në 1000 € (majtas); Numri i pulave vojse të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas).....	148
Figura 66:	Numri i thëllëzave të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 .....	149
Figura 67:	Pagesat direkte për qumësht sipas cilësisë 2014-2016, në 1000 € (majtas); Numri i fermerëve përfitues për qumësht sipas cilësisë sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas) .....	150
Figura 68:	Pagesat direkte për fidanë 2013-2016, në 1000 € (majtas); Numri i fidanëve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas) .....	152
Figura 69:	Norma e interesit në Kredi Bujqësore, %.....	153
Figura 70:	Shuma totale e kredive të disbursuara (mil. €).....	155
Figura 71:	Numri i kredive të disbursuara .....	155
Figura 72:	Dëmet në bujqësi .....	160

## Lista e shkurtesave

ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ADA	Agjencia për Zhvillim e Austrisë
AFK	Agjencioni për Financim në Kosovë
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
AM	Autoriteti Menaxhues
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
APR	Aftësit për Zhvillim Rural
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
AUV	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë
AZHB	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
BE	Bashkimi Evropian
BPB	Banka për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BVSH	Bruto Vlera e Shtuar
CEFTA	Marrëveshja për tregti të lirë me vendet e Evropës Qendrore
CIHEAM	Instituti Agroekonomik Mesdhetar i Barit
COSIRA	Konkurrueshmëria e Sektorit Privat në Zonat Rurale
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
DCA	Development Credit Authority, Autoriteti për Zhvillim të Kredisë
DK	Drejtoritë Komunale
DMKE	Drejtoria për menaxhimin me kafshët e egra dhe Ekotorizmi
DPBT	Departamenti i Politika Bujqësore dhe Tregjeve
DPZHR	Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural
DSHKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike
DTU	Departamenti i Teknologjisë Ushqimore
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara)
FBV	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
FINCA	Foundation for International Community Assistance
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GLV	Grupe Lokale të Veprimit
GS	Gazra serrë
ha	hektar
HACCP	Hazard Analysis and Critical Point (Analiza e Rrezikut dhe Kontrollimi i Pikave Kritike)
IBK	Instituti bujqësor i Kosovës

IJPSHESH	Institucionet Jopërfituese në Shërbim të Ekonomive Shtëpiake
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
INP	Inventarizimi nacional i pyjeve
ISO	International Organisation for Standardisation
KE	Komisioni Evripian
KEP Trust	Kosovo Enterprise Program
KGMAMF	Kosovo Grameen Missione Arcobaleno Microcredit Fund
KRK	Kreditimi Rural i Kosovës
LUV	Laboratori i Ushqimit dhe Veterinës
LLEB	Llogaritë Ekonomike për Bujqësi
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural
mil.	milion
MMPH	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizata jo qeveritare
p.th.	peshë e therur
PCB	Procredit Bank
PIK	Pikat e Inspektimit Kufitar
PZhR	Plani i Zhvillimit Rural
QKI	Qendra Këshilluese Informative
RRZHRK	Rrjet për Zhvillim Rural të Kosovës
SMC	Spektori i Serologjisë Molekulare
SZHL	Strategjia Zhvillimore Lokale
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
t	tonë
TEB	Turk Ekonomi Bankasi
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNFCCC	Konventa e Kornizës për Ndryshim Klimatik
USAID	United states Agency for International Development



# 1 Burimet dhe inputet

## 1.1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për Bruto Produktin Vendor, rezulton se ekonomia e Kosovës shënoi rritje reale për 4.1%, në vitin 2016, duke marrë për bazë kontributin pozitiv si të konsumit poashtu edhe të investimeve.

Faktor tjetër me rëndësi mund të përmendim përshejtimin e rritjes së aktivitetit të kredidhënies të sektorit bankar që kishte ndikim të rëndësishëm në financimin e rritjes së aktivitetit të sektorit privat. Në anën tjetër, bilanci tregtar negativ vazhdon të jetë faktori kryesor që po e pengon arritjen e një norme më të lartë të rritjes ekonomike. Ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2016, vazhdoi të karakterizohet me stabilitet makroekonomik. Shkalla e inflacionit, ashtu si në ekonominë e eurozonës dhe në ekonomitë e rajonit, qëndroi në nivel mjaft të ulët.

Sistemi financiar vazhdoi të zgjerojë aktivitetin, duke i ofruar kështu ekonomisë së vendit një ofertë më të pasur të produkteve financiare. Aktiviteti ndërmjetësues financiar i sektorit bankar ka vazhduar të ketë rritje të qëndrueshme, duke shërbyer kështu si mbështetës i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit privat. Viti 2016, shënoi përshejtim të kreditimit si për sektorin e ndërmarrjeve ashtu edhe për atë të ekonomive familjare. Norma më e lartë e rritjes së kredive u evidentua tek kreditë për ekonomitë familjare, qasja e të cilave në financimin bankar po rritet nga viti në vit. Normat e interesit në kreditë bankare në Kosovë vazhduan të zvogëlohen edhe gjatë vitit 2016, duke u shoqëruar me lehtësime edhe në aspektet tjera të qasjes në kredi.

Aktiviteti ekonomik global është rikuperuar gjatë vitit 2016, megjithëse me diferenca të dukshme në mes të rajoneve. Rritja vjetore e BPV-së në Eurozonë në vitin 2016 ishte 1.8%<sup>1</sup>. Gjatë vitit 2016, rritja ekonomike në Eurozonë u mbështet kryesisht nga kërkesat e brendshme.

Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës dhe çmimet e ulëta të naftës kanë ndikuar në rritje të të ardhurave, duke ndikuar kështu edhe në rritjen e konsumit të brendshëm. Rritja ekonomike në Eurozonë u mbështet kryesisht nga ekonomitë qendrore të Eurozonës si Gjermania (1.9%), Franca (1.2%), Austria (1.5%), Spanja (3.2%) dhe Italia (0.9%).

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të përforcohet. Rritja kërkesës në Eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve në disa vende të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve të huaja dhe konsumit të brendshëm, paraqiten si kontribues të rëndësishëm në rritjen mesatare prej rreth 3.0 % të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në vitin 2016.

---

<sup>1</sup> BQK, Raporti Vjetor 2016, Qershor 2017

Në tabelën në vijim janë prezantuar të dhënat në formë tabelare për bruto produktin vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2010-2016.

**Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale (në '000 €)**

Aktivitetet ekonomike	Bruto Vlera e Shtuar (BVSH)						
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	598,838	614,262	617,588	638,710	661,820	599,608	635,044
B Industria nxjerrëse	136,399	124,087	114,049	118,288	116,411	118,447	126,698
C Industria përpunuese	489,304	493,945	549,265	584,764	575,830	625,841	665,852
D Furnizimi me energji elektrike, me gaz	108,249	123,450	128,280	144,870	156,739	191,221	211,821
E Furnizimi me ujë	29,936	34,287	36,620	52,059	47,078	48,344	44,870
F Ndërtimtaria	283,165	361,886	341,199	352,185	335,153	397,314	395,438
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	538,761	535,207	611,578	655,390	688,580	712,234	746,731
H Transporti dhe magazinimi	171,433	186,582	187,695	233,714	197,360	209,275	220,501
I Hotelet dhe restorantet	27,477	34,843	39,082	49,795	52,093	60,094	71,861
J Informimi dhe komunikimi	34,547	42,113	54,359	53,279	109,251	108,965	111,556
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	151,483	173,521	192,621	213,264	221,158	212,086	175,836
L Afarizmi me pasuri të patundshme	417,021	416,862	437,190	475,530	499,116	499,305	483,836
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	51,586	62,086	72,106	74,587	76,593	90,861	93,868
N Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	12,114	19,635	22,422	21,577	34,082	33,859	37,189
O Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	434,705	476,976	497,788	495,527	499,169	454,493	465,893
P Edukimi	122,292	154,861	162,005	164,556	217,134	234,071	242,634
Q Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	57,919	67,380	72,006	75,251	97,600	107,790	112,584
R Art, zbavitje dhe rekreacion	11,333	15,394	20,262	23,754	22,932	23,653	24,955
S Shërbime tjera	10,550	7,484	10,898	8,409	9,353	12,744	12,871
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbimet e padiferencuara që prodhojnë aktivitetet e familjeve për përdorim vetanak	5	5	1	-	-	-	-
<b>BVSH me çmime bazë</b>	<b>3,687,117</b>	<b>3,944,864</b>	<b>4,167,016</b>	<b>4,435,509</b>	<b>4,617,451</b>	<b>4,740,205</b>	<b>4,880,038</b>
Tatimet në produkte	795,524	949,831	973,592	978,075	971,540	1,097,282	1,220,098
Subvencionet në produkte	-80,677	-80,159	-81,844	-86,967	-21,497	-30,479	-30,023
<b>Bruto Produkti Vendor</b>	<b>4,401,964</b>	<b>4,814,535</b>	<b>5,058,763</b>	<b>5,326,617</b>	<b>5,567,494</b>	<b>5,807,009</b>	<b>6,070,113</b>

Burimi: ASK, Bruto Produkti Vendor 2010-2016

Bazuar në statistikat e paraqitura në tabelën më lartë, vërejmë se BPV me çmime aktuale në vitin 2016 ishte 6,070 mil. €, ndërsa rritja reale në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015, ishte 4.1%.

Bruto Produkti Vendor për kokë banori për vitin 2016 ishte 3,386 €. Marrë në përgjithësi rritje reale për vitin 2016, kishte në këto aktivitete ekonomike:

Ndërtimtaria 4.47%; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 4.39%; Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave 4.38%, Transporti dhe magazinimi 4.30%,

Furnizimi me energji elektrike, me gaz 4.12%, si dhe Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi që kishte rritje për 3.08% etj.

Ndërsa rënie kishin këto aktivitete: Furnizimi me ujë 7.59%, dhe Industria nxjerrëse 3.55%.

Rritja reale sipas komponentëve kryesore të BPV-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2016 ishte siç vijon:

Rritja reale sipas komponentëve të BPV-së, me qasje në shpenzime: shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH shënuan rritje për 21.9%, Ndryshimet në inventar 10.5%, Importi i mallrave (FOB) 8.6%, Formimi i bruto kapitalit fiks 7.3%, Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake 6.6% dhe Eksporti i shërbimeve 4.7%.

Ndërsa me rënie u karakterizuan këto aktivitete: Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë 6.3%, Eksporti i mallrave 4.5%, e poashtu edhe Importi i shërbimeve që kishte rënie për 4.3%.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat për bruto produktin vendor me qasjen e shpenzimeve 2010-2016.

**Tabela 2: Bruto produkti vendor me çmime aktuale 2010-2016, (në mil €)**

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
BPV me çmime aktuale	4,402	4,815	5,059	5,327	5,568	5,808	6,070
Shpenzimet e konsumit final	4,517	4,976	5,320	5,539	5,731	5,859	6,146
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	3,768	4,003	4,282	4,446	4,802	4,943	5,268
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	722	802	842	864	910	894	854
Qeveria e Kosovës	496	578	625	659	724	772	730
Donatorët (pagat)	227	224	217	205	187	122	124
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	26	31	20	23	19	22	24
Formimi i bruto kapitalit	1,451	1,632	1,465	1,471	1,435	1,601	1,650
Formimi i bruto kapitalit fiks	1,301	1,476	1,317	1,323	1,294	1,499	1,550
Ndryshimet në inventar	149	157	148	148	141	102	100
Eksporti neto	-1,565	-1,793	-1,727	-1,684	-1,599	-1,652	-1,726
Importi i mallrave dhe i shërbimeve	2,443	2,737	2,649	2,611	2,852	2,926	3,072
BPV për kokë banori (Euro)	2,480	2,672	2,799	2,935	3,084	3,277	3,386

Burimi: ASK, Bruto Produkti Vendor 2010-2016

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, është karakterizuar me rritje mesatare prej 0.3% në vitin 2016. Me rënie prej 0.1% u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9% të shportës së konsumatorit kosovar.

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> në vitin 2016, arritën vlerën neto prej 1.60 miliardë €, që paraqet një rritje vjetore rreth 9.6%<sup>3</sup>. Shpenzimet buxhetore<sup>4</sup> arritën vlerën prej 1.66 miliardë €, që paraqet një rritje vjetore rreth 5.7%. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 61.1 milionë €, krahasuar me deficitin prej 111.4 milionë € në vitin 2015, përderisa si përqindje e BPV-së, deficitin primar ka shënuar rënie nga 1.9% në 1.0%. Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 7.4% në vitin 2016, si pasojë e rënies së eksporteve dhe rritjes së importeve. Eksporti i mallrave arriti vlerën prej 309.7 mil. €, që përkon me një rënie vjetore prej 4.8%. Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 565.0 mil.€, një rritje kundrejt vitit paraprak prej 23.6%. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 9.1%, duke arritur në 1,038.4 mil. €. Në anën tjetër, vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 4.3% dhe arriti në 473.4 mil. €.

**Tabela 3: Bilanci i pagesave (jo kumulative), në mil. €**

Përshkrimi	Llogaria rrjedhëse	Mallrat dhe shërbimet	Nga të cilat mallra	Të ardhurat	Transferet rrjedhëse	Llogaria e kapitalit dhe financiare	Nga i cili kapital	Gabimet neto dhe mosdeklarimet
2005	-228.7	-1,087.00	-1,078.50	139.1	700.3	72.7	18.9	174.8
2006	-205.2	-1,144.10	-1,173.10	158.8	759.2	-14.9	20.8	240.9
2007	-197.5	-1,242.40	-1,354.40	186.3	842.0	22.3	16.5	203.3
2008	-450.5	-1,498.10	-1,644.70	164	873.2	-277.9	10.5	162.1
2009	-273.9	-1,418.50	-1,646.30	60.9	983.4	-12.8	100.3	160.9
2010	-494.4	-1,565.20	-1,741.60	67.0	982.5	-254.5	21.3	218.5
2011	-616.4	-1,790.80	-2,047.10	111.3	1,021.10	-335.5	42	238.9
2012	-367.2	-1,726.30	-2,050.10	153.6	1,192.50	-128.1	12.9	226.2
2013	-304.7	-1,683.40	-1,995.60	121.5	1,222.40	-97.5	34.7	172.5
2014	-415.8	-1,722.70	-2,058.60	113.8	1,171.90	-123.8	21.2	270.8
2015	-515.3	-1,767.90	-2,109.30	92.6	1,149.30	-236	25.8	253.5
2016	-534.6	-1,725.80	-2,290.80	80.9	1,177.00	-106.1	14.2	-120.3

Burimi: BQK, Raporti Vjetor 2016

Gjatë vitit 2016, deficitin i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 534.6 mil. €, krahasuar me deficitin prej 471.4 mil. €, sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore ndërsa, bilancet pozitive të shërbimeve dhe llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan rritje.

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 565.0 mil. €, një rritje kundrejt vitit paraprak prej 23.6%. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 9.1%, duke arritur në 1,038.4 mil. €, kurse vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 4.3% dhe arriti në 473.4 mil. €. Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit dhe

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> BQK, Raporti Vjetor 2016, Qershor 2017

<sup>4</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

shërbimet e transportit u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.4 përkatësisht 6.6%, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe e telekomunikacionit shënoi rënie prej 11.6%. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e transportit shënuan rënie prej 15.1%, ndërsa shërbimet e udhëtimit shënuan rritje prej 4.2%. Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rënie prej 12.6%. Bilanci i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve u zvogëlua për 5.6%, ndërsa bilanci i të ardhurave të realizuara nga investimet u zvogëlua për 1.6%. Në vitin 2016, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 3.2%, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 691.0 mil. €, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8%.

### **1.1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik**

Bujqësia tradicionalisht ka luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës. Kontributi i sektorit bujqësor në BPB dhe punësim është i ngjashëm me vendet e rajonit por më i lartë se në vendet e OECD-së dhe BE-së. Sidoqoftë, me kalimin e viteve përqindja e kontributit të këtij sektori është në rënie e sipër.

Në vendin tonë sektori i ushqimit dhe i bujqësisë ka potencial të kontribuojë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, në reduktimin e varfërisë dhe në rritjen e sigurisë së ushqimit ku në vitin 2016 pati pjesëmarrje në BPV me 10.5% në bruto produktin e brendshëm. Pjesëmarrja e vlerës së eksportit të produkteve bujqësore në vlerën e përgjithshme të eksportit në vitin 2016, ishte 15%. Vlera totale e prodhimit bujqësorë duke përfshirë edhe shërbimet vlerësohet të jetë 736.8% mil. €, nga ku prodhimet bimore kanë pasur vlerën 412.3 mil. €, me pjesëmarrje prej 56%, prodhimet blegtorale 302.4 mil € ose 41% dhe shërbimet 22.1 mil. €, që kishin pjesëmarrje 3%. Për avancimin dhe përmirësimin e gjendjes, politikat bujqësore janë të orientuara për rritjen e produktivitetit të qëndrueshëm bujqësor, duke përfshirë politikat që ndikojnë në mjedisin e biznesit bujqësor dhe mënyrën e shfrytëzimit të pasurive natyrore për të mbështetur transformimin strukturor dhe inovacionin në bujqësi.

Për realizimin e aktiviteteve të parapara buxheti i ndarë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë çdo vit ka shënuar rritje. Kështu që për vitin 2016, MBPZHR ka pasur në dispozicion buxhetin në vlerë prej 55 mil. €. Ndarja buxhetore për masat e shtyllës së parë për vitin 2016 ishte 50%, nga buxheti total për grante dhe subvencione. Për zbatimin e këtyre aktiviteteve të parapara është hartuar Programi për Zhvillim Rural 2016, si program vjetor i mbështetjes së fermerëve dhe agro përpunuesve në vend. Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtij Programi ka qenë 23 mil. € dhe është shpërndarë në pesë masat kryesore: Masa për investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore; Masa për investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore; Masa për diversifikimin në fermë dhe zhvillimin e bizneseve; Masa për Grupet Lokale të Veprimit dhe Masa për ujitjen e tokave

bujqësore. Shuma e mjeteve që është ndarë në këtë drejtim ka bërë që të shtohet interesimi i fermerve për aplikim, me ç' rast ka pasur një shtim të konsiderueshëm të sipërfaqes me pemë, veçanërisht me fruta manore.

Në pjesën e bujqësisë është vazhduar edhe gjatë këtij viti me hartimin e Programit të Pagesave Direkte 2016, si program vjetor i mbështetjes së fermerëve. Këtë vit për herë të parë ka filluar mbështetja me pagesa direkte edhe për: elbin, thekrën, bujqësinë organike, akuakulturën, arrën, lajthinë, aroninë dhe është rritur shuma e subvencionimit për bletët. Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtij Programi ka qenë 23 mil. € dhe është shpërndarë në këta nën sektorë: drithëra, blegtori, hortikulturë. Numri i aplikimeve përfitues nga ky program për vitin 2016, është mbi 43,000 fermerë.

Si rezultat i investimeve të bëra në sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2016, përveç tjerash është rritur niveli i prodhimit të bujqësore dhe agro përpunuese në vend, është rritur sipërfaqja e punueshme e tokave bujqësore, janë hapur vende të reja të punës, është rritur dukshëm eksporti i produkteve bujqësore dhe në një masë është filluar me zëvendësimin e produkteve të importit nga produktet bujqësore të prodhuara në vend.

Përpyqje të mëdha janë bërë edhe në përgatitjen e institucioneve për akreditim për IPARD II. Në kuadër të përgatitjeve të procesit të akreditimit të institucioneve për IPARD II, janë duke u ndjekur procedurat për akreditimin e Autoritetit Menaxhues dhe Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë. Parandalimi i ndryshimeve ilegale në përdorimin e tokës bujqësore mbetet pengesë për zhvillimin e sektorit bujqësor. Ende nuk ka informata se sa tokë bujqësore humbet në baza vjetore.

MBPZHR, është angazhuar në zbatimin e obligimeve sektoriale që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA), duke azhurnuar Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (Kapitujt 11, 12, 13 dhe 27) dhe duke raportuar për zhvillimet në sektor.

Me qëllim të kompensimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi gjatë vitit 2016, me vendim të Qeverisë, MBPZHR ka ndarë buxhet për kompensimin e dëmeve të të gjithë fermerëve, në vlerë prej 25% të dëmit të shkaktuar.

Aktivitetet tjetër gjatë vitit 2016, ishte vazhdimi i formave të mbështetjes për promovimin dhe marketingun e prodhimit të bujqësore si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Brenda vendit janë mbështetur aktivitetet e shoqatave dhe asociacioneve të fermerëve për promovimin e prodhimit të bujqësore, përmes aktiviteteve të ndryshme, si: Dita e mollës, Dita e mjedrës, Dita e boronicës, Dita e domates, Dita e patates, Festivali i rrushit "Hardhfest", etj.

Sa i përket përkrahjes në promovimin e produkteve Kosovare në arenën ndërkombëtare janë mbështetur fermerët dhe agro përpunuesit për pjesëmarrje në panairët e rëndësishme ndërkombëtare, si: International Green Week në Berlin, SIAL në Paris, EXPO në Antalia, Panairi Bujqësor në Viroviticë dhe disa aktivitete tjera.

### 1.1.2 Puna dhe punësimi

Treguesit kryesorë, për fuqinë punëtore në Kosovë merren nga rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) e cila veteve të fundit organizohet 4 herë në vit. Kjo anketë ka për qëllim të sigurojë përdoruesit me statistika kyçe në tregun e punës në seri të rregullta kohore. Ky publikim përmban të dhëna të detajuara mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, statusit të punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe çështjeve të tjera të ngjashme, që kanë të bëjnë me tregun e punës.

Sipas rezultateve të dalta nga ky publikim, del se dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune. Në popullsinë e moshës së punës përfshihen moshat prej 15-64 vjeçare.

Shkalla e punësimit në AFP për vitin 2016, ishte 28.0%. Bazuar në të dhënat e kësaj ankete punësimi me i lartë ka qenë tek meshkujt, 43.0% ndërsa, punësimi tek femrat është paraqitur në shkallë më të ulët apo 12.7%, përqindje shumë më e vogël krahasuar me punësimin e meshkujve.

Sektorët më të rëndësishëm ekonomik, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë edhe më tutje: tregtia me 14.8%, prodhimi me 13.2%, ndërtimtaria me 11.5% dhe arsimit me 10.6%, ndërsa sektorët tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim. Femrat, ishin të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe të shëndetësisë 51.3%, ndësa meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e prodhimit, ndërtimtarisë dhe tregtisë me 44.3%.

**Tabela 4: Indikatorët kryesorë të tregut të punës sipas variablave, viti dhe gjinia**


Indikatorët	2014			2015			2016		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	61.8	21.4	41.6	56.7	18.1	37.6	58.3	18.6	38.7
Shkalla e joaktivitetit	38.2	78.6	58.4	43.3	81.9	62.4	41.7	81.4	61.3
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	41.3	12.5	26.9	38.7	11.5	25.2	43	12.7	28
Shkalla e papunësisë	33.1	41.6	35.3	31.8	36.6	32.9	26.2	31.8	27.5
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	56.2	71.7	61	54.2	67.2	57.7	47.2	65.4	52.4
Përqindja e të rinjëve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	26.6	34	30.2	28.3	34.9	31.4	26.5	34.2	30.1
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	26.7	189	24.9	24	18.8	22.8	24.1	18.8	22.9

Burimi: ASK-Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) 2016

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2016 ishte 38.7%, ku pjesëmarrja e femrave ishte 18.6% ndërsa e meshkujve 58.3%. Në krahasim me dy vitet e mëparshme shkalla e

pjesëmarrjes ka pasur një rritje të vogël në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 për 2.9 pikë përqindje, ndërsa rënie për 6.9 pikë përqindje me vitin 2014. Shkalla e joaktivitetit gjithsej ishte 61.3% me pjesëmarrje të femrave afro 81.4% ndërsa e meshkujve 41.7%. Shkalla e punësimit për dallim nga viti 2015 shënoi rritje për 2.8 pikë përqindje në vitin 2016.

**Figura 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës sipas variablave, gjithsej (%)**



Burimi:ASK-Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) 2016

Sipas rezultateve të AFP-së për vitin 2016, shkalla e papunësisë arriti në 27.5%. Papunësia më e theksuar vërehet tek femrat me pjesëmarrje prej 31.8%, krahasuar me meshkujt me 26.2%. Edhe gjatë këtij viti shkalla më e theksuar e papunësisë shfaqet tek grupmoshat 15-24 vjeçare me 52.4%. Papunësia është më e lartë tek femrat e reja (65.4%) se sa tek të rinjtë meshkuj (47.2%).

Në vitin 2016, afro 103,843 të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim dhe përbënin 30.1% të popullsisë së re. Pjesa e femrave NEET<sup>5</sup> është 34.2% krahasuar me 26.5% të meshkujve.

Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejtë gjatë dekadës së ardhshme pasi që Kosova konsiderohet se është një ndër vendet me popullsi më të re në Evropë. Pagat neto në vendin tonë të shumicës së punonjësve arrinin midis 300 € deri 400 € në muaj. Nuk janë vërejtur dallime shumë të mëdha gjinore sa i përket pagave.

### **Përdorimi i tokës**

Shfrytëzimi i tokës bujqësore karakterizohet për nga format e përdorimit, aktivitetet dhe inputet që njerëzit i ndërmarrin në përdorimin e tokës për të prodhuar, ndryshuar, për të ruajtur ose konzervuar atë. Përdorimi i tokës dhe ndryshimet që ndodhin gjatë veprimit

<sup>5</sup>NEET-Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim



tonë, kanë implikime të rëndësishme ekonomike dhe mjedisore për prodhimin dhe tregtinë e produkteve bujqësore, ruajtjen e tokës dhe ujit, cilësinë e ajrit dhe përqendrimet e gazrave serrë.

Të dhënat për përdorimin e tokës bujqësore janë shumë të rëndësishme pasi që mundësohet një parashikim i mirëfilltë për prodhimtarinë bujqësore dhe sigurinë e ushqimit, paralajmërimin e hershëm për sigurimin e ushqimit dhe gjendjen reale për mundësinë e prodhimit në bujqësi.

Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore i referohet sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme-arat, livadhet dhe kullosat, kulturat shumëvjeçare dhe kopshtet e përdorura nga ekonomia bujqësore, pavarësisht nga lloji i zotërimit. Nuk janë të përfshira të dhënat për tokën pyjore, tokën bujqësore të pa përdorur dhe tokën jo bujqësore.


**Tabela 5: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2016, (ha)**

	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %	Pjesëmarrja %
Tokë e punueshme - ara (duke përfshirë perimet)	178,129	178,902	773	0.4	43.0
Perimet	7,257	8,321	1,064	14.7	2.0
-nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	6,859	7,864	1,005	14.7	-
-nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	398	457	59	14.8	-
Kopsht	587	994	407	69.3	0.2
Pemët	4,727	5,493	766	16.2	1.3
Vreshta	3,068	3,117	49	1.6	0.7
Fidanishte	178	196	18	10.4	0.0
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	216,481	218,808	2,327	1.1	52.6
<b>Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore</b>	<b>410,427</b>	<b>415,831</b>	<b>5,404</b>	<b>1.3</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB), 2016; \* Grupimi i kulturave është si në AESH të ASK dhe mund të ketë ndryshime me Kapitullin e dytë në këtë Raport sepse ka dallime në grupim të kulturave

Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore të vitit 2016, gjithsej sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore janë 415.8 mijë ha, prej të cilës pjesa më e madhe i përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) 218.8 mijë ha ose 52.6%, ndërsa tokë e punueshme-ara (duke përfshirë perimet) janë 178.9 mijë ha ose 43%.

**Figura 2: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, 2016 (ha)**




Burimi: Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB), 2016

Në vitin 2016, toka e punueshme-ara (duke përjashtuar perimet) me sipërfaqe prej 178.9 mijë ha, ka pasur ndryshime në krahasim me vitin e mëparshëm për 773 ha, apo rritje prej 0.4%. Perimet në fushë të hapur si kulturë e parë kanë zënë sipërfaqen prej 8 mijë ha, dhe ka pasur rritje rritje për 14.7% në krahasim me vitin paraprak.

Përveç perimeve në fushë të hapur shtim të sipërfaqës për 59 ha ka pasur edhe kategoria me perime në serra (kulturë e parë) me një rritje prej 14.8%. Nga të gjitha kategoritë e shfrytëzimit të tokës ngritje të sipërfaqës më së shumti ka pasur kategoria e kopshteve, nga gjithsej 587 ha në vitin 2015 arriti në 994 ha në vitin 2016, kishte rritje për 69%. Pemët marrin pjesë me sipërfaqe prej 5.5 mijë ha, e që në krahasim me vitin 2015 ka pasur rritje prej 16.2%.

Gjithashtu edhe fidanishtet që zotronin sipërfaqen prej 178 ha në vitin 2015, në vitin 2016 patën rritje prej 10%. Poashtu edhe sipërfaqja me vreshta është rritur për 49 ha apo 1.6% krahasuar me vitin 2015.

**Figura 3: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, 2016 (%)**



Burimi: Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB), 2016


Në figurën e mësipërme është prezantuar ndarja e tokës bujqësore në përqindje në vitin 2016, sipas mënyrës së përdorimit ose shfrytëzimit. Ashtu siç u përshkrua më lartë mund të vërejmë se pjesëmarrje më të madhe prej 53% ka pasur kategoria e livadheve dhe kullosave përfshirë tokën e përbashkët. Pastaj radhitet toka e punueshme arat me 43%, pasuar nga perimet 2%, pemët 1%, vreshtat poashtu kishin pjesëmarrje prej 1%, kopshtet 0.2%, dhe fidanishtet 0.05%.

## **1.2 Llogaritë ekonomike dhe çmimet e inpueteve në bujqësi**

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi paraqesin një fushë të gjerë të indikatorëve lidhur me aktivitetet ekonomike sa i përket fushës së bujqësisë dhe kanë synim analizimin e procesit të prodhimit të industrisë bujqësore dhe të ardhurave primare të gjeneruara po nga i njejt prodhim.

Të dhënat sa i përket konsumit të ndërmjetëm dhe prodhimit të industrisë bujqësore kanë shënuar rritje në vitin 2016. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 prodhimi i industrisë bujqësore është rritur për 11%, ndërsa konsumi i ndërmjetëm është rritur për 7%.

**Figura 4: Konsumi i ndërmjetëm, prodhimi i industrisë bujqësore dhe vlera e shtuar bruto, në mil. €**




Burimi: ASK, Llogaritë Ekonomike për Bujqësi, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Vlera e shtuar bruto e cila njëherit paraqet edhe ndryshimin në mes të vlerës së prodhimit të industrisë bujqësore dhe vlerës së konsumit të ndërmjetëm në vitin 2016 ka arritur vlerën 489 mil. € vlerë e cila krahasuar me vitin 2015 ka shënuar rritje prej 17%.

Gjatë vitin 2016, vlera e shtuar bruto ishte e barabartë me 67% të vlerës së prodhimit, që krahasuar me vitin 2015 ishte 64%.

**Figura 5: Konsumi i ndërmjetëm i bujqësisë në vitin 2016 (%)**




Burimi: ASK, Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2016, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Duke ju referuar figurës së mësipërme e cila paraqet vlerën e komponentëve të konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2016, vërejmë se kategoria ushqimit të kafshëve e cila përfshinë materialin ushqyes të cilin fermeri e blen nga fermerët tjerë apo lëndën e parë dhe ushqimin për kafshë që fermeri e prodhon në fermë, kontribuon me 44%, që paraqet pothuajse gati gjysmën e konsumit të ndërmjetëm. Plehërat dhe përmirësuesit e tokës kanë pjesëmarrje me 13% në konsumin e ndërmjetëm, shpenzimet e energjisë 8%, farërat dhe materiali mbëltues 6%, mallrat dhe shërbimet tjera si dhe shërbimet bujqësore kontribuojnë

me nga 9%, shpenzimet veterinare 5%, si dhe mirëmbajtja e materjaleve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet kontribuojnë me nga 3%.

Figura e mëposhtme paraqet shpenzimet e ndryshme në fermë gjatë vitit. Ndër kategoritë më të rëndësishme për vitin 2016 është konsumi i ndërmjetëm, i cili kontribuon me 70%, pasuar nga konsumi i kapitalit fiks me 28%, ndërsa kategoritë tjera si kompensimi i punëtorëve dhe qiraja me shpenzimet tjera për shfrytëzimit të tokës dhe ndërtesave karakterizohen me pjesëmarrje shumë të ulët me nga 1%.

**Figura 6: Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2016**



Burimi: ASK, Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2016, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

### Çmimet e inpueteve bujqësore

Indeksi vjetor i çmimeve të inpueteve bujqësore 2010 - 2016, përfshin të dhëna për indekset e çmimeve në Kosovë për periudhën Janar - Dhjetor 2010 - 2016. Çmimet e prodhimeve të inpueteve bujqësore janë grumbulluar në barnatore bujqësore, barnatore veterinerë, nga kompanitë, tregjet, dhe vendet tjera ku çmimet e inpueteve bujqësore janë në dispozicion.

Produktet që përbëjnë bazën e indeksit të çmimeve të inpueteve marrin pjesë në njërin nga dy grupet kryesore: mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) si dhe mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2).

Brenda kategorisë së mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1), indekset e çmimeve janë llogaritur për grupet vijuese: farërat dhe materiali mbëltues, energjia, plehrat dhe përmirësuesit e tokës, produktet për mbrojtjen e bimëve, shpenzimet veterinerë, ushqimi i kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallrat dhe shërbimet e tjera.

Çmimet e mallrave dhe shërbimeve që lidhen me investimet bujqësore (Input 2) janë llogaritur duke përdorur çmimet e materialeve (makinerive dhe pajisjeve tjera), ndërtesat dhe të tjera (ndërtesat jo-rezidente të fermës, punët tjera përveç përmirësimit të tokës).

Tabela në vijim paraqet indeksin e çmimeve vjetore të inputeve bujqësore. Çmimet e kategorisë së Farërave dhe Materialit Mbëltues, të cilat në vitin 2015 shënuan rritje, në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015 kanë pësuar rënie prej 12%. Kategoria e energjisë dhe lubrifikantëve poashtu pësoi rënie prej 7%, plehrat dhe përmirësuesit e tokës për 3%, shpenzimet veterinerë për 2%, mirëmbajtja e ndërtesave për 2%, si dhe produktet për mbrojtjen e bimëve kishin rënie për 0.4%. Në anën tjetër, çmimet e kategorisë së ushqimit të kafshëve kanë shënuar rritje për 10%. Poashtu, kategoria traktorët tek input 2, ka shënuar rritje të dukshme për 12%, ndërsa kategoritë tjera nuk kanë pasur aq ndryshime në çmime krahasuar me vitin paraprak.

Për Input 1, indeksi vjetor i inputeve në vitin 2016, ka rënie për 2.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015. Indeksi për Input 2 është rritur për 5.2% mes viteve 2016 dhe 2015.

**Tabela 6: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2010-2016, (2010=100)**

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 në %
<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET E KONSUMUARA AKTUALISHT NË BUJQËSI (INPUT 1)</b>	<b>100.0</b>	<b>112.9</b>	<b>119.7</b>	<b>122.4</b>	<b>120.8</b>	<b>118.4</b>	<b>115.6</b>	<b>-2.4</b>
FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	100.0	112.7	109.4	107.1	115.3	158.6	139.9	-11.8
ENERGJI; LUBRIFIKANT	100.0	114.7	123.4	118.9	115.7	102.2	95.4	-6.6
Energjia elektrike	100.0	101.0	114.5	124.5	133.1	139.0	137.3	-1.2
Lëndë djegëse	100.0	117.1	125.5	119.1	114.2	97.8	90.5	-7.4
Lubrifikant	100.0	117.1	125.5	119.1	114.2	97.8	94.9	-2.9
PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	100.0	126.0	142.4	146.1	139.2	131.2	127.6	-2.8
Plehrat e thjeshtë	100.0	130.7	152.2	155.7	148.1	135.9	127.9	-5.9
Plehrat e përbëra	100.0	130.7	152.2	155.7	148.1	135.9	127.3	-6.3
PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	100.0	98.5	99.6	129.7	159.4	113.6	113.1	-0.4
SHPENZIMET VETERINARE	100.0	107.0	106.8	109.3	104.6	102.6	100.2	-2.3
LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	100.0	122.3	137.5	143.4	130.8	114.4	126.1	10.2
Lëndë të thjeshta ushqimi	100.0	123.7	140.5	146.0	131.4	117.2	130.3	11.2
Lëndë të përbëra ushqimi	100.0	137.0	144.4	144.2	135.5	117.0	88.1	-24.7
MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	100.0	100.0	100.4	100.7	100.4	99.0	99.2	0.2
MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	100.0	100.7	101.6	100.3	100.4	99.7	98.0	-1.7
MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	100.0	101.5	103.9	108.5	110.3	112.6	113.5	0.8
<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)</b>	<b>100.0</b>	<b>101.3</b>	<b>101.5</b>	<b>103.0</b>	<b>104.6</b>	<b>110.1</b>	<b>115.8</b>	<b>5.2</b>
TRAKTOR	100.0	101.3	101.3	104.1	107.1	118.5	132.2	11.6
TJERA	100.0	101.3	101.7	102.0	102.6	103.2	102.2	-0.9
<b>INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT 1 + INPUT 2)</b>	<b>100.0</b>	<b>108.1</b>	<b>112.2</b>	<b>114.4</b>	<b>114.1</b>	<b>115.0</b>	<b>115.7</b>	<b>0.6</b>

Burimi: ASK (Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi), përpunuar nga DAESB - MBPZHR

### 1.3 Struktura e fermës

Në vitin 2016, në Kosovë ka pasur 185,705 ha tokë të punueshme – ara<sup>6</sup>. Toka e përdorur nga fermat në vendin tonë në vitin në fjalë përbënte rreth 45% të gjithë sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore.

Bazuar në madhësinë e sipërfaqes së tokës së punueshme struktura e fermave klasifikohet në katër kategori kryesore:

- I. Fermat që kishin madhësi shumë të vogël me më pak se 0.5 ha deri më pak se 1ha përbëjnë 10.9% të fermave dhe kishin sipërfaqe prej 20,279 ha.
- II. Fermat me madhësi nga 1 deri më pak se 5 kishin pjesëmarrjen prej 52.9%, që do të thotë mbi gjysma e fermave i takon kësaj kategorie dhe përfaqësojnë rreth 98,260 ha.
- III. Fermat me madhësi prej 5 deri në më pak se 10 dhe 10 deri në më pak se 20 kishin një përfaqsim prej 24.6% që përfshijnë sipërfaqe prej 45,756 ha, dhe
- IV. Fermat me madhësi prej 20 deri më 30 e më shumë merrnin pjesë me 11.5% që përfshijnë sipërfaqen prej 21,409 ha.

Në tabelën në vijim është paraqitur madhësia ekonomike bujqësore në vitin 2016 sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, pjesëmarrjes (%), dhe numrit të ekonomive bujqësore dhe pjesëmarrja e tyre (%).

**Tabela 7: Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2016**

Madhësia e fermës	Sipërfaqja (ha)	Pjesëmarrja (%)	Nr. Ekonomive Bujqësore	Pjesëmarrja (%)
0 dhe më pak se 0,5	5,676	3.06%	33,312	30.62%
0,5 deri më pak se 1	14,602	7.86%	22,340	20.53%
1 deri më pak se 2	33,383	17.98%	25,086	23.06%
2 deri më pak se 5	64,876	34.94%	21,792	20.03%
5 deri më pak se 10	29,498	15.88%	4,531	4.16%
10 deri më pak se 20	16,258	8.75%	1,253	1.15%
20 deri më pak se 30	5,300	2.85%	226	0.21%
30 e më shumë	16,109	8.67%	263	0.24%
<b>Gjithsej<sup>7</sup></b>	<b>185,705</b>	<b>100%</b>	<b>108,803</b>	<b>100%</b>

Burimi: Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2016

Sipas radhitjes që është prezantuar në tabelën më lartë, rrjedh se rreth 63.8% e të gjitha fermave në Kosovë kishin më pak se 5 ha sipërfaqe të shfrytëzuar bujqësore dhe së bashku këto ferma të vogla përbënin rreth 118,540 ha të tokës bujqësore të shfrytëzuar. Në anën tjetër, vetëm 15.8% e fermave me madhësi 5 deri më pak se 10 ha zotronin sipërfaqe të tokës së shfrytëzuar prej 29,498 ha. Kur flasim për fermat më të mëdha duke u nisur prej 10 deri 20


<sup>6</sup> Në të gjithë tekstin në kuadër të struktues së fermës nuk është e përfshirë sipërfaqja në 4 komuna në pjesën veriore andaj ka dallim nga sipërfaqja e paraqitur tek nënkëpitulli – Përdorimi i tokës

<sup>7</sup> Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore



apo 30 e më shumë ha, posedonin vetëm 37,667 ha tokë për qëllime bujqësore me pjesëmarrje prej 20.3%.

**Figura 7: Numri i ekonomive bujqësore sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2016**



Burimi: Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2016

Sa i përket numrit të ekonomive bujqësore rreth 33,312 prej tyre apo 30.6% prej gjithsej ekonomive bujqësore posedojnë ferma me madhësi prej 0 dhe më pak se 0,5 ha sipërfaqe të tokës së punueshme. Grup tjetër më i madh paraqitet me 25,086 ekonomi bujqësore që përbëjnë 23.1% dhe posedojnë ferma me madhësi 1 deri më pak se 2 ha.

Si grup i tretë me pjesëmarrje më të lartë të ekonomive bujqësore respektivisht 20.5% ose 22,340 nga to posedojnë madhësi të fermave nga 0,5 deri më pak se 1.

Shiquar në tërësi mund të themi se sa i përket ekonomive bujqësore në Kosovë ato karakterizohen me tri kategori kryesore të madhësisë së fermave:

-Afërsisht 94.2% të ekonomive bujqësore apo 102,530 sosh në vitin 2016, bëjnë pjesë në kategoritë e madhësisë së fermave prej më pak se 0,5 deri në më pak se 5 ha.

-Kur bëhet fjalë për fermat me madhësi më të madhe të sipërfaqës së tokës së punueshme vijmë në përfundim se duke filluar nga fermat me madhësi 5 deri më pak se 10 ha kanë vetëm 4.16%, që bëjnë pjesë 4,531 ekonomi bujqësore.

-Vetëm 1.60%, që do të thot se 1,742 ekonomi bujqësore kishin ferma me madhësi nga 10 deri në 30 e më shumë ha.


**Tabela 8: Madhësia e fermave sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2014/2016**

Madhësia e fermës	Sipërfaqja (ha)		Ndryshimi (2014-2016)	Ndryshimi 2014/2016 (%)
	2014	2016		
0 dhe më pak se 0.5	9,142	5,677	-3,465.2	-37.9
0.5 deri më pak se 1	16,703	14,603	-2,100.5	-12.6
1 deri më pak se 2	31,905	33,384	1,479.0	4.6
2 deri më pak se 5	55,257	64,877	9,619.8	17.4
5 deri më pak se 10	29,518	29,498	-19.9	-0.1
10 deri më pak se 20	15,755	16,258	503.0	3.2
20 deri më pak se 30	5,303	5,300	-3.0	-0.1
30 e më shumë	16,798	16,109	-689.0	-4.1
<b>Gjithsej</b>	<b>180,381</b>	<b>185,705</b>	<b>5,324.2</b>	<b>3.0</b>

Burimi: Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2016

Nëse krahasojmë madhësinë e fermave sipas kategorive për vitin 2014 dhe 2016, vërehet se ka ndryshime për 9,619 ha, tek kategoria e fermave me madhësi prej 2 deri më pak se 5 ha, që shprehur në përqindje i bie të ketë pasur rritje për 17.4%. Rritje tjetër kemi po ashtu edhe tek kategoria e fermave me madhësi 1 deri më pak se 2, për 4.6%. Në kategorinë e fermave që kanë madhësi prej 10 deri më pak se 20 ha, paraqet rritje në vitin 2016 ndryshe nga viti 2014 për 3.2%. Zvogëlim në sipërfaqe paraqitet në kategorinë e fermave më pak se 0.5 ha prej 37.9% për dallim nga viti 2014. Gjithashtu rënie për 12.6%, ka pasur edhe në kategorinë e fermave 0.5 deri më pak se 1 ha.

**Figura 8: Madhësia e fermave sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2014/2016**



Burimi: Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2016


Nga rezultatet e Anketës së ekonomive bujqësore 2016, shohim se gjithsej sipërfaqja e tokës së punueshme bujqësore në vitin 2016, u rrit nga 180,381 ha që ishte në vitin 2014 për 3.0 %.

Lidhur me ndryshimet dhe lëvizjet që janë paraqitur në numrin e ekonomive bujqësore në vitin 2016 krahasuar me vitin 2014 janë paraqitur në figurën në vijim.

Ndryshimet më të mëdha janë shfaqur në kategorinë e fermave që kanë madhësinë nga 2 deri më pak se 5 ha, që kishte rritje krahas vitit 2014 për 16.4%.

Zvogëlim të ekonomive familjare në vitin 2016, për 16% shfaqet tek kategoria e fermave me madhësi më pak se 0.5 ha.

**Figura 9: Numri i ekonomive sipas madhësisë së sipërfaqes së tokës së punueshme 2014/2016**



Burimi: Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2016

## 1.4 Bizneset bujqësore-Agroindustria

Industria ushqimore zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë dhe është një burim kryesor i punësimit dhe krijimit të të ardhurave. Degët më të rëndësishme të industrisë ushqimore në Kosovë janë industria: bukës, qumështit, pijeve, mishit dhe degë tjera të kësaj industrie. Sektori i industrisë së ushqimit në Kosovë ka pësuar ndryshime thelbësore gjatë dekadës së kaluar.

Pas shkatërrimeve të shumta nga lufta e vitit 1999, industria ushqimore filloi gradualisht të rimëkëmbet në një ekonomi të orientuar drejt tregut. Konkurrenca vendore dhe e jashtme domosdoshmërisht ka ndikuar në stimulimin e përsosmërisë së cilësisë së prodhimit e cila ka pasur efekt në avansimin e teknologjisë në ndërmarrjet e caktuara ushqimore.

Një avansim i tillë teknologjik ka bërë të mundur arritjen e standardeve të larta në kualitetin e prodhimit. Përkundër të arriturave të deritanishme pozicioni konkurrues i produkteve ushqimore Kosovare në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm ende nuk është përmirësuar sa duhet. Bazuar në të dhënat e ASK-së shohim se, duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2014 mesatarja e pjesëmarrjes së aktiviteteve bujqësore të regjistruara në regjistrin e biznesit ndaj

aktiviteteve tjera ishte 7.6%. Filluar nga viti 2015, kemi një rritje prej 9.6%, pasuar me rritje të pjesëmarrjes në 10.4% në vitin 2016.


**Tabela 9: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike**

Vitet	Ndërmarrjet e regjistruara në Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	Ndërmarrjet e regjistruara Sipas seksioneve të aktiviteteve tjera ekonomike	Pjesëmarrja (%)
2012	741	9,576	7.7
2013	753	9,420	7.9
2014	674	9,404	7.1
2015	945	9,833	9.6
2016	1,090	10,424	10.4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sa i përket rritjes së numrit të aktiviteteve në bujqësi rritje më e hovshme ka qenë në vitin 2015, me 945 aktivitete bujqësore apo 40.2% me shumë se sa në vitin 2014, duke vazhduar me rritje në vitin 2016 në 1,090 aktivitete, apo 15.3% më tepër se sa në vitin 2015.


**Figura 10: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në vitin 2016, ishin të regjistruara 1,090 ndërmarrje në seksionin e aktiviteteve ekonomike të Bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë, ndërsa gjithsej ndërmarrje të regjistruara sipas seksioneve dhe aktiviteteve ishin 10,424. Aktivitetet e regjistruara nga Bujqësia marrin pjesë 10% nga totali i përgjithshëm i aktiviteteve tjera ekonomike të regjistruara gjatë këtij viti.

**Figura 11: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari (%), ndaj aktiviteteve tjera ekonomike, në vitin 2016**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në tabelën në vijim janë të prezantuara të dhënat lidhur me qarkullimin monetar në ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve për vitet 2011-2016: qarkullimi monetar vjetor, numri i të punësuarve si dhe numri i bizneseve aktive.


**Tabela 10: Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2011-2016**

Viti	Qarkullimi (000,€)	Numri i të Punësuarve	Numri bizneseve aktive
2011	275,851	6,046	1,742
2012	285,389	6,778	1,819
2013	290,518	7,130	1,896
2014	312,188	8,004	2,055
2015	323,370	8,790	2,130
2016	360,536	10,024	2,314
<b>Totali</b>	<b>1,847,852</b>	<b>46,772</b>	<b>11,956</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Bazuar në të dhënat që merren nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, agrobizneset kanë shënuar rritje nga viti në vit. Në vitin 2011, 2012 dhe 2013, mesatarisht për këto vite qarkullimi i përgjithshëm ka qenë 283 mil. €, duke vazhduar me ngritje të lehtë prej 10% në vitin 2014, krahasuar me mesataren e tri viteve. Rritja ka vazhduar edhe në vitin 2015, poashtu edhe në 2016, me ç' rast kishte rritje prej 11.5%, për dallim nga viti 2015.


**Figura 12: Qarkullimi monetar i ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari, 2011-2016**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Gjithashtu edhe numri i të punësuarve është rritur duke filluar nga viti 2011, kur ky numër ishte rreth 6,046. Nëse krahasohet numri i të punësuarve në vitin 2011, me atë të vitit 2016, del se ka pasur rritje për 66%.

**Figura 13: Numri i të punësuarve në agro biznese për vitet 2011-2016**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sa i përket bizneseve aktive poashtu ka pasur një shtim gradual të atyre që merren me aktivitete bujqësore ose si lëndë të parë kanë produktet bujqësore dhe ato pyjore. Numri mesatar i këtyre bizneseve aktive për vitet 2011-2013 ishte 1,822, ndërsa mesatarja për vitet

2014, 2015 dhe 2016 ishte 2,167, që do të thotë se në tri vitet e fundit ka pasur mesatarisht rritje të bizneseve aktive për 19%.

**Figura 14: Numri i bizneseve aktive per vitet, 2011-2016**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Nga industria agro-ushqimore në vitin 2016, qarkullim më të madh ka pasur në përpunimin e produkteve ushqimore me vlerë të qarkullimit 186 mil. €. Nga degët tjera të agro-industrisë që janë të prezantuara në tabelë, prodhimi i pijeve ka pasur qarkullim prej 84 mil. €, pasuar nga prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to, që kishin qarkullim prej 35 mil. €. Me vlerë të përafërt të qarkullimit ishte edhe industria e drurit dhe produkteve të drurit me qarkullim vjetor prej 32 mil. €. Qarkullim më i vogël u karakterizua tek prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës me 17 mil. €, pylltaria dhe prerja e drunjve me 2 mil. €. Qarkullim shumë më i vogël vlenë të ceket tek këto aktivitete: peshkimi dhe akuakultura 401 mijë €, prodhimi i produkteve të duhanit 87 mijë €, si dhe prodhimi i lëkurës dhe produkteve të sajë 42 mijë €.


**Tabela 11: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari, 2016**

Aktivitetet	Qarkullimi (000,€)	Nr. i të punësuarve	Nr. i bizneseve aktive
(01) Prodh. bimorë dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to	35,926	1,368	547
(02) Pylltaria dhe prerja e drunjëve	2,641	61	40
(03) Peshkimi dhe Akuakultura	401	9	3
(10) Përpunimi i produkteve ushqimore	186,089	5,427	1,153
(11) Prodhimi i pijeve	84,971	1,550	66
(12) Prodhimi i produkteve të duhanit	87	1	2
(15) Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	42	5	4
(16) Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta, materialeve të gërshetuara-thurëse	32,802	1,166	431
(17) Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	17,576	372	66
<b>Gjithsej</b>	<b>360,536</b>	<b>9,959</b>	<b>2,312</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Numri më i madh i fuqisë punëtore me afro 5,427 të punësuar, i takojnë kategorisë së përpunimit të produkteve ushqimore. Numër më të vogël të të punësuarve në krahasim me industrinë e lartë përmendur kishte në industrinë për prodhimin e pijeve me 1,550 të punësuar, industrinë e prodhimit bimorë dhe shtazorë, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to me 1,360 të punësuar, si dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të tij me rreth 1,166 të punësuar.

**Figura 15: Numri i të punësuarve në vitin 2016**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR



Numër më i madh i bizneseve ka qenë tek përpunimi i produkteve ushqimore ku ishin të regjistruara 1,153 biznese, vijuar nga 547 bizneset e regjistruara në aktivitetin (01) si prodhim bimor dhe shtazor, gjueti dhe shërbimet që lidhen me to dhe 431 biznese në aktivitetin (16) ku përfshihen bizneset që kanë të bëjnë me prodhimin e drurit dhe produkteve të tij. Numër më i vogël i bizneseve ishte në aktivitetet (11) dhe (17) me nga 66 biznese aktive.

**Figura 16: Numri i bizneseve aktive në vitin 2016**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR


### Qarkullimi në bazë të regjioneve

Qarkullimi i përgjithshëm vjetor në vitin 2016, nga ndërmarrjet e regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari, të përshkruara më lartë sipas kategorive, ishte në vlerë prej 360 mil. €.

Në figurat në vijim është paraqitur qarkullimi i bizneseve dhe pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari në vitin 2016, numri i të punësuarve dhe numri bizneseve aktive sipas regjioneve të Kosovës.

Pjesëmarrje më të madhe ka pasur regjioni i Prishtinës me përqindje prej 27%, përcjellur nga regjioni i Prizrenit me 20%, pastaj me vlerë më të vogël radhiten 5 regjionet tjera: Regjioni i Pejës dhe Gjakovës me pjesëmarrje prej 14%, regjioni i Gjilanit me 10%, i Mitrovicës 9%, dhe Ferizajit me vetëm 6%.


**Figura 17: Pjesëmarrja e qarkullimit të bizneseve sipas regjioneve, 2016(%)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në ndërmarrjet e regjistruara në aktivitetet Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatarë, ishte në përqindje më të madhe në regjionin e Prishtinës me pjesëmarrje rreth 26%, përcjellur nga regjioni i Prizrenit 19%, regjioni i Gjakovës 13%, regjioni i Pejës 12%, regjioni i Gjilanit 11% dhe me më pak pjesëmarrje në numrin e të punësuarve në këtë sektor paraqitet regjioni i Ferizajit me përfaqësim prej 10% dhe Mitrovicës 9%.


**Figura 18: Numri i të punësuarve në bazë të regjioneve, 2016 (%)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Me numrin e aktiviteteve të regjistruara brenda vitit, prin regjioni i Prishtinës me pjesëmarrje prej 23%, pastaj radhitet regjioni i Prizrenit me 20%, ai i Gjakovës 14%, dhe tri regjionet tjera: Gjilani, Peja dhe Ferizaji, janë me përqindje të njëjtë prej 11%. Pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të aktiviteteve ekonomike bujqësore të regjistruara ka pasur regjioni i Mitrovicës me vetëm 10%.

**Figura 19: Numri i aktiviteteve të regjistruara në regjione , 2016 (%)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

## 2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij

### 2.1 BPV në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi (LLEB) janë llogari satelite të Sistemit Evropian të Llogarive Ekonomike të Integruara (ESA). Ato janë publikuar nga Zyra Statistike e Komuniteteve Evropiane (Eurostat) që nga viti 1964. Konceptet themelore dhe rregullat e llogaritjes janë identike me ato të përcaktuara në ESA, karakteristikat dhe kërkesat e veçanta në bujqësi janë marrë gjithashtu në konsideratë në LLEB.

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi (LLEB) janë të bazuara në Rregulloren (KE) Nr.138/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 5 dhjetor 2003, mbi Llogaritë Ekonomike për Bujqësi në Komunitet.

Të dhënat e LLEB mund të përdoren për të llogaritur treguesit e të ardhurave për sektorin e bujqësisë. LLEB paraqesin të dhënat në vlerë monetare: vlera më çmime të prodhimit, vlera me çmime aktuale dhe vlera me çmime konstante. LLEB me çmime aktuale përfshijnë vlerën me çmime të prodhimit së bashku me subvencionet duke i'a zbritur taksat.

Ky është publikimi i tetë me radhë i Llogarive Ekonomike për Bujqësi i përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), publikimi përfshin të dhëna për vitin 2016.

Burimet kryesore të të dhënave për përpilimin e Llogarive Ekonomike për Bujqësi janë dy anketat e kryera në ASK: Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore (AESHB) dhe Statistikat e Çmimeve në Bujqësi (SÇB). Burime të tjera të të dhënave janë: Regjistrimi i Bujqësisë, Shërbimet Veterinare dhe të dhënat administrative nga MPBZHR. Në mungesë të burimeve të të dhënave për artikuj të caktuar, janë përdorur vlerësimet e ekspertëve.

Sipas të dhënave të llogarive ekonomike bujqësore të kalkuluara sipas kodeve që janë prezentuar në tabelën në vijim mund të themi se vlera e prodhimeve bimore për vitin 2016 ishte 412.3 mil. €, vlera e prodhimeve blegtorale arriti në 302.4 mil. €, konsumi i ndërmjetëm gjithsej është vlerësuar rreth të jetë 256.9%, ndërsa shërbimet bujqësore kishin vlerë 22 .1 mil. €.

Përveç kodit 12, ku janë të përfshira produktet blegtorale që kishin rënie për 6.2% dhe kodit 23 ku përfshihet kompensimi i punëtorve që po ashtu kishte rënie për 14%, të gjitha kategoritë tjera kanë shënuar rritje në vitin 2016.

Sipas dhënave të burimeve të lartë cekura rrjedh se prodhimet bimore që përfshinë: kategorinë e drithrave, bimëve foragjere, perimeve dhe prodhimet e kopshtit, patateve dhe pemëve kanë shënuar rritje në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015 për 17.5%. Kjo rritje në vlerën e prodhimeve bimore mund të spjegohet me rritjen e prodhimit të perimeve dhe bimëve foragjere.

Gjithashtu edhe nga ana e prodhimeve blegtorale ku përfshihen: qumështi, vezët mjalti dhe leshi i papërpunuar, ka pasur rritje të vlerës së prodhimeve për 8.4% në vitin 2016, për dallim nga viti 2015. Rritja mund të shpjegohet me rritjen e vlerës së produkteve blegtorale.

Prandaj, bazuar në këto llogari vërejmë se gjithsej prodhimet bimore dhe blegtorale janë rritur në shkallë prej 13.5% në vitin 2016, nëse e krahasojmë me vitin 2015.

Sa i përket prodhimeve bimore, perimet dhe prodhimet e kopshtit janë kategoria më e rëndësishme dhe përbëjnë afro 29.6%, të gjithsej prodhimit bimor të vitit 2016 përcjellur nga drithrat 25.2%. Nërsa, bimët foragjere të cilat përfshijnë bimët që prodhohen dhe konsumohen në të njejtën ekonomi bujqësore, përbëjnë 21.2% të gjithsej prodhimit bimor.

Pemët përbëjnë rreth 15.5%, patatet 7.4%, bimët industriale 0.1% si dhe prodhimet të tjera 1%.

Kurse kur bëhet fjalë për produktet blegtorale për vitin 2016, qumështi është produkti më i rëndësishëm blegtoral që kontriboi me 119.8 nga gjithsej 148.7 mil.€, produkti në fjalë ka shënuar rënie prej 9.7% në vitin 2016, ndryshe nga viti 2015.

Ndërkaq, në nën kategorinë e kafshëve përfshihet kryesisht shitja e mishit nga gjedhet, derrat, delet, dhitë, shpezët dhe kategori të tjera.

Nga këto kategori shitjet e mishit të gjedhit janë më të rëndësishme, pasuar nga mishi i shpezëve, mishi i deles dhe dhisë, si dhe mishi i derrit.

Kur flasim për rritjen e vlerës së produkteve bimore sipas kategorive nga prodhimtaria bimore në vitin 2016, shtim më të lartë të vlerës kanë pasur këto produkte:

Bimët industriale 76.5%, Patatet 32.6%, Bimët foragjere 22%, kategoria e Drithrave 15.9%, Pemët 15.4%, Perimet dhe prodhimet e kopshtit 14.2%, si dhe Prodhimet e tjera bimore (farërat) që kishin rritje prej 4.9%.

Ndërsa nga blegtoria ka pasur rritje në kodin 11 të tabelës me 27.8% dhe Prodhimet blegtorale gjithsej që kishin rritje prej 8.4%.

Shtim të vlerës ka pasur edhe në Shërbimet bujqësore për 19.5%, në Vlerën e shtuar bruto me çmime bazë 20.4%, Të ardhurat sipërmarrëse, si dhe kategoritë tjera të prezantuara në tabelë.

**Tabela 12: Llogaritë ekonomike për bujqësi me çmime aktuale, në mil. €**

Kodi	Llogaritë Ekonomike Bujqësore	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi (%)
1	Drithërat (përfshirë farërat)	93.5	107	107.1	102.1	92.1	89.5	103.7	14.2	15.9
2	Bimët industriale	0.05	0.05	0.14	0.12	0.26	0.17	0.3	0.13	76.5
3	Bimët foragjere	51.2	56	67.8	95.2	67.3	71.7	87.5	15.8	22.0
4	Perimet dhe prodhimet e kopshtit	123.3	119.6	104.1	154.4	82.9	107	122.2	15.2	14.2
5	Patatet	26.6	20.2	12	19.6	23	23	30.5	7.5	32.6
6	Pemët	26	23.2	32.9	51.9	54.6	55.2	63.7	8.5	15.4
9	Prodhimet e tjera bimore (farërat)	3.4	3.7	3.5	4.2	4.5	4.1	4.3	0.2	4.9
10	Prodhimet bimore gjithsej	324	329.7	327.6	427.6	324.7	350.7	412.3	61.6	17.6
11	Blegtoria	97.6	96	92.3	117.3	85.9	120.3	153.7	33.4	27.8
12	Produktet blegtorale	148.8	155.8	174.2	181.1	173	158.6	148.7	-9.9	-6.2
13	Prodhimet blegtorale gjithsej	246.4	251.9	266.6	298.4	258.9	278.9	302.4	23.5	8.4
14	Prodhimet bimore dhe blegtorale gjithsej	570.3	581.6	594.1	726	583.7	629.7	714.6	84.9	13.5
15	Shërbimet bujqësore	14.8	14.7	14.5	20.4	20.2	18.5	22.1	3.6	19.5
16	Prodhimet bujqësore gjithsej	585.2	596.2	608.6	746.3	603.9	648.2	736.7	88.5	13.7
19	Konsumi i ndërmjetëm gjithsej	200.1	216.4	224.5	250	233.2	239.3	256.9	17.6	7.4
20	Vlera e shtuar bruto me çmime bazë	390.6	384.3	390.3	305.8	377.3	416.8	489.3	72.5	17.4
21	Konsumi i kapitalit fiks	77.9	81	84.5	93.7	90.6	95.5	102.6	7.1	7.4
22	Vlera e shtuar neto me çmime bazë	312.7	303.3	305.8	403.6	286.8	321.3	386.7	65.4	20.4
23	Kompensimi i punëtorëve	3.5	3.9	4.2	4.6	4.6	2.7	2.3	-0.4	-14.8
25	Subvencionet tjera në prodhim	0.06	0.1	0	1.02	0.6	0.6	1	0.4	66.7
26	Të ardhurat faktor	312.8	303.4	305.8	404.6	287.4	322	387.6	65.6	20.4
27	Teprica operative / Të ardhurat e përziera	309.3	299.5	301.6	400.1	282.7	319.3	385.4	66.1	20.7
28	Qiratë dhe shpenzimet tjera për shfrytëzimin e patundshmërive	2.2	2.3	2.3	3.3	3.1	4.5	4.6	0.1	2.2
29	Interesi i paguar	1	0.9	0.8	0.6	0.4	1.4	1.6	0.2	14.3
31	Të ardhurat sipërmarrëse	306.1	296.3	298.4	396.2	279.2	313.2	379.1	65.9	21.0

Burimi: ASK, Llogaritë ekonomike për bujqësi, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

## 2.2 Drithërat

Sipërfaqja e kultivuar me drithëra në vitin 2016, përbën 72% të tokës së punueshme-arave. Kulturat që zënë përqindjen më të madhe të tokës së kultivuar me drithëra janë gruri me 66% dhe misri me 31%, ndërsa pjesa tjetër është e kultivuar me tërshërë, elb, thekër dhe drithëra tjera. Në vitin 2016, përveç grurit sipërfaqja e të cilit shënoi rënie për 1%, kulturat e tjera shënuar rritje në sipërfaqe. Rritjen më të madhe e shënoi tërshëra me 20%, pasuar nga elbi dhe thekra me nga 5% secila, ndërsa sipërfaqja me misër mbeti pothuajse e njëjtë.

Rritja në sipërfaqe por edhe rritja që ishte në rendiment tek të gjitha drithërat rezultuan që prodhimtaria totale e drithërave të rritet për 27%. Misri kishte rritje të rendimentit për 1.3 tonë/ha e kjo ndikoi që prodhimtaria totale e misrit të rritet për 42%. Prodhimtaria e tërshërës u rrit për 59% kjo si rezultat i rritjes së rendimentit 32%, por edhe rritjes së sipërfaqes për 20%. Përveç kulturave të cekura më lartë, prodhimtaria e thekrës u rrit për 23%, ndërsa ajo e grurit dhe elbit për nga 20%.

**Tabela 13: Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave, 2010-2016**

Kultura	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>							<b>%</b>	
Drithëra	119,871	121,095	137,215	141,912	131,949	134,886	134,571	-1	0
Grurë	78,420	79,928	102,918	101,846	90,728	89,942	89,122	-5	-1
Misër	35,424	35,209	31,181	36,122	35,038	41,492	41,524	11	0
Elb	1,177	844	568	1,363	1,487	1,141	1,196	-10	5
Thekër	571	607	253	235	588	396	415	2	5
Tërshërë	4,279	4,508	2,294	2,346	3,940	1,790	2,156	-20	20
Drithëra të tjera kokërr	-	-	-	-	168	125	157	7	26
<b>Prodhimtaria</b>	<b>t</b>							<b>%</b>	
Drithëra	430,524	435,034	438,792	540,136	463,581	443,584	562,899	17	27
Grurë	294,540	300,203	345,027	391,727	331,296	304,443	365,651	7	20
Misër	120,461	119,693	86,304	136,633	116,209	131,486	186,592	46	42
Elb	3,642	2,608	1,808	4,415	4,716	3,061	3,669	-10	20
Thekër	1,371	1,457	740	571	1,521	809	991	3	23
Tërshërë	10,510	11,072	4,913	6,790	9,840	3,415	5,428	-19	59
Drithëra të tjera kokërr	-	-	-	-	-	371	568	53	53
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>							<b>%</b>	
Grurë	3.76	3.76	3.35	3.85	3.65	3.38	4.10	13	21
Misër	3.40	3.40	2.77	3.78	3.32	3.17	4.49	31	42
Elb	3.09	3.09	3.18	3.24	3.17	2.68	3.07	1	14
Thekër	2.40	2.40	2.92	2.43	2.59	2.04	2.39	2	17
Tërshërë	2.46	2.46	2.14	2.89	2.50	1.91	2.52	3	32
Drithëra të tjera kokërr	-	-	-	-	-	2.96	3.62	22	22

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16 ); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14)

Në vitin 2016, nga sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me drithëra, 65.5% është e mbjellë me grurë. Me sipërfaqe prej 88,122 ha, prodhimtaria e grurit është 365,651 ton, dhe me këtë prodhimtari Kosova arrin t'i mbulojë rreth 80% të nevojave për konsum ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga importi.

Vlera e prodhimit ishte 62.2 mil. € që është 7.6% më e lartë se në vitin 2015 për shkak se prodhimtaria është më e madhe si rezultat i rritjes së rendimentit edhe pse çmimi është më i ulët për 0.02 €. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, sasia e grurit të importuar duke përfshirë edhe produktet e grurit është më e ulët në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 për 50%.

**Tabela 14: Bilanci i furnizimit për grurin, 2010-2016**

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me drithëra	ha	119,871	121,095	137,215	141,912	131,949	134,886	134,571
Sipërfaqja me grurë	ha	78,420	79,928	102,918	101,846	90,728	89,942	88,122
Pjesëmarrja e grurit	%	65.4	66.0	75.0	71.8	68.8	66.7	65.5
Rendimenti	t/ha	3.76	3.76	3.35	3.85	3.65	3.38	4.15
Prodhimtaria	t	294,540	300,203	345,027	391,727	331,296	304,443	365,651
Importi i grurit dhe eku. të grurit	t	199,570	210,782	178,313	171,387	178,782	204,015	104,012
Furnizimi	t	494,110	510,985	523,340	563,114	510,078	508,458	469,663
Eksporti i grurit dhe eku. të grurit	t	37,257	40,213	37,365	38,158	33,132	27,765	5,885
Përdorimi vendor	t	456,853	470,772	485,974	524,956	476,946	480,693	463,778
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	64.5	63.8	71.0	74.6	69.5	63.3	78.8
Farë gruri	t	23,526	23,978	30,875	30,554	27,218	26,983	26,437
Humbjet	t	8,836	9,006	10,351	11,752	9,939	9,133	10,970
Ushqimi për kafshë	t	47,392	48,303	55,515	63,029	53,306	48,985	58,833
Përdorimi industrial	t	9,687	10,130	8,864	8,756	9,044	10,417	10,737
Procesimi	t	202,737	207,148	229,689	262,006	223,688	208,086	174,267
Konsumi njerëzor	t	164,675	172,207	150,681	148,859	153,751	177,089	182,535
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.19	0.25	0.26	0.22	0.20	0.19	0.17
Vlera e prodhimit	mil. EUR	56.0	75.1	89.7	86.2	66.3	57.8	62.2
Bilanci tregtar i grurit	mil. EUR	-75.5	-74.7	-72.2	-68.8	-73.8	-81.9	-24.4

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12/'13,'15,'16); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Misri është kultura e dytë më e kultivuar në grupin e drithërave. Në vitin 2016, 30.9% e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me drithëra është e mbjellë me misër. Në vitin 2016 sipërfaqja me misër ishte pothuajse e njëjtë me vitin 2015, ndërsa prodhimi është 42% më i lartë si rezultat i rritjes së rendimentit. Me këtë sasi të prodhimit Kosova mund të mbulojë 87% të nevojave të brendshme, ku pjesa më e madhe është përdorur si ushqim i kafshëve. Për të përmbushur nevojat e përgjithshme Kosova gjithashtu importon misrin dhe bilanci tregtar mbetet negativ në vlerë prej 4.1 mil. €.



**Tabela 15: Bilanci i furnizimit për misrin, 2010-2016**

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me drithëra	ha	119,871	121,095	137,215	141,912	131,949	134,886	134,571
Sipërfaqja me misër	ha	35,424	35,209	31,181	36,122	35,038	41,492	41,524
Pjesëmarrja e misrit	%	29.6	29.1	22.7	25.5	26.6	30.8	30.9
Rendimenti	t/ha	3.40	3.40	2.77	3.78	3.32	3.17	4.49
Prodhimtaria	t	120,461	119,693	86,304	136,633	116,209	131,486	186,592
Importi i misrit dhe eku. të misrit	t	36,666	32,063	28,081	38,471	45,921	56,760	27,027
Furnizimi	t	157,127	151,756	114,385	175,104	162,130	188,246	213,619
Eksporti i misrit dhe eku. të misrit	t	91	78	54	61	312	221	94
Përdorimi vendor	t	157,036	151,678	114,331	175,043	161,818	188,025	213,525
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	76.7	78.9	75.5	78.1	71.8	69.9	87.4
Farë misri	t	708	704	624	722	701	830	830
Humbjet	t	3,614	3,591	2,589	4,099	3,486	3,945	5,598
Ushqimi për kafshë	t	92,911	92,319	66,473	105,449	89,618	101,369	144,131
Përdorimi industrial	t	2,758	2,522	2,066	2,975	3,177	3,841	2,445
Procesimi	t	10,161	9,661	7,456	11,222	10,834	12,750	10,654
Konsumi njerëzor	t	46,884	42,881	35,123	50,575	54,003	65,291	49,867
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.22	0.29	0.30	0.31	0.28	0.23	0.24
Vlera e prodhimit	mil. EUR	26.5	34.7	25.9	42.4	32.5	30.2	44.8
Bilanci tregtar i misrit	mil. EUR	-8.1	-8.9	-8.6	-9.9	-10.4	-11.3	-4.1

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12-'13, '15, '16); ASK- Vlerësimet të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

## 2.3 Perimet

Në vitin 2016, në Kosovë janë mbjellur 17,395 ha me perime, që krahasuar me vitin 2015 ka pasur rritje të sipërfaqes për 19%.

Ndër kulturat primore të cilat në vitin 2016, kanë shënuar rritje në sipërfaqe krahasuar me vitin 2015 janë: lulelakra 160%, kungulli i misrit 114%, kungulli 85%, karrota 73%, sallata 62%, pjepëri 56%, bishtajoret tjera 55%, shalqiri 44%, majdanozi 38%, lakra 36%, hudhra 22%, patatja dhe fasulja me nga 13%, domatja 10% dhe speci 9%. Tabela në vijim paraqet sipërfaqet me perime ndër vite si dhe ndryshimin në përqindje mes viteve.

**Tabela 16: Sipërfaqja me perime, 2010 - 2016**

Kultura	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13-15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Sipërfaqja	ha							%	
Perime	16,356	16,196	14,557	16,356	15,854	14,656	17,395	11	19
Patate	3,760	3,746	3,198	2,777	3,695	3,353	3,795	16	13
Domate	935	967	1,271	950	558	791	866	13	10
Patëllxhan i zi	6	5	2	8	-	5	4	-32	-11
Spec	2,914	2,993	3,153	3,686	2,553	3,090	3,363	8	9
Kungull	956	880	671	1,005	1,354	551	1,017	5	85
Kungull misiri	94	94	106	96	232	229	490	164	114
Kërpudha	1	2	2	-	1				
Trangull	343	359	255	340	193	317	259	-9	-18
Shalqi	1,141	1,240	847	827	781	781	1,127	42	44
Pjepër	175	171	271	455	167	193	301	11	56
Lakër	836	842	568	851	556	594	807	21	36
Lulelakër	7	4	13	29	-	32	83	172	160
Spinaq	71	75	40	55	139	204	181	36	-11
Sallatë	48	51	29	75	-	59	96	42	62
Panxhar	40	43	2	5	58	19	11	-58	-41
Rrepkë (rillkë)	3	3	1	2	-	2	1	-36	-31
Majdanoz	11	11	9	20	-	9	13	-12	38
Presh (purri)	113	121	93	143	44	78	70	-21	-10
Qepë	1,043	1,074	881	1,060	1,041	1,079	1,228	16	14
Hudhër	150	152	141	193	85	114	140	7	22
Fasule	3,609	3,260	2,954	3,648	3,959	2,945	3,317	-6	13
Bizele	32	34	7	52	241	134	96	-32	-28
Bishtajoret tjera	15	13	16	30	59	19	30	-17	55
Karrota	53	56	27	49	76	57	99	63	73
Perime tjera	-	-	-	-	64	-			

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14);

Sa i përket prodhimitarisë së perimeve në vitin 2016, krahasuar me mesataren e tre viteve të fundit ajo ka shënuar ngritje për 43%, sipas kategorive ngritje kanë shënuar prodhimitaria e shumicës së kulturave perimore ku vlenë të cekën kulturat si kungulli i misirit 8,859 tonë dhe karrota 638 tonë. Rritje në prodhimtarin totale kanë pasur edhe kultura tjera si shalqiri, pjepri, spinaqi me nga 74%, ndërsa rritje më të ulët ka shënuar speci me 15%. Në vitin 2016, vlen të ceket se si rezultat i rritjes së sipërfaqes me lulelakër edhe prodhimitaria ka shënuar rritje prej 1,353 tonë, ndërsa rënie ka shënuar prodhimitaria e trangullit prej 40%, duke ju referuar edhe zvogëlimit të sipërfaqes me trangull.

**Tabela 17: Prodhimtaria e perimeve, 2010 - 2016**

Kultura	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Prodhimtaria	t							%	
Perime	338,989	345,565	163,146	235,326	221,330	246,096	335,467	43	36
Patate	87,354	87,036	33,407	50,847	64,027	70,678	98,583	59	39
Domate	60,318	62,358	13,693	17,291	17,386	24,333	27,215	38	12
Patëllxhan i zi	134	98	17	170	-	165	123	-26	-25
Spec	93,924	96,322	50,744	72,928	57,921	55,469	68,849	11	24
Kungull	7,617	7,119	9,099	10,224	14,363	6,141	14,894	45	143
Kungull misiri	1,861	1,846	2,065	1,963	4,604	4,811	13,670	260	184
Kërpudha	16	19	19	-	7	-	-	-	-
Trangull	12,902	13,502	5,239	8,975	5,428	17,365	10,428	-2	-40
Shalqi	25,743	27,975	17,080	17,641	16,669	17,404	29,997	74	72
Pjepër	2,138	2,090	2,455	4,824	1,778	2,966	5,558	74	87
Lakër	22,988	23,154	13,975	21,924	14,426	16,694	25,957	47	55
Lulelakër	131	75	169	1,793	-	218	1,571	56	622
Spinaq	859	898	262	408	1,199	1,892	2,031	74	7
Sallatë	608	635	200	736	-	884	1,392	72	57
Panxhar	389	422	27	59	678	240*	276	-15	15
Rrepkë (rillkë)	23	21	6	8	-	12	12	15	-5
Majdanoz	67	71	50	112	-	103	186	73	80
Presh (purri)	1,559	1,675	1,293	2,206	640	1,942	1,831	15	-6
Qepë	13,257	13,655	8,601	15,308	12,812	13,795	19,814	42	44
Hudhër	867	878	557	1,046	431	705	1,063	46	51
Fasule	5,575	5,033	3,723	5,892	5,831	9,018	10,267	49	14
Bizele	96	103	34	313	1,117	392	250	-59	-36
Bishtajoret tjera	75	66	111	177	353	124	119	-45	-4
Karrota	488	514	320	481	779	743	1,381	107	86
Perime tjera	-	-	-	-	881	-	-	-	-

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14);

\*Për vitin 2015 tek panxhari është përfshirë panxhari i kuq dhe panxhari foragjer të publikuara në Anketën e Ekonomive Bujqësore 2015

Sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me perime në vitin 2016 ishte 17,395 ha, nga e cila 5% është mbjellur me domate.

Prodhimi i përgjithshëm vendor ishte 27,215 tonë, i cili mbulon 62.6% të nevojave vendore për konsum dhe pjesa tjetër mbulohet nga importi. Eksporti i domates shënon 414 tonë, ndërsa importi rreth 16,687 tonë.

Nga gjithsej përdorimi vendor 43,488 tonë, rreth 42,399 tonë janë shfrytëzuar për konsum të përgjithshëm, ndërsa 1,089 tonë llogariten si humbje.

Vlera e prodhimit të domates llogaritet të jetë 13.1 mil. €, që është 36% më e lartë karahasuar me vitin 2015, kjo si rezultat i ngritjes së sasisë së prodhimit të gjithashtu edhe çmimit i cili është rritur për 0.09 €. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ prej 5.5 mil. €.

**Tabela 18: Bilanci i furnizimit për domaten, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me perime	ha	16,356	16,196	14,557	16,356	15,854	14,656	17,395
Sipërfaqja me domate	ha	935	967	1,233	950	558	791	866
Pjesëmarrja	%	5.7	6.0	8.5	5.8	3.5	5.4	5.0
Rendimenti	t/ha	63.63	63.40	20.28	18.20	31.15	30.77	31.42
Prodhimi	t	59,490	61,312	25,006	17,291	17,386	24,333	27,215
Importi i domates	t	13,583	14,536	12,636	13,756	16,814	15,110	16,687
Furnizimi	t	73,073	75,848	37,643	31,047	34,199	39,444	43,902
Eksporti i domates	t	649	412	115	32	64	63	414
Përdorimi vendor	t	72,424	75,436	37,527	31,016	34,135	39,381	43,488
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	82.1	81.3	66.6	55.7	50.9	61.8	62.6
Humbjet	t	2,380	2,452	1,000	692	695	973	1,089
Procesimi	t	571	589	240	166	167	234	261
Vetë konsumi final	t	10,851	11,183	4,561	3,154	3,171	4,438	4,964
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	70,045	72,984	36,527	30,324	33,440	38,408	42,399
Përdorimi vendor total	t	72,424	75,436	37,527	31,016	34,135	39,381	43,488
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.62	0.50	0.71	0.56	0.55	0.41	0.50
Vlera e prodhimit	mn EUR	35.4	29.4	17.0	9.3	9.2	9.6	13.1
Bilanci tregtar i domates	mn EUR	-5.1	-4.7	-3.0	-3.3	-5.2	-5.4	-5.5

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14) ASK; Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

Kultura e specit merr pjesë me 19%, në totalin e sipërfaqes së kultivuar me perime. Prodhimtaria sa i përket kulturës së specit karhasuar me vitin 2015, ka shënuar ngritje për 24% e cila mbulon rreth 87% të nevojave për konsum.

Nga totali i përdorimit vendor 79,470 tonë, për konsum të përgjithshëm janë shfrytëzuar 76,716 tonë dhe si humbje llogariten 2,754 tonë, ndërsa për procesim janë destinuar 661 tonë.

Vlera e prodhimit të specit për vitin 2016, ishte 39.7 mil € që është 6% më e lartë se ajo e vitit 2015.

Çmimi i specit për vitin 2016, ka shënuar ulje për 0.10 €. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, në vitin 2016 sasia e specit të importuar ishte 11,734 tonë ndërsa ajo e eksportuar 1,113 tonë.

**Tabela 19: Bilanci i furnizimit për specin, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me perime	ha	16,356	16,196	14,557	16,356	15,854	14,656	17,395
Sipërfaqja me spec	ha	2,914	2,993	3,153	3,686	2,553	3,090	3,363
Pjesëmarrja	%	17.8	18.5	21.7	22.5	16.1	21.1	19.3
Rendimenti	t/ha	32.23	32.18	16.09	19.79	22.69	17.95	20.47
Prodhimi	t	93,924	96,322	50,744	72,928	57,921	55,469	68,849
Importi i specit	t	7,448	7,932	7,721	9,150	10,489	9,246	11,734
Furnizimi	t	101,372	104,254	58,465	82,078	68,409	64,715	80,582
Eksporti i specit	t	2,493	2,045	2,053	1,187	994	602	1,113
Përdorimi vendor	t	98,878	102,209	56,412	80,891	67,416	64,114	79,470
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	95.0	94.2	90.0	90.2	85.9	86.5	86.6
Humbjet	t	3,757	3,853	2,030	2,917	2,317	2,219	2,754
Procesimi	t	902	925	487	700	556	533	661
Vetë konsumi final	t	17,132	17,569	9,256	13,302	10,565	10,118	12,558
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	95,121	98,356	54,382	77,974	65,099	61,895	76,716
Përdorimi vendor total	t	98,878	102,209	56,412	80,891	67,416	64,114	79,470
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.59	0.58	0.58	0.78	0.65	0.70	0.60
Vlera e prodhimit	mn EUR	53.2	53.6	28.3	54.6	36.1	37.3	39.7
Bilanci tregtar i specit	mn EUR	-4.1	-3.2	-2.9	-3.0	-4.1	-4.0	-4.2

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14) ASK; Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

Kultura e patates kultivohet në sipërfaqe prej 3,795 ha, nga totali i sipërfaqes së përgjithshme me perime 17,395 ha, krahasuar me vitin 2015 sipërfaqja e mbjellur me patate është rritur për 13%.

Prodhimtaria e patates llogaritet 98,583 tonë, dhe me këtë sasi prodhimi mbulon 100% të nevojave të brendshme, ndërsa përdorimi vendor llogaritet 88,822 tonë nga i cili 83,893 tonë janë shfrytëzuar për konsum të përgjithshëm kurse 4,929 tonë llogariten si humbje, për procesim janë destinuar 4,683 tonë dhe për konsum final 28,096 tonë.

Bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 0.2 mil.€, ndërsa vlera e prodhimit është 32.8 mil.€, me çmim prej 0.35 € që krahasuar me vitin 2015 është rritur për 0.02 €. Sasia e importit të patates llogaritet 4,868 tonë ndërsa sasia e eksportit 14,629 tonë, që krahasuar me vitin 2016 ka shënuar ngritje për 19%.

**Tabela 20: Bilanci i furnizimit për pataten, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me perime	ha	16,356	16,196	14,557	16,356	15,854	14,656	17,395
Sipërfaqja me patate	ha	3,760	3,746	3,198	2,777	3,695	3,353	3,795
Pjesëmarrja	%	23.0	23.1	22.0	17.0	23.3	22.9	21.8
Rendimenti	t/ha	23.23	23.23	10.45	18.31	17.33	21.08	25.97
Prodhimi	t	87,354	87,036	33,407	50,847	64,027	70,678	98,583
Importi i patates	t	2,778	1,380	1,595	2,708	4,503	4,822	4,868
Furnizimi	t	90,132	88,416	35,002	53,555	68,530	75,500	103,451
Eksporti i patates	t	3,095	3,971	5,450	9,690	12,673	12,294	14,629
Përdorimi vendor	t	87,037	84,445	29,553	43,865	55,858	63,206	88,822
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	100.4	103.1	113.0	115.9	114.6	111.8	111.0
Humbjet	t	4,368	4,352	1,670	2,542	3,201	3,534	4,929
Procesimi	t	4,149	4,134	1,587	2,415	3,041	3,357	4,683
Vetë konsumi final	t	24,896	24,805	9,521	14,491	18,248	20,143	28,096
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	82,669	80,093	27,882	41,323	52,656	59,673	83,893
Përdorimi vendor total	t	87,037	84,445	29,553	43,865	55,858	63,206	88,822
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.29	0.30	0.32	0.43	0.31	0.33	0.35
Vlera e prodhimit	mn EUR	24.1	24.8	10.2	20.8	18.9	22.2	32.8
Bilanci tregtar i patates	mn EUR	-0.2	0.1	0.3	0.7	-0.2	-0.4	-0.2

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14) ASK; Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

## 2.4 Pemët dhe vreshtat

Në vitin 2016, në Kosovë janë mbjellur 8,785 ha me pemë, që përfaqëson 2% nga sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore. Krahasuar me vitin 2016 sipërfaqja me pemë është rritur për 10%, ndërsa nëse krahasohet me mesataren e tri viteve të fundit rritja llogaritet 13%.

Nga totali i sipërfaqes mbjellur me pemë, kulturat si molla, rrushi për verë dhe kumbulla përbëjnë 68% të sipërfaqes. Në vitin 2016, kulturat të cilat kanë shënuar rritje në sipërfaqe krahasuar me mesataren e tri viteve të fundit janë mjedra, arra 77%, lajthija 57%, mushmolla 53%, qershia 32%, vishnja 17%, manaferra 16%, dardha 10%, boronica 5%, molla 4% dhe rrushi i tryezës 1%.

Kulturat të cilat kanë shënuar zvogëlim në sipërfaqe me pemë në raport me mesataren e tri viteve të fundit janë: ftoi 52%, kajsia 47%, pjeshka 38% dhe rrushi për verë 1%.

**Tabela 21: Sipërfaqja me pemë, 2010 - 2016**

Kultura	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Sipërfaqja	ha							%	
Frutat	6,578	6,733	7,082	8,342	6,921	7,998	8,785	13	10
Molla	1,661	1,790	1,725	2,024	1,973	1,972	2,076	4	5
Dardha	352	354	326	561	210	367	416	10	13
Ftoni	39	38	52	111	26	58	31	-52	-46
Mushmolla	22	22	16	35	21	-	43	53	-
Kumbulla	1,063	1,063	1,404	1,843	699	1,518	1,518	12	0
Kajsia	16	13	22	47	23	12	15	-47	20
Pjeshka	41	42	39	84	28	12	26	-38	112
Qershia	50	50	50	88	51	27	73	32	170
Vishnja	58	58	107	106	125	147	148	17	0
Arra	63	75	57	91	48	177	186	77	5
Lajthia	13	15	2	22	88	65	91	57	40
Dredhëza	49	45	52	148	201	203	175	-5	-14
Mjedëra	1	0	0	23	141	324	797	390	146
Manaferra	10	10	10	-	15	19	20	16	3
Rrush për verë	2,504	2,510	2,517	2,408	2,420	2,321	2,348	-1	1
Rrush tryeze	636	648	702	751	781	747	769	1	3
Gështenja	-	-	-	-	24	-	-	-	-
Boronica	-	-	-	-	14	14	15	5	5
Pemë tjera	-	-	-	-	32	14	39	70	182

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); MPBZHR - Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari

Prodhimtaria e përgjithshme e pemëve për vitin 2016, ka shënuar rritje në raport me mesataren e tri viteve të fundit për 22%.

Sipas kategorive kulturat tek të cilat prodhimtaria ka shënuar rritje krahasuar me mesataren e tri viteve të fundit janë: mjedra 687%, qershia 83%, molla 69%, mushmolla 60%, arra dhe dredhëza me nga 36%, dardha 35%, manaferra 21% dhe rrusi i tryezës 8%, rritja e prodhimtarisë së këtyre kulturave vjen si rezultat i rritjes së sipërfaqes së mbjellur me pemë.

Kategoritë tek të cilat prodhimtaria është zvogëluar krahasuar me mesataren e tri viteve të fundit janë: lajthija 70%, kajsija 40%, ftoi 34%, boronica 31% dhe rrusi për verë 7%.

**Tabela 22: Prodhimtaria me pemë, 2010 - 2016**

Kultura	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Prodhimtaria	t							%	
Frutat	52,419	41,429	59,633	76,702	45,873	70,096	78,502	22	12
Molla	12,545	13,523	8,120	16,786	13,519	18,352	27,485	69	50
Dardha	2,495	2,510	1,562	4,259	1,363	3,189	3,966	35	24
Ftoni	275	265	506	977	224	294	329	-34	12
Mushmolla	90	92	66	138	87	-	181	60	-
Kumbulla	6,957	6,957	17,514	24,433	7,525	17,543	12,722	-23	-27
Kajsia	89	71	83	239	110	75	85	-40	13
Pjeshka	177	180	173	441	130	61	211	0	245
Qershia	257	256	167	354	211	99	405	83	309
Vishnja	255	255	1,175	381	793	810	696	5	-14
Arra	314	371	234	483	229	323	470	36	46
Lajthia	18	21	2	31	111	13	16	-70	20
Dredhëza	294	270	275	465	965	1,498	1,328	36	-11
Mjedëra	2	1	1	105	529	1,748	6,250	687	258
Manaferra	73	73	73	-	107	284	237	21	-17
Rrush për verë	22,536	12,048	22,656	20,473	15,101	18,426	16,800	-7	-9
Rrush tryeze	6,042	4,536	7,026	7,137	4,869	6,996	6,866	8	-2
Gështenja	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Boronica	-	-	-	-	-	276	189	-31	-31
Pemë tjera	-	-	-	-	-	109	268	146	146

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12, '13/'15-'16); ASK - Vlerësimet të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); MPBZHR - Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari

Sipërfaqja e mbjellur me mollë merr pjesë me 24%, në totalin e sipërfaqes së mbjellur me pemë 8,785 ha, që krahasuar me vitin 2015 ka shënuar rritje prej 5%.

Prodhimtaria e mollës llogaritet 27,485 tonë, e cila mbulon 69% të nevojave të brendshme. Sasia e importuar në vitin 2016, ishte 12,384 tonë, krahasuar me vitin 2015 ka shënuar ulje për 15%, ndërsa ajo e eksportuar ishte 119 tonë për dallim nga viti 2015 që ishte 17 tonë.

Përdorimi vendor sa i përket kulturës së mollës ishte 39,750 tonë, 37,001 tonë janë destinuar për konsum të përgjithshëm, ndërsa 2,749 tonë humbje, për procesim llogariten 2,474 tonë.

Vlera e prodhimit për vitin 2016 ishte 9.9 mil. €, kjo vlerë ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2015, që ishte 7.3 mil. €, bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ edhe për vitin 2016 në vlerë prej 4.0 mil. €.



**Tabela 23: Bilanci i furnizimit për mollën, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me pemë	ha	6,578	6,733	7,071	8,342	6,921	7,998	8,785
Sipërfaqja me mollë	ha	1,661	1,790	1,725	2,024	1,973	1,972	2,076
Pjesëmarrja	%	25.3	26.6	24.4	24.3	28.5	24.7	23.6
Rendimenti	t/ha	7.55	7.55	4.71	8.29	6.85	9.30	13.24
Prodhimi	t	12,545	13,523	8,120	16,786	13,519	18,352	27,485
Importi i mollës	t	12,222	11,085	12,590	13,143	15,808	14,909	12,384
Furnizimi	t	24,767	24,608	20,710	29,929	29,326	33,261	39,869
Eksporti i mollës	t	7	3	45	15	7	17	119
Përdorimi vendor	t	24,760	24,605	20,665	29,914	29,319	33,243	39,750
Shkalla e vet mjaftueshmërisë	%	50.7	55.0	39.3	56.1	46.1	55.2	69.1
Humbjet	t	1,255	1,352	812	1,679	1,352	1,835	2,749
Procesimi	t	1,129	1,217	731	1,511	1,217	1,652	2,474
Vetë konsumi final	t	6,774	7,302	4,385	9,064	7,300	9,910	14,842
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	23,505	23,253	19,853	28,235	27,968	31,408	37,001
Përdorimi vendor total	t	24,760	24,605	20,665	29,914	29,319	33,243	39,750
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.49	0.49	0.54	0.53	0.49	0.44	0.40
Vlera e prodhimit	mn EUR	5.5	6.0	3.9	8.0	6.0	7.3	9.9
Bilanci tregtar i mollës	mn EUR	-3.4	-3.3	-4.1	-4.4	-4.6	-4.9	-4.0

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14) ASK; Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

Kultura e kumbullës merr pjesë me 13% në totalin e sipërfaqes së mbjellur me pemë prej 8,785 ha.

Prodhimi i përgjithshëm vendor ishte 12,722 tonë, i cili mbulon 97% të nevojave vendore për konsum, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga importi.

Në Kosovë, pjesa më e madhe e kumbullave është përdorur për konsum njerëzor 12,249 tonë, për procesim janë destinuar 2,366 tonë ndërsa si humbje llogariten 891 tonë. Vlera e prodhimit të kumbullës ishte 5.6 mil. €, që është 21% më e ulët se në vitin 2015.

Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, në vitin 2016 sasia e kumbullës së importuar është rritur 79% krahasuar me vitin 2015, ndërsa sasia e kumbullës së eksportuar ishte 8 tonë që krahasuar me vitin 2015 është zvogëluar dukshëm.

**Tabela 24: Bilanci i furnizimit për kumbullën, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me pemë	ha	6,578	6,733	7,071	8,342	6,921	7,998	8,785
Sipërfaqja me kumbull	ha	1,063	1,063	1,404	1,843	699	1,518	1,518
Pjesëmarrja	%	16.2	15.8	19.9	22.1	10.1	19.0	17.3
Rendimenti	t/ha	6.54	6.54	12.47	13.26	10.76	11.56	8.38
Prodhimi	t	6,957	6,957	17,514	24,433	7,525	17,543	12,722
Importi i kumbullës	t	313	245	339	311	474	237	425
Furnizimi	t	7,270	7,202	17,853	24,744	7,998	17,780	13,147
Eksporti i kumbullës	t	0	0	2	8	0	81	8
Përdorimi vendor	t	7,270	7,202	17,852	24,736	7,998	17,700	13,139
Shkalla e vetë mjaftueshmërisë	%	95.7	96.6	98.1	98.8	94.1	99.1	96.8
Humbjet	t	487	487	1,226	1,710	527	1,228	891
Procesimi	t	1,294	1,294	3,258	4,545	1,400	3,263	2,366
Vetë konsumi final	t	4,206	4,206	10,587	14,770	4,549	10,605	7,690
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	6,783	6,715	16,626	23,026	7,472	16,472	12,249
Përdorimi vendor total	t	7,270	7,202	17,852	24,736	7,998	17,700	13,139
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.29	0.35	0.40	0.34	0.78	0.43	0.47
Vlera e prodhimit	mn EUR	1.9	2.3	6.5	7.7	5.5	7.0	5.6
Bilanci tregtar i kumbullës	mn EUR	-0.1	-0.1	-0.1	-0.1	-0.2	-0.1	-0.2

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14) ASK; Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

Nga sipërfaqja e përgjithshme e mbjellur me pemë 8,785 ha, dredhëza është kultivuar në sipërfaqe prej 175 ha, që në raport me vitin 2015 ka shënuar zvogëlim të sipërfaqes prej 14%.

Prodhimtaria e dredhëzës ishte 1,328 tonë, dhe mbulon 84% të nevojave vendore për konsum dhe pjesa tjetër mbulohet nga importi.

Për konsum njerëzor janë shfrytëzuar 1,485 tonë, nga totali përdorimit vendor që ishte 1,578 tonë, për procesim janë destinuar 247 tonë, ndërsa si humbje llogariten 93 tonë.

Vlera e prodhimit të dredhëzës ishte 0.7 mil. €, që është 11% më e ulët se në vitin 2016, kjo si rezultat i zvogëlimit të sasië prodhuese dhe nëse i referohemi çmimit shohim se nuk ka pasur dallim me vitin 2015, çmimi ka vazhduar të jetë 0.58 €.

Bilanci tregtar i dredhëzës vazhdon të jetë negativ edhe në vitin 2016, gjatë vitit 2016 sasia e dredhëzës së importuar ishte 297 tonë, 98% më e lartë se në vitin 2015, ndërsa sasia e eksportit ishte 48 tonë.

**Tabela 25: Blicanci i furnizimit për dredhëzën, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me pemë	ha	6,578	6,733	7,071	8,342	6,921	7,998	8,785
Sipërfaqja me dredhëz	ha	49	45	52	148	201	203	175
Pjesëmarrja	%	0.7	0.7	0.7	1.8	2.9	2.5	2.0
Rendimenti	t/ha	6.00	6.00	5.29	3.14	4.81	7.38	7.58
Prodhimi	t	294	270	275	465	965	1,498	1,328
Importi i dredhëzës	t	167	164	169	163	4	150	297
Furnizimi	t	461	434	444	628	968	1,648	1,626
Eksporti i dredhëzës	t	2	11	36	0	2	3	48
Përdorimi vendor	t	459	422	408	628	967	1,645	1,578
Shkalla e vet mjaftueshmërisë	%	64.0	63.9	67.4	74.1	99.8	91.0	84.2
Humbjet	t	21	19	19	33	68	105	93
Procesimi	t	55	50	51	86	179	279	247
Vetë konsumi final	t	178	163	166	281	583	905	803
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	438	403	389	595	899	1,540	1,485
Përdorimi vendor total	t	459	422	408	628	967	1,645	1,578
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.80	1.23	1.03	0.91	1.05	0.58	0.58
Vlera e prodhimit	mn EUR	0.2	0.3	0.3	0.4	0.9	0.8	0.7
Bilanci tregtar i dredhëzës	mn EUR	-0.2	-0.1	-0.1	-0.2	0.0	-0.2	-0.2

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13'15'16); ASK - Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14) ASK; Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

## **Vreshtat**

Totali i sipërfaqes me vreshta në vitin 2016 ishte 3,117 ha, që krahasuar me vitin 2015 ka shënuar rritje për 2%.

Prodhimtaria e rrushit të tryezës llogaritet 6,866 tonë, e cila mbulon 73% të nevojave për konsum ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga importi rreth 2,642 tonë, kurse sasia e eksportuar llogaritet 112 tonë.

Vlera e prodhimit të rrushit të tryezës ishte 5.8 mil. €, që është 9.4% më e ulët se në vitin 2015, kjo si rezultat i uljes së sasisë së prodhimit dhe gjithashtu çmimit. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ edhe në vitin 2016, me 1.2 mil. €.

**Tabela 26: Bilanci i furnizimit për rrush tryeze, 2010-2016**

Zërat e bilancit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sipërfaqja me vreshta	ha	3,140	3,158	3,220	3,159	3,201	3,068	3,117
Sipërfaqja me rrush tryeze	ha	636	648	703	751	781	747	769
Pjesëmarrja	%	20.3	20.5	21.8	23.8	24.4	24	25
Rendimenti	t/ha	9.50	7.00	9.99	9.50	6.23	9	9
Prodhimi	t	6,042	4,536	7,026	7,137	4,869	6,996	6,866
Importi i rrushit të tryezës	t	2,251	2,011	1,764	2,762	2,920	2,025	2,624
Furnizimi me rrush tryeze	t	8,293	6,547	8,790	9,899	7,789	9,021	9,490
Exporti i rrushit të tryezës	t	212	8	454	40	96	28	112
Përdorimi vendor	t	8,081	6,539	8,336	9,859	7,693	8,993	9,379
Shkalla e vetmajftueshmërisë	%	74.8	69.4	84.3	72.4	63.3	78	73
Përdorimi i rrushit të tryezës	t	8,081	6,539	8,336	9,859	7,693	8,993	9,379
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.80	0.93	0.93	0.81	1.02	0.91	0.84
Vlera e prodhimit	mil.€	4.8	4.2	6.5	5.8	5.0	6.4	5.8
Bilanci tregtar	mil.€	-1.2	-1.5	-0.8	-1.2	-1.6	-0.9	-1.2

Burimi: ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari; kalkulime nga DAESB-MBPZHR

Në vitin 2016, sipërfaqja e kultivuar me rrush tryeze në Kosovë është 769 ha. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur varietetet e kultivuara të rrushit të tryezës. Nga këto varietete, pjesa më e madhe e sipërfaqes është kultivuar me varietetin Muskat Hamburg me sipërfaqe prej 255 ha, pasuar nga varieteti Muskat Italian me 176 ha, Afuz Ali me 121 ha, dhe Kardinal me 87 ha. Varietetet tjera kultivohen në sipërfaqe më të vogël dhe përbejnë 130 ha të gjithsej sipërfaqes së kultivuar me rrush tryeze.

**Tabela 27: Varietetet e rrushit të tryezës 2016**

Variatete tryeze		
Nr	Variatetet	Sipërfaqja në ha
1	Muskat Hamburg	255.2
2	Muskat Italian	175.63
3	Afuz Ali	120.81
4	Kardinal	86.59
5	Moldavkë	17.4
6	Ribier	9.85
7	Demir Kapi	9.68
8	Antigona	8.08
9	Rr. tryeze eksperim.	7.98
10	Viktoria	49.44
11	Black Magic	7.38
12	Mbretëresha	1.94
13	Groqanka	0.79
14	Red Globe	4.91
15	Muskat Korrikut	0.88
16	Crimson Seedless	1.95
17	Michele Palieri	8.01
18	Rrush pa farë	2.44
	<b>Gjithsej</b>	<b>768.96</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Në Kosovë ka më shumë se 40 varietete të rrushit që kultivohen për qëllime të ndryshme. Në vitin 2016, sipërfaqja e kultivuar me rrush për verëra ishte 2,348 ha, prej të cilave 1,556 ishin të mbjellura me varietete të kuqe ndërsa 792 ha me varietete të bardha. Nga sipërfaqja e kultivuar me rrush të kuq prinë varieteti Vranac me 441 ha të kultivuar, pasuar nga varieteti Prokupë me 376 ha, varieteti Game me 261 ha, Burgundez i Zi me 164 ha, si dhe lloje tjera që përbëjnë sipërfaqen e kultivuar me varietete të kuqe me gjithsej 314 ha.

Nga sipërfaqja e kultivuar me varietete të bardha, pjesa më e madhe është e kultivuar me varietetin Smederevkë me sipërfaqe 344 ha, pasuar nga Rizlingu Italian me sipërfaqe 225 ha, varieteti Shardone me 86 ha, dhe varieteti Rizling Rajne me 52 ha, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes prej 73 ha është e kultivuar me varietete tjera siç janë Zhuplanka, Krakacitel, Semion, Burgundez i bardhë, Zhillavka, Melnik dhe e bardha e Kladovës.

**Tabela 28: Varietetet e rrushit të verës 2016**

Variatete të kuqe			Variatete të bardha	
Nr	Variatetet	Sipërfaqja në ha	Variatetet	Sipërfaqja në ha
1	Vranac	441.18	Smederevkë	343.65
2	Prokupë	376.34	R. Italian	225.43
3	Game	261.45	Shardone	97.61
4	Burgundez i Zi	164.25	R. Rajne	52.39
5	Zhametë	108.79	Zhuplanka	22.23
6	Kabernet Sauvignon	57.71	Rrakacitel	11.67
7	Game me ngjyrë	22.81	Semion	8.9
8	Frankovke	30.6	Burgundez i Bardhë	12.47
9	Merlot	34.82	Zhillavka	3.17
10	Kabernet Frank	23.03	E bardha e kladoves	3.18
11	Syrah	3.98	Melnik	11.49
12	Pllovdin	18.61		
13	Shaslla e kuqe	0.52		
14	Petit Verdo	1.49		
15	Carmonere	3.98		
16	Te tjera	4.97		
17	E hershmja e Opuzenit	1.22		
18	Sheshi i zi	0.26		
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,556.01</b>		<b>792.19</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

## Verërat

Viti 2016 ka shënuar rënie të prodhimit të verës në Kosovë. Një ndër arsytet ishin kushtet klimatike ku breshëri shkaktoi mjaft dëme të vreshtave. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 kishte 10% rënie të prodhimit të verës gjithsej. Nëse krahasojmë prodhimin e verës së kuqe dhe të bardhë, nuk ka shumë dallim në rënie ku vera e kuqe ka shënuar 9% rënie ndërsa vera e bardhë 11%. MBPZHR-ja në vazhdimësi e ka mbështetur këtë sektor përmes granteve dhe subvencioneve me qëllim të shtimit të sipërfaqeve me vreshta të reja me rrush tryeze, e po ashtu përmirësimin e cilësisë, teknologjisë prodhuese dhe llojlojshmërisë, duke ndikuar kështu në stimulimin e eksportit drejt tregjeve të huaja.

**Tabela 29: Prodhimi i verës 2011-2016**

Prodhimi	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(‘13-‘15 në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Verë e kuqe	1000 l	1,118	2,518	3,659	3,271	6,034	5,506	27	-9
Verë e bardhë	1000 l	403	2,769	4,023	1,482	4,044	3,613	14	-11
Gjithsej verë	1000 l	1,521	5,287	7,682	4,753	10,078	9,119	22	-10

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura 19 kompani të cilat merren me përpunimin e rrushit. Nga kompanitë e listuara në këtë tabelë, në vitin 2016 vërejmë se kompania "Stone Castle Vineyards & Winery" prin me më së shumti prodhim të verës me sasi prej 43,752 hl, pasuar nga kompania "Sunny Hills" me 20,058 hl të prodhuar të verës, kompania "Haxhijaha" me 9,956 hl, kompania "Stone Castle" me 9,896 hl, dhe kompanitë tjera me një sasi prej 7,525 hl. Nga totali i sasisë së prodhuar të verës nga 19 kompanitë e paraqitura në tabelë në vitin 2016, sasia e prodhuar e verës së bardhë ishte 36,131 hl, ndërsa verës së kuqe dhe verës rose 55,056 hl.

**Tabela 30: Prodhimi i verës sipas kompanive në vitin 2016**

Nr		Verë e bardhë/hl	Verë e kuqe/hl	Verë Rose/hl	Gjithsej verë/hl	Rrush për destilim/hl
1	Shpk "Stone Castle Vineyards&Winery" L.L.C	16,704.73	26,547.13	500.00	43,751.86	8,815.29
2	"Stone Castle" L.L.C	6,653.54	3,192.28	49.79	9,895.61	0.00
3	NTP "Haxhijaha"	4,008.02	5,906.45	42.00	9,956.47	38.85
4	NPT " Sunny Hills"	6,193.66	13,864.32	0.00	20,057.98	0.00
5	"Biopak Shpk"	1,316.53	1,033.24	0.00	2,349.77	335.68
6	Shpk"Rahoveci"	59.72	121.47	0.00	181.19	6.71
7	NPT"Rahvera - AB"	55.00	177.69	0.00	232.69	25.80
8	NTP "Daka"	31.00	148.55	0.00	179.55	8.55
9	NPT"Bahha"	35.05	268.69	0.00	303.74	7.29
10	NTP "Agro-alf"	36.86	263.29	0.00	300.15	9.75
11	NTP "Sefa"	20.73	279.82	0.00	300.55	67.19
12	Shpk "Dea"	0.00	17.00	0.00	17.00	2.46
13	"Kosova Wine" sh.p.k	625.54	1,982.89	0.00	2,608.43	24.53
14	N.P.SH. "Albatros"	40.00	46.00	0.00	86.00	15.00
15	N.P.T " Astra - Vera"	30.82	21.00	0.00	51.82	2.06
16	NPT " Tradita"	0.00	90.00	0.00	90.00	0.00
17	Dardania Wine sh.p.k.	20.00	130.00	0.00	150.00	0.00
18	NTP "Muja"	300.00	227.77	0.00	527.77	0.00
19	"Gëzim Vuqiterna B.I."	0.00	146.34	0.00	146.34	5.67
	<b>Gjithsej</b>	<b>36,131.20</b>	<b>54,463.93</b>	<b>591.79</b>	<b>91,186.92</b>	<b>9,364.83</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

### **Analizat fiziko - kimike të verës për vitet 2013 - 2016, në laboratorin e Enologjisë në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë**

Gjatë vitit 2016, në laboratorin e enologjisë janë realizuar 344 analiza fiziko - kimike ku, 82 ishin mostra për treg të brendshëm, 162 mostra për eksport dhe 100 mostra për import, ndërsa në vitet si në vijim 2015 gjithsej janë realizuar 315 analiza, 2014 janë realizuar 387 dhe në 2013 janë realizuar gjithsej 294 analiza fiziko - kimike.

**Tabela 31: Analizat fiziko - kimike të verës për vitet 2013 - 2016**

Viti	2013	2014	2015	2016
Mostra treg i brendshëm	64	74	60	82
Mostra eksport	230	208	150	162
Mostra import	0	105	105	100
<b>Totali</b>	<b>294</b>	<b>387</b>	<b>315</b>	<b>344</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari

## 2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra

Sipërfaqja dhe prodhimtaria e kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra u rritën, përveç barit sipërfaqja e të cilit u zvogëlua për 13% dhe prodhimtaria për 29%. Rritja në prodhimtari ishte më e madhe në krahasim me rritjen në sipërfaqe si rezultat i rritjes së rendimentit. Prodhimtaria e misrit të gjelbër u rrit më shumë se dyfishi i vitit 2015 pasi që rritja në sipërfaqe prej 30% u shoqërua me rritje në rendiment për 65%. Rritje mbi 50% në prodhimtari shënoi edhe tërfili, e kjo ishte kryesisht rezultat i rritjes në sipërfaqe për 45% ndërsa rendimenti shënoi rritje për 5%.



**Tabela 32: Sipërfaqja, prodhimtaria, rendimenti i kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra, 2010-2016**

Kultura	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13-15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>							<b>%</b>	
Foragjere dhe drithëra të kositura të gjelbëra	99,043	98,833	94,444	110,314	26,554	97,183	97,936	-	-
Misër (i gjelbër)	1,062	1,032	2,511	4,294	2,414	2,256	2,943	-2	30
Sanë (livadhe)	74,952	76,386	72,048	81,924	-	68,711	69,021	-8	0
Bari	2,733	1,645	3,677	5,036	6,689	9,809	8,575	19	-13
Jonxhë	14,678	14,707	13,330	15,495	15,011	15,109	15,190	0	1
Tërfil	2,582	2,577	1,328	1,502	2,085	526	765	-44	45
Foragjeret e tjera të gjelbëra	3,035	2,486	1,550	2,063	355	772	1,440	35	86
<b>Prodhimtaria</b>	<b>t</b>							<b>%</b>	
Foragjere dhe drithëra të kositura të gjelbërta	398,556	396,049	259,522	393,087	151,095	317,888	390,707	-	-
Misër (i gjelbër)	15,944	15,493	28,006	82,050	36,434	31,633	68,219	36	116
Sanë (livadhe)	208,058	212,037	166,519	217,155	-	194,768	225,813	10	16
Bari	9,269	5,578	8,980	14,836	19,575	31,028	21,936	1	-29
Jonxhë	145,054	145,054	46,828	60,869	86,583	53,368	63,522	-5	19
Tërfil	8,009	7,994	3,908	5,889	6,924	1,784	2,715	-44	52
Foragjeret e tjera të gjelbëra	12,223	9,893	5,281	12,288	1,579	5,308	8,502	33	60
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>							<b>%</b>	
Misër (i gjelbër)	15.01	15.01	11.15	19.11	15.09	14.02	23.18	44	65
Sanë (livadhe)	2.78	2.78	2.31	2.65	-	2.83	3.27	19	15
Bari	3.39	3.39	2.44	2.95	2.93	3.16	2.56	-15	-19
Jonxhë	9.88	9.86	3.51	3.93	5.77	3.53	4.18	-5	18
Tërfil	3.10	3.10	2.94	3.92	3.32	3.39	3.55	0	5
Foragjeret e tjera të gjelbëra	4.03	3.98	3.41	5.96	4.45	6.87	5.90	3	-14

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14);

\*Në vitin 2014 në sipërfaqen dhe prodhimtarin e përgjithshme nuk është përfshirë sana

## 2.6 Kulturat industriale

Kulturat industriale kultivohen në sipërfaqe të vogël në Kosovë, janë të mbjellura gjithsej 389 ha, ku prodhimtaria totale është 1,028 tonë. Sipërfaqja në vitin 2016, është rritur për 43 ha apo për 12% në krahasim me vitin 2015.

**Tabela 33: Sipërfaqja dhe prodhimtaria e kulturave industriale, 2015-2016**

	2015	2016
Sipërfaqja në ha	346	389
Prodhimtaria në tonë	757	1,028

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore 2015, 2016

## 2.7 Materiali fidanor

Prodhimtaria e materialit fidanorë të pemëve në Kosovë ka një traditë dhe favorizohet nga kushtet pedoklimatike të përshtatshme për rritjen dhe prodhimin cilësor të tyre. Këtë gjë e dëshmon shtrirja e tyre në regionet e Kosovës si dhe ekzistenca e një numri të madh kultivarësh (sidomos të mollës).

Pas luftës, në fidanishtet e Kosovës, materiali fidanor prodhohej kryesisht me metodën klasike të shartimit me syth të fjetur ku fidanët përfitoheshin për dy vite, kjo nënkupton prodhim të fidanëve me kosto të lartë, dhe shpesh herë materiali fidanor i prodhuar rezultonte me cilësi të dobët, kryesisht ka dominuar prodhimi i fidaneve me nënshartesa gjenerative. Mirëpo, viteve të fundit është rritur në mënyrë të dukshme interesimi i fermerëve për regjistrimin e fidanishteve të tyre si dhe për shtimin e sipërfaqeve të tyre. Faktorë bazë për këtë është elementi "fidanë" i cili po vlerësohet me të gjitha parametrat e vetë kryesorë siç është cilësia, pastërtia varietore dhe origjina e tij. Pikërisht këtu vërehet ndryshimi, që gradualisht po shndërrohet në bindje për të gjithë ata që merren me material fidanor të pemëve. Nga e gjitha kjo që u tha deri me tani, sektori i pemëtarisë e veçanërisht prodhimtaria e fidanëve, konsiderohet sektor me rendësi ekonomike për bujqësinë kosovare ku vitet e fundit po i kushtohet një mbështetje dhe zhvillim më i madh nga MBPZHR. Vlen të theksohet se nga viti 2013, ka filluar realizimi i programit për pagesa direkte në sektorin e materialit fidanorë të pemëve me 0.20 € për fidanë të pemëve dhe fidaneve të hardhisë së rrushit të prodhuara mbi nënshartesa vegjetative. Kjo mbështetje ka pas efekt në rritjen e cilësisë së materialit fidanor, rritjen e prodhimit si dhe zvogëlimin e importit të fidaneve të pemëve.

Ligjin Nr. 2004/13 mbi materialin fidanor rregullon çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin, tregtimin, importimin, eksportimin, kontrollin si dhe regjistrimin e prodhuesve, importuesve dhe tregtuesve të materialit fidanor.

Në Ligjin për Materialin Fidanorë Nr.2004/13 deklarimi i prodhimit të materialit fidanorë të pemëve është i obliguar. Prandaj duke ju referuar UA. Nr.7/2007 "Për mbajtjen, formën dhe procedurat e mbajtjes së shënimeve mbi sasinë, llojin dhe varietetin e materialit fidanorë të prodhuar, tregtuar dhe asgjësuar", për prodhuesit e materialit fidanorë që nga viti 2006-2016 nga prodhuesit e materialit fidanorë të pemëve çdo vit është bërë deklarimi i prodhimtarisë së materialit fidanorë të pemëve.

- Nga inspektorët fitosanitarë bëhet shpërndarja zyrtare/grumbullimi i librave "Për mbajtjen, formën dhe procedurat e mbajtjes së shënimeve mbi sasinë, llojin dhe varietetin e materialit fidanorë të prodhuar, tregtuar dhe asgjësuar"
- Në DPBT bëhet përpunimi i të dhënave në programin excel.

Sipas të dhënave statistikore të përgatitura nga DPBT në formë tabelare është paraqitur prodhimi i fidaneve të pemëve nga viti 2006-2016.

**Tabela 34: Prodhimi i fidanëve të pemëve me nënshartesa gjenerative dhe vegetative për vitet 2006-2016**

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Nënshartesat vegetative	30,000	44,745	57,477	60,034	107,834	200,110	339,371	646,024	469,636	564,785	477,303
Nënshartesat gjenerative	80,254	95,123	97,758	124,866	187,961	200,211	176,665	196,828	182,919	86,920	134,995
<b>Totali</b>	<b>110,254</b>	<b>139,868</b>	<b>155,235</b>	<b>184,900</b>	<b>295,795</b>	<b>400,321</b>	<b>516,036</b>	<b>842,852</b>	<b>652,555</b>	<b>651,705</b>	<b>612,298</b>

Burimi: DPBT / MBPZHR

Në bazë të dhënave të deklaruara nga prodhuesit e materialit fidanor për vitin 2016, dominon prodhimi i fidaneve të kulturës së mollës në sasi prej: 415,804 fidane prej të cilave me nënshartesa vegetative janë 386,499 fidane /M9, M27, M26, MM106, MM 111, M25.

## 2.8 Ujitja e tokës bujqësore

Ujitja si një proces mjaft i rëndësishëm për tokën bujqësore në Kosovë, organizohet në forma të ndryshme.

Format e ujitjes të cilat fermerët tanë i përdorin janë, ujitja formale e organizuar përmes kompanive të ujitjes pastaj kemi mënyrën e ujitjes jo formale, ujitjen e pa organizuar dhe ujitjen individuale e cila bëhet nga burime të ndryshme ujore si lumenj, puse, etj.

Kosova ka një qëndrueshmëri të mirë me rezervat ujore, ku kapaciteti i vlerësuar për kokë banori është rreth 1,600 m<sup>3</sup> edhe pse shpërndarja vazhdon të jetë e pabarabartë.

Duke ju referuar të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale për bujqësi, është vlerësuar se gjatë vitit 2016, janë ujitur rreth 21,775.81 ha në dy forma të ujitjes: ujitje formale si dhe ujitje jo formale.

Vlerësohet se nga ujitja formale përmes ndërmarrjeve, janë ujitur gjithësej 15,573.41 ha tokë bujqësore, ndërsa nga lumenjtë 4,018.8 ha dhe nga pusët 2.183.8 ha, tokë bujqësore. Të gjitha këto të dhëna janë të shprehura në tabelën në vijim në bazë të komunave, burimit të ujitjes, kulturës së ujitur si dhe sipërfaqes së ujitur e shprehur në ha.

Nga të dhënat e raportuara nga derjtoritë komunale, disa nga komunat kanë raportuar që nuk kanë sipërfaqe nën ujitje si Dragashi, Skënderaj, Malisheva, etj. Shumica e kulturave të cilat ujitjen janë misri, pemët dhe perimet duke mos përjashtuar edhe sektorët tjerë të cekur në tabelë.

**Tabela 35: Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2016**

Komuna	Burimi i ujitjes	Kulturat e ujitura	Sip. ujitur / ha
Deçani	Drini i Bardhë	Misër,pemë perime	122
Gjakova	Radoniqi, lumenj, puset	Perime,misër,shalqi	2,147
Gllgovci	Ibër-Lepenci	Perime, misër,jonxhë	290
Gjilan	Puset	Perime,serra,fushë të hapur	337
Istog	Drini i Bardhe	Misër, pemë,perime	624
Kaçanik	Lumenj	Misër,fasule,perime	510
Klina	Drini i Bardhë	Misër,perime,pemë	1,525
F.Kosova	L.Drenica, puse	Misër,jonxhë,perime	210
Kamenica			39
Mitrovica	Ibër-Lepenc	Perime,misër	720
Lipjan	Puset		106
Novobërda			25
Obiliq	Ibër-Lepenc	Misër,pemë,perime	495
Rahovec	Radoniqi	Perime,misër,shalqi	3,353
Peja	Drini i bardhë	Misër, pemë, perime	2,570
Podujevë	Lumi Llap, puset	Perime,misër,pemë	658
Prishtinë	Ibër-Lepenc	Patate,misër	231
Prizren	Radoniqi, Dukagjini	Misër, perime, foragjere	2,631
Shtime	Puse, lumenj	Perime, pemë,jonxhë	100
Shtërpca	Lumi lepec,	Misër,perime pemë	1,450
Suhareka	Lumenj,puse	Perime,pemë,jonxhë, lavërtari	615
Ferizaj	Lumenj,puse	Pemë,perime, misër	313
Vitja	Puse	Shalqi,patate	261
Vushtrri	Ibër-Lepenc	Patate,lakër,misër	1,000
Mamusha	Puse, lumenj	Perime, misër	405
Junik	Drini i Bardhë	Jonxhë,misër,patate	231
Klllokoti	Puset		381
Graçanica	Lumi, puse	Misër	350
Parteshi	Puse	Perime,miser,jonxhë	66

Burimi: Departamenti i Politikave Bujqësore dhe i Tregtisë

## 2.9 Gjdhët

Gjdhët janë kategoria më e rëndësishme në kuadër të blegtorisë, ato përbëjnë 51% të totalit të krerëve blegtoral. Sa i përket strukturës së fondit të gjedheve, 52% kanë pjesëmarrje lopët qumështore, pasuar nga kategoria e viçave nën 1 vjet me 32% dhe kategoritë e tjera të gjitha së bashku me 16%. Shikuar në aspektin e grupmohave, kategoria gjedhe të moshës 2 e më shumë vjeç përbën 59%, pasuar nga kategoria gjedhe të moshës më pak se një vjet 32% dhe kategoritë gjedhe të moshës 1 deri në më pak se 2 vjet me 9%. Në kategorinë gjedhe të moshës nën 1 vjet dominojnë meshkujt me 54% ndërsa femrat kanë pjesëmarrje prej 46%. Për dallim nga kjo kategori, në kategorinë 1 deri në më pak se 2 vjeç dominojnë femrat me 54% ndërsa meshkujt kanë pjesëmarrje prej 46%.

Në vitin 2016, fondi i gjedheve është rritur për 3% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa nëse e krahasojmë me mesataren e tri viteve paraprake është zvogëluar për 6%. Numri i lopëve qumështore është rritur për 1% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa krahasuar me mesataren e tri viteve paraprake ka pasur rënie të numrit të lopëve qumështore për 9%.

**Tabela 36: Fondi dhe struktura e gjedhëve, 2010-2016**

Numri i kafshëve	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Fondi i gjedheve	356,496	361,688	329,213	321,113	261,689	258,504	264,971	-6	3
Viça meshkuj nën 1 vjet*	74,438	76,283	66,575	65,298	47,357	45,235	45,443	-14	0
Viça femra nën 1 vjet*	56,673	58,078	50,687	49,715	36,055	36,108	38,124	-6	6
Viça meshkuj 1-2 vjet*	12,870	13,375	12,333	10,756	14,351	9,007	11,756	3	31
Viça femra 1-2 vjet*	9,798	10,182	9,389	8,188	10,925	13,737	13,967	28	2
Meshkuj mbi 2 vjet*	3,247	3,223	2,538	2,831	2,872	2,639	7,044	153	167
Mëshqerra*	4,486	4,392	4,351	5,768	13,920	12,138	11,344	7	-7
Lopë qumështore	194,984	196,155	183,340	178,557	134,393	135,801	136,783	-9	1
Lopë të tjera	-	-	-	-	1,816	3,839	510	-82	-87

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12-'13, '15-'16); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); \* Vlerësime DAESB ('09-'13);

Numri i përgjithshëm i gjedheve në vitin 2016 ishte 264,971 krerë e që krahasuar me vitin 2015 kishte rritje për 3%. Sa i përket therjes, 116,849 krerë janë therur në vitin 2016 që d.m.th më shumë se në vitin 2015 për 1.4%. Vlera e prodhimit të përgjithshëm ishte 40.9 mil. €, ndërsa vlera e importit 29.4 mil. €. Me këtë sasi të prodhimit shkalla e vetë-mjaftueshmërisë është 61.9% dhe konsumi për kokë banori është 18.2 kg.

**Tabela 37: Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2010-2016**

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Fondi i gjedheve	krerë	356,496	361,688	329,213	321,113	261,689	258,504	264,971
Lopë qumështore	krerë	194,984	196,155	183,340	178,557	134,393	135,801	136,783
Totali i therjeve	krerë	165,371	172,433	162,292	156,062	128,372	115,195	116,849
Totali i prodh. vendor në p.th.	mil. kg p.th.	27.8	29.6	27.9	26.7	22.8	19.7	20.0
Totali i importeve	mil. kg p.th.	12.5	10.1	9.2	11.5	10.4	13.0	12.3
Furnizimi në p.th.	mil. kg p.th.	40.2	39.6	37.1	38.3	33.2	32.7	32.3
Totali i eksporteve	mil. kg p.th.	0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Konsumi	mil. kg p.th.	40.1	39.6	37.1	38.3	33.2	32.7	32.3
Vlera e prodhimi në p.th.	mil. EUR	55.0	63.5	60.0	58.6	50.5	41.4	40.9
Totali i importeve	mil. EUR	25.5	25.0	24.0	27.8	23.8	33.5	29.4
Bilanci tregtar	mil. EUR	-25.1	-24.9	-23.9	-27.7	-23.8	-33.5	-29.3
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	69.3	74.7	75.3	69.8	68.7	60.4	61.9
Konsumi për kokë banori	kg p.th.	18.4	22.7	20.4	21.0	18.4	18.4	18.2

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12-'13, '15-'16); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZHR;

Në vitin 2016, lopët qumështore përfaqësojnë 52% të numrit të përgjithshëm të gjedheve. Nga furnizimi i përgjithshëm 80% ishte prodhim vendor dhe pjesa tjetër është mbuluar nga importet. Prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vitin 2016 ishte 285 mijë tonë, e që është më i lartë sesa në vitin 2015 sepse numri i lopëve qumështore ishte më i madh. Bilanci tregtar mbetet negativ me 26.8 mil. €. Konsumi për kokë banori ishte 198 kg në vit që do të thotë se një person konsumon rreth 0.5 kg në ditë duke përfshirë qumështin dhe produktet e fazës së parë të procesimit.

**Tabela 38: Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2010-2016**

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Lopë qumështore	krerë	194,984	196,155	183,340	178,557	134,393	135,801	136,783
Prodhimi i qumështit	t	390,065	393,389	368,605	369,702	278,933	282,534	285,261
Importi	t (p.e.)	71,252	75,960	72,371	66,582	67,863	67,491	69,284
Furnizimi	t (p.e.)	461,318	469,349	440,976	436,284	346,796	350,025	354,545
Eksporti	t (p.e.)	604	360	110	422	378	800	745
Përdorimi vendor	t (p.e.)	460,714	468,989	440,867	435,862	346,418	349,224	353,800
Shkalla e vetë- mjaftueshmërisë	%	84.7	83.9	83.6	84.8	80.5	80.9	80.6
Humbjet	t (p.e.)	7,801	7,868	7,372	7,394	5,579	5,651	5,705
Konsumi për ushqim të viçave në fermë	t (p.e.)	57,340	57,828	54,185	54,346	41,003	41,532	41,933
Procesimi	t (p.e.)	34,951	35,684	33,578	33,046	26,690	26,868	27,247
Konsumi njerëzor	t (p.e.)	360,622	367,609	345,731	341,075	273,146	275,173	278,914
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.29	0.31	0.32	0.33	0.33	0.30	0.30
Vlera e prodhimit	mil EUR	94.2	101.6	98.3	101.6	76.7	70.6	71.3
Bilanci tregtar	mil EUR	-22.6	-24.5	-25.4	-23.4	-25.5	-25.5	-26.8

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12-'13,'15,'16 ); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZHR

## 2.10 Dhentë dhe dhitë

Dhentë dhe dhitë për nga numri përbëjnë 40% të numrit total të kafshëve. Numri i dhenve dhe dhive në vitin 2016 është 212,040 krerë apo 5% më i ulët sesa në vitin 2015, ndërsa krahasuar me mesataren e viteve '13-'15, ky numër është për 3% më i vogël. Sipas kategorive numri i dhenve në vitin 2016 është zvogëluar për 5% ndërsa numri i dhive për 9%. Rritje të numrit të dhive për 2% ka pasur kur krahasojmë vitin 2016 me mesataren e tri viteve të fundit, ndërsa numri i dhenve është zvogëluar për 3%.

Nga kategoria e dhenve në vitin 2016, dele për mbarështim janë 77%, ndërsa pjesa tjetër janë qengja, desh etj. Nga totali i deleve për mbarështim 87% janë dele që kanë pjellë ndërsa 13% të mbarësuara për herë të parë. Tek dhitë nga numri total prej 27,775 krerë, rreth 88% janë dhi për mbarështim ndërsa pjesa tjetër janë: keca, cjep etj. Nga totali i dhive për mbarështim, 81% janë dhi që kanë pjellë ndërsa 19% dhi të mbarësuara për herë të parë.

Dallimet deri në 10% konsiderohen normale sepse fermerët në varësi nga kushtet financiare janë të detyruar ti shesin krerët e tyre për arsye se gjatë sezonit të dimrit ato konsumojnë më shumë se sa prodhojnë, për fermerin kjo është e kushtueshme kështu që ata bëjnë shitjen e tyre për destinime të ndryshme. Mirëpo ka vit të caktuar kur fermerët i mbajnë rrunëzat dhe ftujat, kështu që me mbajtjen dhe rritjen e tyre fondi rritet 5 deri në 10%. Në vitin 2016 kishte edhe raste të paraqitjes së sëmundjes së brucelozës.

**Tabela 39: Numri i dhenve dhe dhive, 2010-2016**

Numri i kafshëve	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Dhen dhe dhi	229,157	231,209	247,901	216,577	212,014	224,096	212,040	-3	-5
Dhentë	204,988	206,528	221,438	193,458	183,584	193,703	184,265	-3	-5
Dele për mbarështim	163,490	163,490	175,293	153,144	146,924	148,956	141,995	-5	-5
Krerë të tjerë (qengja, desh, etj)	41,498	43,038	46,145	40,314	36,660	44,747	42,270	4	-6
Dhitë	24,169	24,681	26,463	23,119	28,430	30,393	27,775	2	-9
Dhi për mbarështim					23,575	26,310	24,315	-3	-8
Krerë të tjerë (keca, cjep, etj)					4,855	4,083	3,460	-23	-15

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16 ); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14)

Prodhimtaria e dhenve dhe dhive si aktivitet bujqësor që kryesisht zhvillohet në zonat e thella rurale është aktivitet i orientuar në prodhimtari të mishit, ndërsa konsumi i qumështit është më i ulët dhe kryesisht përdoret për prodhimin e djathit. Në vitin 2016 prodhimi i mishit të dhenëve dhe dhive vlerësohet të jetë rreth 2,146 tonë në peshë të therur, importi në krahasim me prodhimtarinë vendore është shumë i ulët dhe Kosova arrin ti plotësoj nevojat vendore për konsum rreth 99%. Vlera e prodhimit në vitin 2016 është 5.2 mil. € ndërsa vlera e bilancit tregtar është -0.1 mil. €. Konsumi për kokë banori llogaritet të jetë rreth 1.2 kg/vit.

**Tabela 40: Bilanci i furnizimit për mishin e dhenve dhe dhive, 2010-2015**

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Fondi i dhenve	krerë	204,988	206,528	221,438	193,459	183,584	193,703	184,265
Fondi i dhive	krerë	24,169	24,681	26,463	23,119	28,430	30,393	27,775
Therjet	krerë	212,431	217,228	223,448	193,870	184,467	195,284	185,069
Prodhimi (p.th)	t	2,410	2,455	2,559	2,226	2,142	2,267	2,146
Importet neto (p.th)	t	63	27	630	48	36	26	19
Përdorimi vendor (p.th)	t	2,473	2,482	3,189	2,274	2,178	2,293	2,165
Vlera e prodhimit	mil. EUR	5.3	5.7	6.2	5.6	5.4	5.6	5.2
Bilanci tregtar	mil. EUR	-0.1	-0.1	-0.7	-0.2	-0.1	-0.1	-0.1
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	97	99	80	98	98	99	99
Konsumi për kokë banori (p.th)	kg	1.1	1.4	1.8	1.2	1.2	1.3	1.2

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16 ); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZHR

## 2.11 Derrat dhe kafshët tjera të fermës

Sektori i derrërisë në Kosovë është më pak i zhvilluar në krahasim me sektorët e tjerë blegtoral, numri i derrave në vitin 2016, ishte 42,309 që për dallim nga viti paraprak ishte për 4% më i vogël, ndërsa krahasuar me numrin mesatar gjatë tri viteve paraprake ishte pothuajse i njëjtë. Sa i përket strukturës së derrave në vitin 2016, 36% ishin gica me peshë nën



20 kg, 13% derra me peshë prej 20-50 kg, 20% derra për majmëri, 27% dosa dhe 4% harça për riprodhim.

Prej numrit total të derrave për majmëri shumica, përkatësisht 40% e tyre kanë peshë prej 110 kg e më shumë, 32% peshë prej 51-79 kg dhe pjesa tjetër prej 28% kanë peshë prej 80-109 kg. Sa i përket dosave, 57% janë dosa që kanë pjellë, 21% dosa të mbarësuara për herë të parë, 18% të pa mbarësuara dhe 4% dosa të tjera.

Numri i kuajve, gomarëve dhe mushkave në vitin 2016 është zvogëluar për 9% krahasuar me vitin 2015, ndërsa në krahasim me numrin mesatar në tri vitet paraprake ulja ka qenë 17%.

**Tabela 41: Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2010-2016**

Numri i kafshëve	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13- 15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Derra	50,580	50,580	55,775	49,198	34,188	44,149	42,309	0	-4
Kuaj, gomarë dhe mushka	4,429	4,429	2,139	2,929	2,980	2,577	2,353	-17	-9

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14)

## 2.12 Shpeztaria

Në vitin 2016, numri i përgjithshëm i shpezëve në Kosovë është rritur për 6% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa në krahasim me mesataren e tri viteve paraprake rritja është 9%. Nga numri i shpezëve, 94% janë pula ndërsa pjesa tjetër prej 6% janë biba, rosa, pata dhe shpezë të tjera. Sa i përket strukturës së pulave, 79% janë pula vojse, 8% brojlerë dhe 13% të tjera (zogj, gjela dhe pula të tjera). Në Kosovë numri i pulave vojse në ekonomitë bujqësore që kanë më shumë se 2,000 pula vojse është 732,400 copë dhe janë 79 ekonomi që posedojnë pula vojse mbi këtë numër ndërsa pjesa tjetër prej 1.3 mil. pula vojse janë në ferma familjare. Nga numri total i brojlerëve, janë 7 ekonomi bujqësore që kanë mbi 5,000 brojler dhe numri i brojlerëve në këto ferma është 90,500, ndërsa janë edhe 105,778 brojlerë në ferma më të vogla.

Në vitin 2016, prodhimi i vezëve në fermat komerciale vlerësohet të jetë rreth 220 mil. vezë ndërsa në kuadër të ekonomive familjare prodhohen edhe rreth 131 mil. copë që rezulton me një prodhimtari totale 351 mil. vezë. Në vitin 2016, janë importuar rreth 6.8 mil. vezë në vlerë prej 413.8 mijë €. Shqipëria është vendi nga i cili janë importuar 78% e vezëve në vitin 2016 pasuar nga, Bullgaria, Maqedonia, Greqia ndërsa nga Austria, Gjermania dhe Italia ka pasuar një sasi shumë të vogël të importit. Ndërsa eksport ka pasur vetëm në Shqipëri. Konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë 201 vezë/vit dhe mund të themi se Kosova plotëson rreth 98% të nevojave për konsum të vezëve.

Në vitin 2016, prodhimi i mishit të pulës vlerësohet të jetë rreth 2,439 tonë duke marr parasysh faktin se sektori i shpeztarisë është i orientuar kryesisht në prodhimtarinë e vezëve për konsum dhe prodhimin e zogëzave kurse prodhimtaria e mishit të zogut është në fazën e

konsolidimit. Në vitin 2016 importi i mishit të pulës ka qenë rreth 35,918 tonë, nga e cila 70% është importuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Brazili, 5% nga Mbretëria e Bashkuar, nga 4% nga Polonia dhe Gjermania ndërsa pjesa tjetër prej 17% nga vendet e tjera. Konsumi mesatar për kokë banori në Kosovë vlerësohet rreth 21.5 kg /vit. Me prodhimtarinë aktuale Kosova arrin të mbuloj vetëm 6.4% të nevojave për konsum.

**Tabela 42: Numri i shpezëve dhe vezëve 2010-2016, në 1000 krerë**

Numri i shpezëve (1000)	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13-15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Shpezë	2,347	2,347	2,318	2,244	2,692	2,576	2,740	9	6
Pula	2,220	2,220	2,250	2,108	2,584	2,492	2,586	8	4
Brojler					194	304	196		-35
Pula për vezë					1,704	1,874	2,043		9
Zogj, gjela dhe pula të tjera					687	314	347		10
Biba					45	63	108		73
Shpezë të tjera (Rosa, Pata etj.)	127	127	68	136	62	22	46	-38	113
Vezë*	231,608	224,582	218,282	176,078	357,138	361,197	350,827	18	-3

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16 ); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14); \*Vlerësime: DPBT ('09-'11), SHPUK ('12-'13), DAESB ('14-'16)

## 2.13 Bletaria

Mbështetja e vazhdueshme që i është bërë sektorit të bletarisë ka ndikuar që edhe numri i koshereve të rritet në vazhdimësi. Për herë të parë mbështetja e këtij sektori përmes pagesave direkte është bërë në vitin 2012, duke vazhduar vit pas vit me rritje të numrit të koshereve të subvencionuara por edhe me rritje të numrit të përgjithshëm të koshereve. Në vitin 2016 numri i koshereve është rritur për 33% në raport me mesataren e tri viteve paraprake, ndërsa krahasuar me vitin e fundit rritja ka qenë 3%.

**Tabela 43: Numri i koshereve të bletëve, 2010-2016**

Numri i koshereve	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/(13-15) në %	Ndryshimi 2016/2015 në %
Koshere bletësh	46,958	44,634	46,483	93,533	116,172	157,005	162,355	33	3


Burimi: ASK - Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12,'13,'15,'16 ); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '10-'11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14)

Prodhimtaria e mjaltit në vitin 2016 ishte shumë më e ulët sesa në vitin 2015, e kjo si rezultat i kushteve atmosferike. Në vitin 2016 janë importuar 200 tonë mjaltë që në krahasim me vitin 2015, sasia e importuar ishte për 13% më e madhe ndërsa eksport të mjaltit nuk kishte. Duke marr parasysh prodhimtarinë vendore si dhe sasinë e importuar, në Kosovë në vitin 2016 janë konsumuar 768 tonë mjaltë, pra një banor i Kosovës ka konsumuar 0.4 kg gjatë vitit. Mbulimi i nevojave për konsum nga prodhimtaria vendore ishte 74 %.

### 3 Pylltaria

Kosova karakterizohet me një sipërfaqe të qëndrueshme pyjore me rreth 481,000 ha (45% e sipërfaqes totale). Shpërndarja e përdorimit të tokës është llogaritur në bazë të klasifikimit të 3,453 sipërfaqeve pronë të Kosovës. Figura më poshtë ilustron shpërndarjen e sipërfaqeve, ku shihet se përqindja më e madhe i takon pyjeve, pastaj tokës bujqësore, livadheve/kullosave, dhe të tjerave.

**Figura 20: Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës)**



Burimi: INP

Pyjet e Kosovës janë të dominuara nga pyjet fletore, duke mbuluar 93% (449,400 ha) të sipërfaqeve pyjore, ku më shumë se gjysma janë një-moshare, ndërsa, 5% (23,800 ha) e sipërfaqeve pyjore mbulohet nga pyjet halore të cilat janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në mes të klasave të ndryshme të strukturës. Plantacionet e pishave kontribuojnë në sipërfaqet një-moshare. Në total, 50% e sipërfaqes pyjore është konsideruar një-moshare.

**Tabela 44: Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit (ha)**

Përbërja pyjeve	Rigjenerimi	Një-moshar	Dy-katësh	Shumë-moshar	Totali
Halorë	2,200	6,600	6,200	8,800	23,800
Përzier	0	400	3,200	4,200	7,800
Fletorë	45,400	236,000	123,600	44,400	449,400
<b>Totali</b>	<b>47,600</b>	<b>243,000</b>	<b>133,000</b>	<b>57,400</b>	<b>481,000</b>

Burimi: INP

Për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2010-2020, Agjencia e Pyjeve të Kosovës gjatë vitit 2016 është angazhuar në hartimin e Planeve menaxhuese për menaxhimin e pyjeve në një sipërfaqe prej 23,076 ha për 6 njësi menaxhuese siç shihet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 45: Planet menaxhuese 2016**

Njësia menaxhuese	Sipërfaqja/ha
Meçegllav, Dubak	2,952
Qerreti	4,356
Maja	2,553
Rahovec, Shkozë, Koznik, Zatriq	7,693
Uji i Bardhë II	1,912
Karadak	3,610
<b>Totali</b>	<b>23,076</b>

Burimi: APK

Tabelat e mëposhtme ilustrojnë planin e shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore dhe realizimin e shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore në vitin 2016. Vërehet një dallim i lartë vëllimor i sipërfaqeve pyjore në mes të planit të shfrytëzimit dhe realizimit të shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore.

**Tabela 46: Plani i shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore 2016 në m<sup>3</sup>**

Dru teknik	8,386
Dru zjarri	64,318
<b>Neto masa drunore</b>	<b>72,704</b>
Mbeturina	6,732
<b>Bruto masa drunore</b>	<b>79,436</b>

Burimi: APK

**Tabela 47: Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore 2016 në m<sup>3</sup>**

Dru teknik	3,096
Dru zjarri	25,307
<b>Neto masa drunore</b>	<b>28,403</b>
Mbeturina	560
<b>Gjithsej</b>	<b>28,963</b>

Burimi: APK

Vëllimi drusor në pyje shtetërore i planifikuar për shfrytëzim në vitin 2016 ishte 79,436 m<sup>3</sup>, ndërsa sasia e shfrytëzuar ishte vetëm 28,963 m<sup>3</sup> (36% e planit). Në vitin 2015 ishte planifikuar të shfrytëzohen 92,488 m<sup>3</sup> përderisa sasia e shfrytëzuar ishte vetëm 29,673 m<sup>3</sup> (32% e planit). Ky plan parasheh realizimin e masës drunore sipas asortimenteve drunore. Pyjet private janë po ashtu të përfshira në trajtimin dhe kultivimin e pyjeve. Për këto pyje Agjencia e Pyjeve shqyrton kërkesat e pronarëve të tyre lidhur me përmbushjen e nevojave për dru zjarri dhe dru teknik.

**Tabela 48: Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore 2016 sipas DK**

Drejtoria Koordinuese	Dru Teknik halorë	Dru teknik fletorë	Dru zjarri	Mbeturina	Gjithsej m <sup>3</sup>	Realizimi %
Prishtinë	0	0	1,057	7	1,064	16
Pejë	490	152	3,984	0	4,625	49
Mitrovicë	0	0	430	43	473	3
Prizren	132	258	4,688	331	5,408	62
Gjilan	252	264	8,337	0	8,853	55
Ferizaj	328	1,212	5,332	0	6,872	33
DMKE	8	0	1,481	179	1,668	125
<b>Gjithsej</b>	<b>1,210</b>	<b>1,886</b>	<b>25,307</b>	<b>560</b>	<b>28,963</b>	<b>36</b>

Burim: APK

Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore në vitin 2016 sipas Drejtorive Koordinuese ka qenë gjithsej 28,963 m<sup>3</sup>. Nga këto dru teknik halorë ishin 1,210 m<sup>3</sup>, dru teknik fletor 1,886 m<sup>3</sup>, dru zjarri 25,307 m<sup>3</sup> dhe mbeturina 560 m<sup>3</sup>.

Plani për shfrytëzim të pyjeve në pronën private në vitin 2016 përfshiu aktivitete për kultivimin dhe shfrytëzimin e pyjeve, si dhe punët tekniko-profesionale siç shihen në tabelën më poshtë.

**Tabela 49: Plani i shfrytëzimit të pyjeve në pronën private 2016 në m<sup>3</sup>**

<b>A. Kultivimi dhe Shfrytëzimi i Pyjeve</b>	
1. Ngritja e pyjeve të reja - pyllëzime	84 ha
2. Përritja e pyjeve - meliorim	17 ha
3. Kultivim i pyjeve	4,104 ha
4. Shfrytëzim i pyjeve	5,020 ha
<b>B. Punët tekniko-profesionale</b>	
1. Kërkesa të parapara-parashtruara (vendime)	4,304 copë
2. Planifikimi i prerjeve në pyjet private	153,803 m <sup>3</sup>
3. Dru Zjarri	149,490 m <sup>3</sup>
4. Dru teknik	4,313 m <sup>3</sup>

Burim: APK

Tek kultivimi dhe shfrytëzimi i pyjeve përfshihen ngritja e pyjeve të reja – pyllëzime me 84 ha, përritja e pyjeve – meliorim me 17 ha, kultivim i pyjeve me 4,104 ha dhe shfrytëzim i pyjeve me 5,020 ha, ndërsa tek punët tekniko-profesionale përfshihen kërkesat e parapara-parashtruara (vendimet), planifikimet e prerjeve në pyjet private, drunjtë e zjarrit dhe drunjtë teknik.

**Tabela 50: Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve në pronën private 2016**

	Njësia	Gjithsej
Kërkesat e shqyrtura	copë	2,773 copë
Damkosja e trungjeve	m <sup>3</sup>	179,280 m <sup>3</sup>
Damkosja për transport	m <sup>3</sup>	151,030 m <sup>3</sup>
Masa drunore e përcjellur	m <sup>3</sup>	129,913 m <sup>3</sup>
Numri i fletëdërgesave të dhëna	copë	24,547 copë
Kontrolla-vështrime profesionale	raste	373 raste
Drurët jashtë Pyllit	ha	5,791 ha
Pyllëzimet në prona private	ha	9.65 ha

Burimi: APK

Gjatë vitit 2016 kërkesat e shqyrtuara në pyjet private kanë qenë 2,773 copë gjithsej. Damkosja e trungjeve ishte në vëllim prej 179,280 m<sup>3</sup>, damkosja për transport ishte në vëllim prej 151,030 m<sup>3</sup>, dhe masa drunore e përcjellur ishte 129,913 m<sup>3</sup>. Numri i fletëdërgesa të dhëna ishte 24,547 copë, ndërsa kontrolla-vështrime profesionale ishin 373 raste. Kultivimi i pyjeve në prona private rezultoi në 9.65 ha, përderisa shfrytëzimi i drunjëve jashtë pyjeve siç janë masat drunore buzë lumejve, prrockave, mexhave, dhe sipërfaqe të vogla të tjera ishte 5,791 ha.

Aktivitetet për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e pa ligjshme janë të paraqitura më poshtë.

**Tabela 51: Kallëzimet apo fletëparaqitjet e ngritura për Janar - Dhjetor 2016**

Dëmi Pyjor	Copë	m <sup>3</sup>	Totali (€)
Fletëparaqitje kundërvajtje	4,449	8,204	957,778
Fletëparaqitje penale	1,464	7,301	929,128
<b>Gjithsej fletëparaqitje</b>	<b>5,913</b>	<b>15,505</b>	<b>1,886,906</b>

Burimi: APK

Në vitin 2016, Autoritetet Komunale për Pylltari kanë ngritur 1,464 kallëzime penale dhe janë iniciuar 4,449 procedura për kundërvajtje, vlera e dëmit të së cilave së bashku llogaritet në vëllim prej 15,505 m<sup>3</sup> dhe në vlerë monetare prej 1,886,906 €. Nga totali i fletëparaqitjeve, 4,449 prej tyre ishin kundërvajtje në vëllim prej 8,204 m<sup>3</sup> në vlerë monetare prej 957,778 €, ndërsa 1,464 ishin kallëzime penale me vëllim prej 7,301 m<sup>3</sup> dhe vlerë monetare 929,128 €.

Aktivitetet e paligjshme në sipërfaqet pyjore vazhdojnë të jenë një dukuri për të cilat institucionet përkatëse ndërmarrin masa për parandalimin e tyre. Tabela më poshtë ilustron mbrojtjen e pyjeve dhe konfiskimin e masës drunore nga prerësit e paligjshëm.

**Tabela 52: Paraqitja e materialit drunorë të konfiskuar nga prerësit e paligjshëm**

<b>Mbrojtja e Pyjeve, Konfiskimi i masës drunore në m<sup>3</sup></b>	<b>2016</b>
Masa Drunore e Bartur (2015-2016)	1,715
Masa Drunore e Konfiskuar	2,341
Sasia e shitur	1,966
Sasia e dhënë në bazë të memorandumit	118
Gjendja momentale e stoqeve	1,972

Burimi: APK

Masa drunore e bartur në këtë vit ka qenë 1,715 m<sup>3</sup>. Në këtë periudhë ka pasur sasi të dhënë në bazë të memorandumit 117 m<sup>3</sup>. Po ashtu ka pasur edhe konfiskime nga ana e autoriteteve komunale ku janë konfiskuar 2,341 m<sup>3</sup>, sasi të shitur 1,966 m<sup>3</sup> dhe gjendja momentale të stoqeve 1,972 m<sup>3</sup>.

Duke u mbështetur në planin vjetor të menaxhimit, Agjencia Pyjore ndërmori një mori aktivitete në veçanti për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret pyjore.

**Tabela 53: Paraqitja e rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqet pyjore të përfshira në vitin 2016**

<b>Zjarret pyjore 2016</b>				
<b>Komuna</b>	<b>Numri i rasteve</b>	<b>Sipërfaqja (ha)</b>		<b>Gjithsej (ha)</b>
		<b>Publike</b>	<b>Private</b>	
Prishtinë	36	77	62	140
Mitrovicë	11	216	49	265
Pejë	0	0	0	0
Prizren	28	80	38	118
Ferizaj	9	37	0	36
Gjilan	4	25	0	25
<b>Gjithsej</b>	<b>88</b>	<b>435</b>	<b>149</b>	<b>584</b>

Burimi: APK

Në vitin 2016 në komunat e Kosovës ka pasur zjarre pyjore sipërfaqja e të cilave ka përfshirë rreth 584 ha, por zjarret kanë qenë sipërfaqësore dhe nuk kanë shkaktuar dëme të mëdha në masën drunore. Komuna e Prishtinës ka pasur më së shumti raste të zjarreve gjithsej 140 ha, prej të cilave 77 ha ishin pyje publike dhe 62 ha private. Komuna e Prizrenit ka pasur 28 raste të cilat rezultuan në gjithsej 118 ha, prej të cilave 80 ha ishin pyje publike dhe 38 private. Ndonëse në Komunën e Mitrovicës numri i rasteve ishte 11, sipërfaqja e përfshirë ishte më e madhja ndër Komunat e tjera me gjithsej 265 ha, prej të cilave 216 ishin pyje publike dhe 49 pyje private. Më pak raste të zjarreve ka pasur në komunën e Ferizajit dhe Gjilanit, ndërsa në Komunën e Pejës nuk ka pasur asnjë rast.

Agjencia Pyjore gjithashtu u përkujdes për mirëmbajtjen e disa pyllëzimeve gjatë vitit 2016.

**Tabela 54: Mirëmbajtja e pyllëzimeve 2016**

Drejtoria Koordinuese	Komuna	Lokacioni	Sipërfaqja (ha)
Prishtinë	Prishtinë	Kukaj, Viti e Marecit	18
	Podujevë	Brezovan, Sylevicë, Lluqevc	28
	Obiliq	Sibovc	6
Gjilan	Novobërdë	Mendellak	14
	Kamenicë	Shevarinkë	17
Ferizaj	Ferizaj	Izhancë - Viç	40
Prizren	Prizren	Kob i vjetër	50
<b>Total</b>			<b>173</b>

Burimi: APK

Mirëmbajtja e pyllëzimeve u bë në komunën e Prishtinës 18 ha, komunën e Podujevës 28 ha, komunën e Obiliqit 6 ha, komunën e Novobërdës 14 ha, komunën e Kamenicës 17 ha, komunën e Ferizajit 40 ha, dhe komunën e Prizrenit 50 ha. Lokacionet specifike në të cilat u bë mirëmbajtja e pyllëzimeve janë të cekura në tabelën më lartë.

**Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO)**, përmes mbështetjes financiare prej Qeverisë së Finlandës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë, edhe në vitin 2016 vazhdoj me implementimin e projektit, GCP/KOS/005/FIN i cili ka për qëllim që të mbështes zbatimin e Politikave dhe Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë në Kosovë, dokument që është miratuar nga ana e Qeverisë së Kosovës më 2010.

Disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2016 nga projekti “Mbështetje në zbatimin e Politikave dhe Strategjive Pyjore në Kosovë”, janë përmbledhur sipas tri komponentëve të projektit dhe janë paraqitur si në vijim:

Është hartuar raporti i progresit vjetor për Sektorin Pyjor për periudhën 2014-2015.

Është përgatitur dhe organizuar takimi me gjitha palët e interesit për Rishikimin e Përbashkët Vjetor të sektorit të pylltarisë.

Është përgatitur dhe organizuar Forumi i dytë Debatues nën ombrellën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më 27 prill 2016. Forumi i Dytë Debatues, ka shërbyer në sjelljen e ideve të reja dhe rekomandimeve për financimin e sektorit pyjor.

Projekti ka ndihmuar me Rishikimin afatmesëm të Politikave dhe Strategjisë Pyjore në Kosovë 2010 – 2020. Rishikimi i PSP-s ka nxjerrë si përfundim se politikat dhe strategjitë janë në përputhshmëri të plotë me Planin Kombëtar për Zhvillim dhe me shumicën e strategjive të sektorëve të tjerë. Disa prej qëllimeve strategjike që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve u dëshmuar të jenë tej-ambicioze dhe ato nuk janë të bashkërenduara me strategjitë për arsim dhe financa. Në këtë kuptim, do të mund të ishte përkatëse që të



rishikoheshin politikat dhe strategjitë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2010-2020. Një vlerësim i përgjithshëm është që politikat janë mjaft të qarta dhe ofrojnë udhëzime për zbatim. Mungesa e rezultateve të dëshiruara është e ndërlidhur më shumë me mungesën e burimeve financiare dhe projekteve të përbashkëta investive në mes të agjencive përkatëse për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2010-2020. Është konstatuar nga të gjeturat që ndryshimet eventuale mund të adresohen përmes plotësimit dhe hartimit të Planit të Veprimit për periudhën e dytë pesëvjeçare të zbatimit të Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Pyjor 2010-2020.

Është finalizuar hartimi i Programit Kombëtarë për Pyllëzim dhe Ripyllëzim 2016 – 2025

Është finalizuar hartimi i Programit për Mbrojtjen e Shëndetit Pyjor 2016 – 2015

Janë vendosur pikat bioindikative për monitorimin shëndetit pyjor

Është finalizuar hartimi i Programi Zhvillimor për Fidanishten në Pejë 2016 – 2021,

Është finalizuar dhe është aprovuar dokumentacioni i plotë i tenderit për Integrimin e Modulit GIS dhe funksionaliteteve të tjera në Sistemin Informativ të Pyjeve të Kosovës.

Është nënshkruar marrëveshja mes FAO-s dhe MBPZHR-s për organizimin e punëve pyjore publike në komunat e veriut të Kosovës, pyllëzimin dhe pastrimin e 170 ha të tokave pyjore.

Është organizuar trajnimi i kryepunëtorëve në implementimin e Punëve Publike në pylltari, në komunat veriore të Kosovës. Për këtë trajnim janë angazhuar dy trajner një Ekspert ndërkombëtar për infrastrukturë pyjore dhe një Specialist për mekanizimin pyjor.

Ekipi i projektit ka krijuar një bazë për krijimin e mekanizmit koordinues, një platformë funksionale që mbledh të gjithë akterët përkatës në fushën e pylltarisë, për të mundësuar integrimin e menaxhimit pyjor në komunat veriore të Kosovës.

Është organizuar një udhëtim studimor në Kroaci për stafin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të Agjencisë, Institutin e Pylltarisë për krijimin e sipërfaqeve provë “ICP Forest”, mirëmbajtjen e trupave dhe farave si dhe menaxhimin e kulturave pyjore.

## 4 Konsumi, tregtia dhe çmimet e tregut

### 4.1 Trendet e konsumit

Të dhënat nga Anketa për Buxhetin e Ekonomive Familjare ofrojnë informacionet kryesore për treguesit e rëndësishëm që kanë të bëjnë me kushtet e jetesës si dhe karakteristikat bazë demografike, ekonomike dhe sociale të ekonomive familjare në Kosovë gjatë vitit 2016.

Këto të dhëna të detajuara kanë të bëjnë me shpenzimet e konsumit për mallra dhe shërbime, informacion mbi të ardhurat, shpenzimet për konsum të përgjithshëm, vetëkonsum, informata themelore për strehim dhe shumë karakteristika tjera demografike dhe socio-ekonomike.

**Tabela 55: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2009-2016**

Vitet	Gjithsej në mil. (€)	Konsumi për ekonomi familjare (€)	Konsumi për kokë banori (€)
2009	1,911	6,847	1,161
2010	1,937	7,110	1,226
2011	1,928	7,010	1,210
2012	2,292	7,657	1,380
2013	2,382	7,625	1,402
2014	2,471	7,611	1,386
2015	2,461	3,503	1,432
2016	2,321	7,539	1,460

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016

Nga rezultatet e dala nga ky publikim i Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) për vitin 2016, konsumi i përgjithshëm në Kosovë në vitin 2016 ishte 2,321 milionë €, ndërsa për ekonomi familjare 7,539 €, si dhe për kokë banori 1,460 €. Konsumi i përgjithshëm në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, ka një rënie të lehtë prej 5.7%, ndërsa konsumi për kokë banori ka një rritje prej 2%. Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2016 është shpenzuar për ushqim (42%) dhe për banim (29%) duke pasuar me shpenzimet për veshmbathje me 5%, me nga 4% transporti, alkooli dhe duhani si dhe mobiljet ndërsa kategoritë e tjera marrin pjesë me 12%.

Ndërkaq, krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 pjesëmarrja e ushqimit nga prodhimi vetanak në konsumin e përgjithshëm ka shënuar një rënie të vogël prej 1 pikë përqindje.

**Tabela 56: Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit, 2009 – 2016 në( %)**

Konsumi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Ushqim dhe pijet joalkoolike	36	35	38	45	45	44	43	42
Alkool dhe duhan	3	4	4	5	4	4	4	4
Veshmbathja	5	6	5	4	4	4	4	5
Banimi	36	33	31	30	30	28	30	29
Mobiliet	3	3	3	3	3	4	3	4
Shëndetësi	3	2	2	2	2	3	3	3
Transport	5	6	6	4	4	5	4	4
Komunikim	2	2	2	2	2	3	3	3
Rekreacion	2	2	2	1	2	0	1	1
Edukim	1	1	1	1	1	1	1	0
Hotele, restorante	1	3	3	1	2	2	2	2
Të tjera	3	3	3	2	2	2	2	3
Ushqimi i vet-prodhuar nga ekonomitë familjare ?	7	7	7	6	6	6	7	6

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016

Konsumi i ushqimit në Kosovë në vitin 2016, sipas rezultateve të ABEF-it, është shumë i përafërt me të gjitha vitet e tjera, me disa dallime të vogla. Zakonisht dominohet nga mishi me 21%, qumështi, djathi, dhe vezët, kishin pjesëmarrje të njëjtë si edhe në vitin 2015, pra merrnin pjesë me 18% në shpërndarje të konsumit të ushqimit. Buka dhe drithërat kishin pjesëmarrje 17%, ashtu si edhe në vitin paraprak, e që kontribuojnë në më shumë se gjysmën e konsumit të ushqimit (në vlerë). Më pas, radhiten perimet me 12% dhe pijet joalkoolike me 9%, pra, kemi ndryshim në vitin 2016 të kjo kategori prej 1 pikë përqindje më pak në krahasim me vitin 2015. Kategoritë tjera të prezantuara në tabelë përbëjnë 23% të pjesës tjetër të konsumit të ushqimit.

**Tabela 57: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë, 2009– 2016 (%)**

Konsumi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Buka dhe drithërat	19	19	21	19	19	18	17	17
Mishi	18	18	19	20	19	20	20	21
Peshku	1	1	1	1	2	1	1	1
Qumështi, Djathi, Vezët	20	19	18	16	16	17	18	18
Vajrat dhe yndyrat	4	4	5	4	4	3	3	3
Frutat	7	7	6	7	7	8	8	8
Perimet	12	12	11	11	12	12	12	12
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	5	6	6	7	6	6	6	6
Produkte tjera ushqimore	5	5	5	5	5	5	5	5
Pijet jo alkoolike	9	9	8	10	10	10	10	9
Ushqimi i përgjithshëm	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016

Kur flasim për burimet kryesore të të hyrave në vitin 2016, shohim se burimi kryesor dhe më i rëndësishëm ishin rrogat nga punësimi i rregullt nga sektori publik që përbëjnë 25%. Burimi

i dytë për nga rëndësia janë të hyrat neto nga bizneset që përbëjnë 26% të të hyrave të përgjithshme, ku vërehet një rritje prej 4% e të hyrave nga sektori privat për dallim nga viti 2015 ku kjo përqindje ishte 22%.

Burime tjera të rëndësishme janë pensionet dhe bizneset e ekonomive familjareme nga 11% secila. Të hollat e dërguara nga jashtë (remitencat) që janë shumë të vlefshme për ekonomitë familjare ashtu edhe për ekonominë e vendit në vitin 2016 kanë pësuar rënie për 1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2015. Njësoj si edhe në vitin e kaluar, rreth 5% të të ardhurave kanë qenë nga bujqësia.


**Tabela 58: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë në %**

<b>Burimi i të hyrave</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	26	25
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	22	26
Bujqësi	5	5
Të ardhurat nga medijt <sup>1</sup>	6	7
Biznese të tjera të ekonomive familjare	11	11
Pensionet	13	11
Të hollat e dërguara nga jashtë	9	8
Të hollat e dërguara nga Kosova	1	1
Ndihma sociale-Kategori 1	4	3
Ndihma sociale -Kategori 2	1	1
Të ardhurat nga prona	1	0
Pensionet e familjeve të dëshmorëve	0	1
Të tjera <sup>2</sup>	1	1
<b>Totali në %</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016

Kur flasim për pronësinë sipas strukturës gjinore si dhe asaj nën hipotekë edhe në vitin 2016, përkundër faktit se ka pasur rritje të pronësisë në favor të femrës për 6 pikë përqindje, ende vazhdon të dominoj tradita që mashkulli të jetë pronar i shtëpisë (banesës). Nëse shprehim në përqindje, 89% e meshkujve ishin pronar të pronave dhe vetëm 11% e pronave janë në pronësi të femrave.

**Figura 21: Pronësia në vitin 2014 -2016, sipas gjinisë,në %**



Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016

Sa i përket shtëpive apo banesave që janë nën hipotekë në vitet e prezantuara në tabelë më së shumti ka pasur në vitin 2014 (3%), kjo përqindje ka pësuar ulje për 2 pikë përqindje në vitin 2015 ndërsa në vitin 2016, nën hipotekë ishin 2% e shtëpive apo banesave.

**Tabela 59: Shtëpitë/Banesat nën hipotekë në vitin 2014-2016,në %**

Shtëpitë/banesat nën hipotekë	2014	2015	2016
Jo nën hipotekë	97	99	98
Nën hipotekë	3	1	2

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016

## 4.2 Tregtia

Të dhënat e tregtisë ndërkombëtare janë indikator të rëndësishëm për politikbërësit si në sektorin publik po ashtu edhe në atë privat. Informacione të tilla shërbejnë gjatë përgatitjes së negociatave multilaterale dhe bilaterale në kuadër të politikës së përbashkët tregtare, definimin dhe zbatimin e politikës anti-dumping, hartimin e bilancit të pagesave dhe llogarive kombëtare si dhe informata tjera.

Statistikat e shkëmbimit tregtar janë burim zyrtar i informacionit mbi importet, eksportet dhe bilancin tregtar, pra, vlera dhe sasia e mallrave të tregtuara në mes të Kosovës dhe vendeve të CEFTA-s, BE-së dhe vendeve tjera.

Duke u nisur nga ky fakt në vazhdim është prezantuar më gjerësisht shkëmbimi tregtar i përgjithshëm i Kosovës në vitin 2016, pjesëmarrja e eksportit dhe importit të produkteve bujqësore (kapitujt 1-24) në eksportin dhe importin e përgjithshëm, mbulueshmëria e importit me eksport, bilanci tregtar, pjesëmarrja e eksportit dhe importit në përqindje

(CEFTA, BE dhe vendet tjera), dhe paraqitja e produkteve sipas kapitujve në nivel dy shifrorë (Sistemi i Harmonizuar).


**Tabela 60: Eksporti/Importi i përgjithshëm, në 1000 €**

Periudha	Eksporti	Importi	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria Importit me Eksport(%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2001	10,559	684,500	-673,941	1.5
2002	27,599	854,758	-827,159	3.2
2003	35,621	973,265	-937,644	3.7
2004	56,567	1,063,347	-1,006,780	5.3
2005	56,283	1,157,492	-1,101,209	4.9
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8.5
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10.5
2008	198,463	1,928,236	-1,729,773	10.3
2009	165,328	1,935,541	-1,770,213	8.5
2010	295,957	2,157,725	-1,861,768	13.7
2011	319,165	2,492,348	-2,173,183	12.8
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	11.0
2013	293,919	2,450,363	-2,156,444	12.0
2014	324,554	2,583,231	-2,258,677	12.6
2015	325,246	2,627,271	-2,302,025	12.4
2016	309,687	2,785,198	-2,475,511	11.1

Burimi: ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme

Përgjatë periudhës së kaluar, eksporti i përgjithshëm ka pasur luhatje nëpër vite, mirëpo nëse shikojmë prej vitit 2005 e deri më tash ka pasur një përmirësim të dukshëm. Përderisa eksporti në vitin 2005 ishte mbi 56 mil.€, në vitin 2015 ka shënuar rritje në mbi 325 mil. €, pra, rritja e eksportit ishte për 480%. Kur krahasojmë dy vitet e fundit kjo rritje ishte shumë e vogël, përkatësisht një rritje për 0.21% në vitin 2015, ndryshe nga viti 2014 kur rritja ishte 10% krahasuar me vitin 2013. Trendi i rritjes së eksportit nuk ka vazhduar dhe në vitin 2016, përkundrazi, në këtë vit eksporti ka pësuar rënie për 4.8% krahas viti 2015.

**Figura 22: Eksporti/Importi i përgjithshëm, në 1000 €**



Burimi: ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme

Importi në vitin 2015 ka arritur vlerën më të lartë apo kthyer në shifra në mbi 2,627 mil. €, një rritje për 1.7% më shumë se në vitin 2014. Niveli i ulët i eksportit dhe në anën tjetër, rritja e vazhdueshme e importit ka ndikuar që bilanci tregtar të jetë negativ në vlerë prej 2,302 mil.€).

Bilanci tregtar për vitin 2015 ka qenë 1.9% më i lartë se sa në vitin 2014, duke vazhduar sikurse viteve tjera me trendin e bilancit të thellë negativ të shkëmbimit tregtarë të Kosovës me vendet e tjera. Te dhënat tregojnë se kjo rritje e importit ka vazhduar të rritet për 6.0% në vitin 2016 nëse krahasohet me një vit më herët, duke quar në rritje të bilancit negativ për 7.5%.

**Tabela 61: Pjesëmarrja e Eksportit-Importit të produkteve bujqësore, në 1000 €**


Vitet	Eksporti (1-98)	Eksporti (1-24)	(%)	Importi (1-98)	Importi (1-24)	(%)
	1	2	3=2/1	4	5	6=5/4
2008	198,463	20,763	10.5	1,928,236	473,666	24.6
2009	165,328	19,993	12.1	1,935,541	434,810	22.5
2010	295,957	24,749	8.4	2,157,725	482,649	22.4
2011	319,165	26,185	8.2	2,492,348	561,428	22.5
2012	276,100	30,807	11.2	2,507,609	574,974	22.9
2013	293,919	34,947	11.9	2,450,363	583,704	23.8
2014	324,554	39,372	12.1	2,583,231	616,051	23.8
2015	325,246	41,683	12.8	2,627,271	628,808	23.9
2016	309,687	45,256	15.0	2,785,198	658,767	23.6

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Gjatë viteve 2008-2016, pjesëmarrja më e ulët e eksportit (1-24) në eksportin e përgjithshëm (1-98) ka qenë në vitin 2011 me mbulueshmëri prej 8.2%, ndërsa mbulueshmëria më e lartë u arrit në vitin 2016 (15.0%). Në shkëmbimin tregtar të produkteve bujqësore, vërehet se në vazhdimësi kemi një trend të lehtë të rritjes së eksportit për vitet 2008-2016. Rritje më e

madhe e vlerës së eksportit të produkteve bujqësore ka qenë në vitin 2016 (45.2 mil. €), që është rritje e eksportit për 8.7% më shumë se sa në vitin 2015.


**Figura 23: Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Tempo të shpejtë të rritjes ndër vite ka pasur gjithashtu edhe vlera e importit që është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Përderisa kemi pasur rritje të importit të përgjithshëm, apo vlerën më të madhe të importit për kapitujt (01-98) për 6.0% në vitin 2016, gjithashtu po në këtë vit ka qenë edhe pika më e lartë e vlerës së importit të produkteve bujqësore për kapitujt (01-24), që arriti vlerën (658mil. €), njëherësh rritje për 4.7% më shumë se sa në vitin 2015.

**Figura 24: Pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Përqindja e pjesëmarrjes së importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm ka qenë shumë e përafërt. Ndryshe prej viteve tjera, pjesëmarrje më të lartë të importit (1-24) në



importin e përgjithshëm (1-98) ka pasur në vitin 2008 (24.6%), ndërsa më e ulëta ka qenë në vitin 2010 (22.4%). Në vitin 2016 kjo pjesëmarrje ishte 23.6%.


**Tabela 62: Eksport-Importi i produkteve bujqësore (1-24), në 1000€**

Viti	Eksporti	Importi	Bilanci tregtar	Eksporti/Importi (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2008	20,763	473,666	-452,903	4.4
2009	19,993	434,810	-414,817	4.6
2010	24,749	482,649	-457,900	5.1
2011	26,185	561,428	-535,243	4.7
2012	30,807	574,974	-544,167	5.4
2013	34,947	583,704	-548,757	6.0
2014	39,372	616,051	-576,679	6.4
2015	41,683	628,808	-587,125	6.6
2016	45,256	658,767	-613,511	6.8

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në vitet e fundit vlera e importit të produkteve bujqësor është rritur në vazhdimësi, por paralelisht edhe eksporti ka pasur rritje nga viti në vit. Meqenëse eksporti ka shënuar rritje, kjo ka rezultuar me një mbulueshmëri më të lartë të importit nga ana e eksportit. Vlera e bilancit tregtar për produktet bujqësore në periudhën kohore 2008-2015 ka vazhduar të jetë negative me një mesatare prej 514 mil. €. Në vitin 2016 bilanci tregtar ka qenë negativ në vlerë prej 613.5 mil. €, që do të thotë se vlera negative e bilancit tregtar të importit është thelluar më tutje për 19.1%, më shumë se sa mesatarja e viteve 2008-2015.

**Figura 25: Eksport-Importi i produkteve bujqësore (1-24) në, 1000€**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i përgjithshëm i produkteve bujqësore (1-24) në vitin 2016, ka arritur vlerën më të lartë deri më tani (45.2 mil. €), që krahasuar me vitin 2015 eksporti ka pasur një rritje prej 8.6%, ndërsa importi ka pasur vlerë prej 658 mil. €, duke shënuar rritje prej 4.7%. Rrjedhimisht nga të dhënat paraprake del se edhe gjatë vitit 2016 kemi deficit tregtar në vlerë

prej 613 mil. €, kurse eksporti mbulon importin me vetëm 6.8%. Partnerët kryesor tregtar me të cilët Kosova realizoi vlerën më të lartë të eksportit dhe importit janë vendet e rajonit, anëtare të marrëveshjes së tregtisë së lirë, CEFTA.

#### 4.2.1 Tregtia me vendet e CEFTA-s

Për krijimin e një zonë të tregtisë së lirë, ku tregtia në mallra dhe shërbime mund të zhvillohet përtej kufijve, për reduktimin e barrierave, Kosova ka nënshkruar në vitin 2007 Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore-CEFTA.


**Tabela 63: Eksport-Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në 1000€**

Viti	Eksporti (1-24)	Eksporti CEFTA (1-24)	(%)	Importi (1-24)	Importi CEFTA (1-24)	(%)
	1	2	3=2/1	4	5	6=5/4
2008	20,763	16,518	79.6	473,666	164,219	34.7
2009	19,993	15,304	76.5	434,810	156,329	36.0
2010	24,749	19,610	79.2	482,649	197,791	41.0
2011	26,185	20,080	76.7	561,428	189,530	33.8
2012	30,807	24,960	81.0	574,974	224,633	39.1
2013	34,947	25,385	72.6	583,704	224,465	38.5
2014	39,372	25,604	65.0	616,051	227,096	36.9
2015	41,683	26,939	64.6	628,808	235,180	37.4
2016	45,256	29,257	64	658,767	248,550	37.7

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore në mes të këtyre shteteve ka shënuar rritje të vazhdueshme qysh prej fillimit të zbatimit të saj në vitin 2008 e deri me tani. Vlera e eksportit të produkteve bujqësore me vendet anëtare të CEFTA-s në 2008, ka qenë mbi 16 mil. €, kurse kjo vlerë është rritur vazhdimisht deri në vitin 2015, kur është realizuar eksport në këto vende në vlerë mbi 26.9 mil. €, që ndryshe nga viti 2014 ka pasur rritje për 5.2%. Edhe pse eksporti në këto vende është përcjellur me shumë barriera edhe në vitin 2016, prapëseprapë shifrat tregojnë se ka pasur rritje të eksportit për 8.6%, më tepër se në vitin 2015.

**Figura 26: Shkëmbimi tregtar me vendet e CEFTA-s, në 1000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Krahasuar me vlerën e eksportit të vitit 2009 si vlerë më e vogël (15.3 mil. €) në vitin 2015 kishte rritje prej 76%. Eksporti në vendet e CEFTA-s ka pasur rritje edhe në vitin 2016, që në krahasim me vitin paraprak pati një shtim të vlerës së eksportit për 8%. Shprehur në përqindje, 64% e vlerës së eksportit apo 29 mil. €, ka qenë i orientuar në vendet e CEFTA-s

Importi i produkteve bujqësore nga vendet e CEFTA-s ka ndryshuar vazhdimisht prej vitit në vit. Vlera më e ulët e importit ishte në vitin 2009 (156 mil. €), ndërsa më e larta në vitin 2016, me një pjesëmarrje në importin e përgjithshëm të produkteve bujqësore (kapitujt 1-24) prej 37.7%, apo në vlerë prej 248.5 mil. €. Ndryshe nga viti 2015, në vitin 2016 vërehet rritje e importit nga vendet e CEFTA-s për 5.7%.

**Figura 27: Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, në 1000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s në eksportin e përgjithshëm ka pasur rënie të vazhdueshme nga viti në vit. Në periudhën 2008 – 2010 kjo

pjesëmarrje ishte mesatarisht 78%, duke u ngritur në vitin 2012 në 81%, njëherazi kjo ishte pjesëmarrje më e lartë e eksportit në këto vende. Ndërsa pjesëmarrja më e ulët është shënuar në vitin 2015 dhe 2016 (65%), që do të thotë se 65% e produkteve për kapitujt (1-24) janë eksportuar në këto vende.

Eksporti i prodhimeve bujqësore në vendet anëtare të CEFTA-s në vitin 2016 është udhëhequr nga Shqipëria me rreth 16.8 mil. €, pastaj Maqedonia me mbi 5 mil. € dhe Serbia me 4.6 mil. €. Krahasuar me vitin paraprak ka qenë pothuajse vlerë e njëjtë, me disa ndryshime të vogla, përveç Shqipërisë që ka pasur eksport më tepër për 2.8 mil. € dhe Maqedonisë ku paraqitet rënie e importit për 1mil. €.

**Figura 28: Importi i produkteve bujqësore nga vendet e CEFTA-s, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sa i përket pjesëmarrjes në përqindje të importit të produkteve nga vendet e CEFTA-s në importin e përgjithshëm (1-24), pjesëmarrje më e madhe ka qenë gjatë vitit 2010 (41%), ndërsa pjesëmarrje më e ulët ishte në vitin 2011 (34%). Në vitin 2012 kjo pjesëmarrje është rritur në 39%, duke pasur me rënie të lehtë, por kryesisht ka pasur trend të rritjes me përqindje përafërsisht të njëjtë, kështu që në vitin 2016 ishte 38%.

Edhe pse vlera e eksportit në këto vende edhe gjatë vitit 2016 ka qenë mjaft e vogël krahasuar me vitet tjera, mund të themi se ka pasur një rritje të konsiderueshme. Nëse e krahasojmë eksportin e vitit 2016 me atë të vitit 2015, vërejmë se vlera e eksportit në Shqipëri është rritur për 21%, B. Hercegovinë 24.1%, Serbi 3.2%, dhe Mal të Zi për 6.1%, ndërsa kemi zvoglim të theksuar të eksportit në Maqedoni për 16.5%.


**Tabela 64: Eksporti i prodhimeve bujqësore në vendet CEFTA-s, në1000 €**

Vendet e CEFTA-s	2014	2015	2016	Ndryshimi (2016-2015)	Ndryshimi 2016/2015 (%)	Pjesëmarrja (%) 2016
Shqipëria	14,059	13,973	16,869	2,896	20.7	57.7
B. Hercegovina	996	916	1137	221	24.1	3.9
R. e Moldavisë	0	0	0	0	0.0	0.0
Mali i Zi	1,379	1,307	1,387	80	6.1	4.7
Maqedonia	5,742	6,211	5,185	-1,026	-16.5	17.7
Serbia	3,428	4,532	4,676	144	3.2	16.0
<b>Gjithsej</b>	<b>25,604</b>	<b>26,939</b>	<b>29,257</b>	<b>2,318</b>	<b>8.6</b>	<b>100.0</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Vlera e produkteve bujqësore të eksportuara nga Kosova në vendet e CEFTA-s është ende e ulët, në vitin 2016 është shënuar një rritje prej 12.4% në krahasim me vitin 2015. Pjesëmarrja më e madhe në eksportin e produkteve bujqësore në vitin e fundit të prezantuar në tabelë ka qenë në Shqipëri 57%, Maqedoni 18%, Serbi 16%, dhe Mali i zi 5%. Produktet më të eksportuara në këto vende janë: Produktet bulmetore nga kapitulli-04, ku bëjnë pjesë qumështi dhe produktet e qumështit; Zorzavatet e ngrënëshme, rrënjët dhe tuberët përkatës nga kapitulli-07; Frutat dhe arrat e ngrënëshme; Produktet e Industrisë bluajtëse - kapitulli 11; Pijet, alkoolet dhe uthullat kapitulli-22; Mbetjet dhe kthimet nga industria ushqimore, produktet e industrisë bluajtëse - kapitulli 23.

**Figura 29: Eksporti i prodhimeve bujqësore në vendet CEFTA-s, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në vitin 2016 importi me të gjitha shtetet e CEFTA-s ka shënuar rritje. Edhe pse vlera e importit nga Moldavia ka qenë e vogël vërehet një rënie për 3%, në krahasim me vitin 2014 ndërsa krahasuar me vitin 2015 kemi rritje të theksuar (30.5%)

Vlera e Importit nga shteti i Serbisë në vitin 2014 dhe 2015 ka qenë pothuajse i njëjti (153 mil. €), ndërsa në vitin 2016 ka shënuar rritje për 6.1%, për dallim nga viti 2015.

Importi i produkteve bujqësore nga B. Hercegovina ka shenuar rritje në tri vitet e fundit, në këtë rast në vitin 2016 ka pasur vlerë prej 22 mil. €, që do të thotë se gjatë këtij viti kishte rritje për 6%.

**Tabela 65: Importi i prodhimeve bujqësore nga vendet CEFTA-s, në1000 €**


Vendet e CEFTA-s	2014	2015	2016	Ndryshimi (2016-2015)	Ndryshimi 2016/2015 (%)	Pjesëmarrja (%) 2016
Shqipëria	14,400	18,533	18,852	319	1.7	7.6
B. Hercegovina	16,481	21,636	22,922	1,286	5.9	9.2
R. e Moldavisë	111	82	107	25	30.5	0.0
Mali i Zi	3,304	3,292	3,348	56	1.7	1.3
Maqedonia	39,076	38,420	40,635	2,215	5.8	16.3
Serbia	153,723	153,214	162,683	9,469	6.2	65.5
<b>Gjithsej</b>	<b>227,096</b>	<b>235,177</b>	<b>248,550</b>	<b>13,373</b>	<b>5.7</b>	<b>100.0</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi nga Maqedonia ka qenë i njëtrajtshëm pa një rritje të theksuar duke filluar nga viti 2014 (39 mil. €), duke psuar rënie në vitin në vijim 2015 për 1.7%, pasuar prap me rritje në vitin 2016 ndryshe nga viti 2015 për 5.8%.

Ndërsa Importi nga Shqipëria mbetet i njëjtë për vitin 2015 dhe 2016 (18 mil.Euro), me një rritje të lehtë prej 1.7%.

**Figura 30: Importi i prodhimeve bujqësore nga vendet CEFTA-s, në 1000 €**



Sa i përket importit nga Mali i Zi për vitet 2014, 2015 dhe 2016 mbetet po thuajse i njëjti me ndryshim të vogël në vitin 2016 për 1.7%.

Marrë në përgjithësi vlera e importit nga vendet e CEFTA-s pati rritje prej 5.7%, krahasuar me vitin 2015.

**Tabela 66: Pjesëmarrja e vendeve të CEFTA-s në Eksport/Import(%) në 2016, në 1000 €**

Vendi	Eksporti	Importi	Pjesmarja eksportit (%)	Pjesmarja importit (%)
Shqipëria	16,869	18,852	57.6	7.6
B. Hercegovina	1,137	22,922	3.8	9.3
Rep. e Moldavisë	0	107	0	0.0
Mali i Zi	1,387	3,348	4.7	1.4
Maqedonia	5,185	40,635	17.7	16.5
Sërbia	4,676	162,683	15.9	66.0
<b>Totali</b>	<b>29,254</b>	<b>248,550</b>	<b>100</b>	<b>100.0</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi nga CEFTA-s për vitin 2016 përsëri është udhëhequr nga Serbia me pjesëmarrje 65.4% të gjithsej importit, pasuar nga Maqedonia 16%, B. Hercegovina 9%, Shqipëria 7.6%, Mali i Zi 1.3%. Nga këto vende më së shumti janë importuar: Lopët për therje; Frutat dhe arrat e ngrënshme, agrumet dhe produkte tjera; Drithërat; Ujrat, përfshirë ujrat minerale dhe ujrat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese apo aromatizuese shtesë; Sheqer i bardhë; Vaj dhe Vaj tjetër për përdorim teknik apo industrial; Biskota të ëmbla dhe lloje të tjera; Pijet alkoolet dhe uthullat; Ushqim të kafshëve mbetjet dhe kthimet nga industria ushqimore dhe produkte të tjera.

#### 4.2.2 Tregtia me vendet e BE-së

Shkëmbim tregtar të produkteve bujqësore ka pasur edhe me vendet e BE-së. Edhe pse eksporti ka qenë me vlerë më të vogël se importi, vlen të ceket se vlera e eksportit në vendet e BE-së në vitin 2016, ishte mbi 11.9 mil. €, që në krahasim me vitin paraprak del të jetë 3.4% më e lartë.

Gjithashtu edhe vlera e importit nga vendet e BE-së është rritur që nga viti 2008, duke vazhduar me rritje edhe në vitin 2016, që kishte vlerë prej 262 mil. €.

Bilanci tregtar ka vazhduar të mbetet negativ, duke vazhduar me thellim të mëtutjeshëm për 5.0%, krahasuar me vitin 2015. Edhe mbulueshmëria e importit me eksport në këto vende ishte mjaft e vogël, në pjesëmarrje prej vetëm 4.6 %.

**Tabela 67: Eksporti-Importi i prodhimeve bujqësore me vendet e BE-së, në 1000 €**

Viti	Eksporti	Importi	Bilanci	Mbulueshmëria Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2008	3,566	163,178	-159,612	2.2
2009	3,559	153,152	-149,593	2.3
2010	3,214	161,898	-158,684	2.0
2011	3,865	214,745	-210,880	1.8
2012	6,105	225,039	-218,934	2.7
2013	8,347	234,116	-225,769	3.6
2014	10,184	249,026	-238,842	4.1
2015	10,530	248,936	-238,406	4.2
2016	11,961	262,440	-250,479	4.5


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në vitin 2016 nga gjithsej vlera e eksportit të produkteve bujqësore, janë eksportuar në vendet e BE-së në vlerë prej 11.9mil. €. Në periudhën 2014-2016, vlera mesatare e eksportit të produkteve bujqësore ishte 10.8 mil. €.

Shprehur në përqindje del se mbulimi i importit nga eksporti në vitin 2016, në shkëmbimin tregtar me vendet e BE-së kishte pjesëmarrje 4.6%.

Trendet e importit kanë ndryshuar nga viti në vit. Vlera më e ulët e importit nga vendet e BE-së ishte në vitin 2009 (153 mil. €), ndërsa vlera më e lartë arriti në vitin 2016, ku u importuan mallra në vlerë prej 262 mil. €, që ka pasur rritje të importit në krahasim me vitin 2015 për 5.4%. Importi i produkteve bujqësore nga BE-ja përbën 39.6%, të vlerës së importit të përgjithshëm.

**Figura 31: Eksporti-Importi i prodhimeve bujqësore me vendet e BE-së, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR



Nga gjithsej eksporti i produkteve bujqësore në vendet e BE-së prej 11.9 mil. €, në vitin 2016, pjesën më të madhe të eksportit apo 80.5 % e përbëjnë: vendet e grupuara si “Vendet e tjera të BE-së” me pjesëmarrje prej 31.5%, Gjermania 26%, pasuar nga Bullgaria me 8%, Rumania 7.4%, Austria me 7.2%, si dhe vendet tjera me më pak vlerë të eksportit me pjesëmarrje në eksport prej 19.5% të vlerës.


**Tabela 68: Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e BE-së, në 1000 €**

Vendet	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi (%)	Pjesëmarrja (%) 2016
Austria	1366	865	-501	-36.7	7.2
Bullgaria	734	913	179	24.4	7.6
Gjermania	2,852	3,156	304	10.7	26.4
Holanda	389	665	276	71.0	5.6
Hungaria	197	252	55	27.9	2.1
R.Çeke	294	492	198	67.3	4.1
Rumania	743	889	146	19.7	7.4
Slovenia	198	221	23	11.6	1.8
Suedia	553	766	213	38.5	6.4
Vendet tjera të BE-së	3,203	3,762	559	17.5	31.5
<b>Gjithsej BE 28</b>	<b>10,529</b>	<b>11,961</b>			<b>100.0</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në eksportin e përgjithshëm të produkteve bujqësore me vendet e BE-së dominuan produktet e njëjta të cilat Kosova eksporton në vendet e CEFTA-s: pijet, alkoolet dhe uthullat, produktet e industrisë bluajtëse, përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve tjera të bimëve, perimet e ngrënshme, kakao dhe përgatitjet prej kakaos. Pjesëmarrje më të madhe të eksportit kanë pasur vendet e grupuara si “Vendet tjera të BE-së” me 31%.

**Figura 32: Shpërndarja e eksportit brenda vendeve të BE-së në vitin 2016**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore në vitin 2016 për kapitujt 1-24 nga vendet e BE-së ka pasur rritje prej 5.2%, krahasuar me vitin paraprak. Përveç rritjes së vlerës së importit të përgjithshëm (1-24), në vitin 2016, ka pasur dallim edhe për nga vendet që është importuar, krahasuar me vitin 2015, importi nga disa vende është rritur, në disa ka pasur rënie.


**Tabela 69: Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së, në 1000 €**

Vendet	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshumi në %	Pjesëmarja në %(2016)
Austria	14,953	14,848	-105	-1	5.6
Bullgaria	14,819	12,209	-2,610	-18	4.6
Gjermania	45,714	54,235	8,521	19	20.6
Greqia	11,349	13,607	2,258	20	5.1
Hungaria	8,679	9,266	587	7	3.5
Italia	30,759	31,948	1,189	4	12.1
Rep.Çeke	2,431	1,814	-617	-25	0.6
Rumania	7,738	8,848	1,110	14	3.3
Slovenia	23,403	23,313	-90	0	8.8
Holanda	9,051	9,529	478	5	3.6
Suedia	363	231	-132	-36	0.09
Vendet tjera të BE-së	79,670	82,592	2,922	4	31.4
<b>Gjithsej BE 28</b>	<b>248,935</b>	<b>262,440</b>	<b>13,505</b>	<b>5</b>	<b>100.00</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Zvoglim të importit për 36% ka pasur nga Suedia, Rep.Çeke 25% dhe Bullgaria 18%. Ndërsa rritje më të madhe të vlerës së importit ka pasur nga këto shtete: Greqia 20%, Gjermania 19%, dhe Rumania 14%. Shtim të vlerës së importit krahasuar me vitin 2015 ka pasur edhe në disa shtete që janë të prezantuara në tabelë, por në një përqindje më të vogël.

**Figura 33: Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së, në vitin 2016, 2015, në 1000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Pjesëmarrje më të madhe në importin e përgjithshëm (kapitujt 01-24) nga vendet e BE-së ka pasur nga vendet e grupuara si "Vendet tjera të BE-së" (31%), Gjermania (21%), Italia (12%),

Slovenia (9%), Bullgaria (5%), Austria (6%), Greqia (5%), Holanda (4%) si dhe Hungaria dhe Rumania kishin pjesmarrje të njejtë (3%) dhe R.Çeke (1%).

**Figura 34: Shpërndarja e importit brenda vendeve të BE-së në vitin 2016 (%)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në mesin e produkteve më të importuara bujqësore nga vendet e BE-së, më dominante kanë qenë: duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar që paraqesin 21% të vlerës së importit, qumështi dhe produktet e qumështit (10%), pijet alkoolike (8%), mishi dhe produktet e tij (7%), përgatitjet prej drithërave (7%), gruri, si dhe produkte tjera që ishin në vlerë më të vogël.

#### 4.2.3 Tregtia me vendet e tjera

Përveç vendeve të CEFTA-s dhe vendeve të BE-së, Kosova realizoi shkëmbim tregtar edhe me vendet tjera. Vendet tjera nga është importuar më së shumti janë: Turqia, Brazili, Zvicra, SHBA, Kina, Kanada dhe vendet e tjera. Produktet kryesore të importuara ishin: mishi dhe produktet e mishit, ëmbëlsirat, përgatitjet prej drithërave, pijet si dhe produkte tjera nga kapitujt 1-24 dhe disa produkte tjera bujqësore.


**Tabela 70: Shkëmbimi tregtar i Kosovës në vitin 2016**

Vendet	Eksporti	Importi	Deficiti	Pjesëmarrja Eksporti (%)	Pjesëmarrja Importi (%)	Mbulimi importit me eksport
CEFTA	29,257	248,550	-219,293	65	38	12
Vendet e BE-se	11,961	262,440	-250,479	26	40	5
Vendet tjera	4,038	145,777	-141,739	9	22	3
<b>Totali</b>	<b>45,256</b>	<b>658,767</b>	<b>-613,511</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>7</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Edhe në vitin 2016 ka pasur rritje të eksportit por edhe të importit të produkteve bujqësore. Eksporti në vendet e CEFTA-s ishte rreth 29 mil. €, ndërsa importi mbi 248 mil. € duke rezultuar me bilanc tregtar negativ prej 219 mil. €.

**Figura 35: Shkëmbimi tregtar i Kosovës në vitin 2016**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Nga eksporti në vendet e BE-së, Kosova ka grumbulluar mbi 11.9 mil. €, kurse ka shpenzuar në import afër 262.4 mil. €, me bilanc tregtar negativ prej 250.4 mil. €. Eksporti në vendet e tjera ka arritur në mbi 4 mil. €, kurse importi mbi 145 mil. €, që njëherit shënon deficit për 141.7 mil. €.

Sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së grupeve të vendeve të përmendura më lartë vlen të ceket se 65% e eksportit ka qenë në vendet e CEFTA-s, 26% në vendet e BE-së, dhe 9% në vendet e tjera.


**Figura 36: Eksporti i produkteve bujqësore(1-24) për vitin 2016 (%)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sa i përket importit, pjesa më e madhe është importuar nga vendet e BE-së (40%), pasuar nga vendet e CEFTA-s (38%) dhe vendet e tjera 22%. Një proporcion i përafërt i ndarjes së pjesëmarrjes së vlerës së importit me vitin 2015.

**Figura 37: Importi i produkteve bujqësore (1-24) për vitin 2016(%)**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

#### 4.2.4 Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve(1-24)

Në krahasim me vlerën e importit, vlera e eksportit është mjaftë e ulët. Në kuadër të eksportit të produkteve bujqësore, për vitin 2016, ashtu si edhe ne vitin 2015 më së shumti janë eksportuar ose vlerë me të lartë të eksportit kanë pasur pijet, pije të ftohta, pije alkoolike (alkoole), dhe uthulla nga kapitulli 22, me afro 17 mil. €, me pjesëmarrje prej 38% në totalin e eksportit.

**Figura 38: Eksporti i produkteve bujqësore për vitin 2016, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR


Me vlerë më të ulët vijjnë perimet dhe disa perime rrënjë dhe arra të tokës nga kapitulli 07, që kishte vlerë 5 mil. €, me pjesëmarrje prej 11% në eksportin e produkteve bujësore. Ndërsa me 9% e eksportit i takon kapitullit 11 ku janë të përfshiera produkte të përziara industriale, niseshte. Këto produkte nga tre kapitujt e përshkruar më lartë përbëjnë 58% të eksportit, pjesa tjetër e vlerës që janë në sasi më të vogël apo 42% i takojnë kapitujve tjerë.

**Tabela 71: Eksporti i produkteve bujqësore 2010-2016, në 1000 €**

Kapituj	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
01 Bagëtia	387	104	65	0	0	0	0
02 Mishi dhe organet e ngrënshme	44	14	5	23	109	175	247
03 Peshku, guacat e detit dhe kurrizorët e tjerë të ujit	20	29	120	0	0	32	37
04 Produktet e qumështit, vezët, mjalti	477	289	149	133	200	459	489
05 Produktet me origjinë shtazore	0	0	0	0	0	0	0
06 Drunj, bimë, lule	70	8	12	94	22	42	58
07 Perime dhe disa perime rrënjë dhe arra të tokës	3,686	2,642	2,946	2,642	4,927	3,201	4,792
08 Fruta dhe arra	656	1,677	1,609	2,122	2,588	2,931	3,845
09 Kafe, çaj, mëlmesa	968	573	717	1,371	2,729	3,180	2,170
10 Drithëra	154	120	79	32	420	724	335
11 Produkte të përziera industriale, niseshte	6,180	7,256	8,316	8,448	6,518	4,182	4,172
12 Vaj gatimi, kokrra të ndryshme, fara, fruta, bimë mjekuese, sanë, foragjere	502	489	681	691	1,347	1,279	1,444
13 Materiale ngjitëse, rrëshirë dhe ekstrakte të tjera	0	0	0	8	0	0	0
14 Materiale mbjellëse frutore, produkte frutore	0	0	0	0	0	0	7
15 Yndyra dhe vajra	100	45	59	46	19	41	9
16 Gatesa të mishit, peshkut, guacave të detit dhe kurrizorëve të tjerë të ujit	3	0	6	102	301	500	478
17 Sheqer dhe ëmbëlsira	168	141	137	171	159	699	804
18 Kakao dhe gatesa nga kakao	1,808	295	1,392	1,803	2,661	2,821	2,397
19 Gatesa për drithëra, miell, niseshte	388	705	704	1,021	1,497	2,104	1,903
20 Perime, pemë dhe arra të gatuar	3075	2854	2484	1599	1,752	2,253	3,753
21 Gatesa të ndryshme të ushqimit	261	139	164	167	317	336	441
22 Pije, pije të ftohta, pije alkoolike (alkoole), uthull	5,313	8,106	10,195	13,300	12,512	15,992	16,989
23 Foragjere për kafshë	419	698	899	1,086	1,296	732	888
24 Duhan dhe zëvendësues	70	0	69	88	0	0	0
<b>Gjithsej 1-24</b>	<b>24,749</b>	<b>26,185</b>	<b>30,807</b>	<b>34,947</b>	<b>39,372</b>	<b>41,683</b>	<b>45,257</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

**Figura 39: Produktet më shumë të eksportuara për vitin 2016 (1000€)**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Vlera më e madhe e eksportit ka qenë nga Ujrat, përfshirë ujrat minerale dhe ujrat e gazuar që kishin vlerë 4.8 mil. €, që në eksportin e produkteve bujqësore në kapitujt (01-24) ka pjesëmarrje prej 10.6%. Pas këtij produkti radhiten: Birrë e bërë nga malti në shishe në vlerë prej 3.8 mil. € dhe pjesëmarrje 8.4%; Miell prej grurit të forte 3.8 mil €, me 6.7% pjesëmarrje në eksport; Çokollata të mbushura kanë pasur vlerë 2.2 mil € ose 4.9% pjesëmarrje. Produktet tjera që janë radhitur sipas vlerës së produkteve të eksportuara janë: Patate të reja 1.8 mil € apo 4.9% pjesëmarrje në eksport, duke vazhduar me pemët manore: Mjedra, manaferra dhe pemë të imta të tjera të këtij grupi që kishte eksport në vlerë prej 1.8 mil.€ me pjesëmarrje në eksport prej 4%, dhe speca të përpunuara që kishin vlerë 1.3 mil € dhe pjesëmarrje në eksport 3%.

#### 4.2.5 Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)

Vlera totale e importit të produkteve bujqësore në vitin 2016 ka arritur shumën rreth 658 mil. €, ndërsa produktet që janë importuar më së shumti e që janë të ndara nëpër kapituj të caktuar janë të përshkruara si në vijim:Nga kapitulli 02 Mishi dhe organet e ngrëshme kishin vlerën 57 mil. €,pijet (alkoolike dhe jo alkoolike) apo 11% e importit. Pason importi nga kapitulli 04-Produktet e qumështit, vezët, mjalti me vlerë të importit 41 mil. €, që ka pjesëmarrje 6% në import, kapitulli 21- Gatesa të ndryshme të ushqimit ka pasur të importuar produkte me vlerë prej 58 mil. € ose 9% e totalit të importit.

**Figura 40: Importi i produkteve bujqësore për vitin 2016, në 1000 €**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR




Vlerë më të lartë të importit vërehet te kapitulli 22- Pije, pije të ftohta, pije alkoolike (alkoole), uthull me vlerë 70 mil. €, që zënë 11% të importit, duke vazhduar me kapitullin 24- Duhan dhe zëvendësues vlera e të cilit ka arritur në 58 mil. €, me pjesëmarrje prej 9%.

**Tabela 72: Importi i produkteve bujqësore 2010-2016, në 1000 €**

Kapituj	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
01 Bagëtia	8,042	6,010	8,444	9,315	12,216	9,524	7,930
02 Mishi dhe organet e ngrënshme	45,017	52,802	52,262	57,446	62,040	61,758	57,847
03 Peshku, guacat e detit dhe kurrizorët e tjerë të ujit	1,552	1,796	1,913	2,452	1,959	2,292	2,119
04 Produktet e qumështit, vezët, mjalti	32,575	36,938	37,792	35,682	38,309	37,750	41,474
05 Produktet me origjinë shtazore	722	906	890	873	815	647	521
06 Drunj, bimë, lule	2,191	2,260	2,596	2,827	2,691	4,493	5,233
07 Perime dhe disa perime rrënjë dhe arra të tokës	17,961	18,664	16,424	16,800	21,796	22,973	23,135
08 Fruta dhe arra	22,184	23,389	22,169	24,340	29,038	30,251	32,959
09 Kafe, çaj, mëlmesa	16,388	21,270	28,015	27,409	26,479	27,904	27,467
10 Drithëra	30,327	46,946	38,794	30,024	31,218	29,338	36,327
11 Produkte të përziera industriale, niseshte	13,661	13,294	18,358	14,790	14,647	15,048	12,823
12 Vaj gatimi, kokrra të ndryshme, fara, fruta, bimë mjekuese, sanë, foragjere	5,844	10,933	10,052	8,015	6,924	8,300	9,700
13 Materiale ngjitëse, rrëshirë dhe ekstrakte të tjera	54	95	92	141	260	225	305
14 Materiale mbjellëse frutore, produkte frutore	12	26	3	3	5	9	10
15 Yndyra dhe vajra	19,296	22,023	26,184	25,670	24,912	25,615	27,863
16 Gatesa të mishit, peshkut, guacave të detit dhe kurrizorëve të tjerë të ujit	16,938	20,192	20,675	23,046	24,471	25,298	24,843
17 Sheqer dhe ëmbëlsira	32,031	36,854	35,077	30,042	31,566	31,948	34,848
18 Kakao dhe gatesa nga kakao	16,709	18,538	17,449	19,601	20,679	21,266	22,258
19 Gatesa për drithëra, miell, niseshte	37,260	43,563	44,933	50,800	53,452	55,777	60,371
20 Perime, pemë dhe arra të gatuar	15,483	19,337	17,935	20,693	20,764	23,104	24,189
21 Gatesa të ndryshme të ushqimit	33,514	37,874	41,044	46,697	49,532	56,021	58,796
22 Pije, pije të ftohta, pije alkoolike (alkoole), uthull	55,409	57,900	57,688	59,555	65,779	63,374	70,388
23 Foragjere për kafshë	12,578	12,749	16,644	17,366	18,469	21,512	19,058
24 Duhan dhe zëvendësues	46,899	57,067	59,539	60,117	58,027	54,381	58,300
<b>Gjithsej 1-24</b>	<b>482,649</b>	<b>561,428</b>	<b>574,974</b>	<b>583,704</b>	<b>616,051</b>	<b>628,808</b>	<b>658,767</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

**Figura 41: Produktet më shumë të importuara për vitin 2016 (000 €)**



Një ndër produktet me vlerë më të madhe të importit nga kapitujt 01-24 janë cigaret, që kishin vlerë 58.1 mil. €, me pjesëmarrje në vlerën e importit 8.8%. Më pas radhiten kategoria Ujrat, përfshirë ujrat minerale dhe ujrat e gazuar që kishin vlerë 37.6 mil. € dhe pjesëmarrje prej 5.7%. Pason sheqeri i bardhë (26.5 mil. €), Vajrat dhe vajrat për përdorim teknik 17.4 mil. €, si dhe produkte tjera të prezantuara në figurë.

### 4.3 Çmimet në zinxhirin e vlerës

Përmes subvencioneve dhe granteve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka për qëllim që të reduktoj importin e produkteve bujqësore nga i cili ndikohen edhe çmimet e produkteve vendore. Tregu Kosovar është i vërshuar nga produktet e importuara të cilat mjaft po i dëmtojnë prodhuesit vendor dhe ekonominë e Kosovës në përgjithësi. Pasi që prodhimtaria vendore nuk po i plotëson nevojat e konsumit, një pjesë e madhe e produkteve importohet prej shteteve tjera për të përmbushur nevojat vendore. Edhe pse eksporti ka shënuar rritje, sasia e lartë e importit po ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në tabelat në vijim janë paraqitur çmimet për disa prodhime bujqësore dhe është bërë një krahasim në mes të çmimeve të prodhimit, importit (çmimi doganor) dhe të konsumit me shumicë dhe pakicë për periudhën 2010 – 2016.

**Tabela 73: Çmimet mesatare vjetore të disa prodhimeve bujqësore 2010-2016 (€/kg)**

Produktet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 (%)
Gruri	0.19	0.25	0.26	0.22	0.20	0.19	0.17	-11
Misri	0.22	0.29	0.30	0.31	0.28	0.23	0.24	4
Patate	0.29	0.30	0.32	0.43	0.34	0.33	0.32	-3
Lakra	0.18	0.17	0.24	0.17	0.19	0.23	0.21	-9
Speca	0.59	0.58	0.58	0.78	0.68	0.81	0.67	-17
Fasulje	1.80	1.95	2.47	2.63	2.92	2.68	2.46	-8
Domate	0.56	0.41	0.67	0.55	0.68	0.54	0.60	11
Molla	0.49	0.49	0.54	0.53	0.55	0.48	0.49	2
Rrush	0.80	0.93	0.93	0.85	1.02	0.91	0.84	-8
Pula (ferme)	1.94	2.12	2.12	2.29	2.33	2.06	2.04	-1
Qumësht	0.29	0.31	0.32	0.33	0.33	0.30	0.30	0
Mjaltë	7.42	8.11	8.52	8.83	9.00	9.77	9.87	1
Veze *	2.13	2.51	2.88	2.69	2.78	2.23	2.40	8

Burimi: ASK (Indeksi i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, 2010 – 2016), përpunuar nga DAESB – MBPZHR; \*njësia 30 copë

Bazuar në të dhënat nga tabela e mësipërme, çmimet në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, kanë pasur mjaftë luhajtje. Rënie më të dukshme të çmimit kanë pësuar specat, pasuar nga gruri dhe lakra. Rritjen më të madhe në çmime nga produktet e listuara në tabelë e kanë shënuar domatja me një rritje prej 11%, vezët me 8% dhe misri me 4%, ndërsa çmimet e produkteve tjera në tabelë nuk kanë shënuar ndryshime të mëdha për dallim nga viti 2015.

**Tabela 74: Vlerat e njësive të importit të disa prodhimeve bujqësore 2010-2016 (€/kg)**

Produktet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 (%)	V.nj. të çmimeve të imp/pr
Gruri	0.18	0.26	0.33	0.20	0.20	0.18	0.16	-11	0.94
Misri	0.13	0.20	0.35	0.21	0.21	0.16	0.18	13	0.75
Patate	0.21	0.26	0.22	0.24	0.30	0.30	0.32	7	1.00
Lakra	0.16	0.29	0.07	0.19	0.19	0.19	0.23	21	1.10
Speca	1.46	0.28	0.36	0.78	0.42	0.47	0.39	-17	0.58
Fasulje	0.74	0.87	1.02	0.87	1.14	1.17	0.91	-22	0.37
Domate	0.38	0.32	0.29	0.23	0.31	0.36	0.34	-6	0.57
Molla	0.21	0.28	0.71	0.35	0.29	0.33	0.32	-3	0.65
Rrush	0.56	0.74	1.01	0.46	0.55	0.44	0.52	18	0.62
Pula (ferme)	1.19	1.46	1.92	1.16	1.20	1.56	0.96	-38	0.47
Qumësht	0.68	0.68	0.65	0.61	0.62	0.60	0.58	-3	1.93
Mjaltë	3.82	4.39	4.81	4.71	5.02	4.99	5.47	10	0.55
Veze *	1.44	2.50	1.53	2.72	1.22	1.42	1.36	1	0.60

Burimi: Dogana e Kosovës, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; \*njësia 30 copë

Tabela e mësipërme paraqet disa çmime apo të ashtuquajtura vlera të njësive (unit values) të importit të produkteve bujqësore. Rritjen më të dukshme në çmim e ka shënuar lakra me 21% pasuar me rrushin me 18% dhe misrin me 13%. Në anën tjetër, disa produkte kanë pësuar rënie mjaft të madhe në çmim siç janë pula (ferme) me 38%, fasulja me 22% dhe specat me 17%. Edhe këtë vit produktet bujqësore të importuara ishin në dispozicion me çmim mjaft më të ulët se çmimi i produkteve vendore në Kosovë, kjo mund të jetë si rezultat i dallimeve në cilësi, afatit të liferimit dhe politikave të shteteve dhe kompanive eksportuese.

**Tabela 75: Çmimet mesatare vjetore të shitjes me shumicë (€/kg)**

Produktet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 (%)
Gruri	0.20	0.29	0.37	0.29	0.26	0.28	0.27	-4
Misri	0.19	0.27	0.34	0.40	0.41	0.48	0.39	-19
Patate	0.23	0.36	0.29	0.36	0.25	0.27	0.32	19
Lakra	0.16	0.25	0.28	0.28	0.32	0.25	0.19	-24
Specat	0.97	1.08	1.14	0.86	0.55	1.08	1.12	4
Fasulje	1.46	1.70	1.93	2.04	2.64	2.59	2.45	-5
Domate	0.73	0.70	0.82	0.68	0.51	0.43	0.64	49
Molla	0.48	0.70	0.51	0.52	0.43	0.49	0.47	-4
Rrush	1.50	2.04	2.04	1.47	2.04	1.74	1.64	-6
Pula (ferme)	1.17	1.68	1.51	1.60	2.15	1.77	1.39	-21
Qumësht	0.66	0.79	0.77	0.79	0.80	0.79	0.78	-1
Mjaltë	5.71	7.44	7.09	8.27	8.12	8.22	8.80	7
Vezë*	1.76	2.22	2.38	2.26	2.60	2.18	2.55	17

Burimi: Sistemi Informativ i Tregut, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; \*njësia 30 copë

Sipas tabelës së mësipërme e cila paraqet çmimet me shumicë të disa produkteve bujqësore, rritje më të dukshme në çmim kanë shënuar domatet me 49%, pasuar nga patatja me 19% dhe vezët me 17%. Produktet të cilat kanë pësuar rënie në çmim janë lakra çmimi i të cilave është 24% më i ulët se në vitin 2015, pasuar nga pula (ferme) me ulje të çmimit prej 21% dhe misri me 19%. Produktet tjera në listë nuk kanë pasur ndryshime të mëdha. Çmimet e shitjes me shumicë janë zakonisht më të larta se çmimet e prodhimit, mirëpo për prodhimet me pjesëmarrje të lartë të importeve me çmime të ulëta kjo rregull mund të mos vlejë.

**Tabela 76: Çmimet mesatare vjetore të shitjes me pakicë (€/kg)**

Produktet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 (%)
Gruri	0.24	0.33	0.43	0.33	0.30	0.31	0.30	-4
Misri	0.24	0.30	0.40	0.44	0.49	0.52	0.44	-15
Patate	0.31	0.45	0.37	0.46	0.43	0.32	0.38	17
Lakra	0.25	0.38	0.36	0.35	0.38	0.29	0.24	-17
Speca	1.22	1.29	1.41	0.99	0.70	1.23	1.30	6
Fasulje	1.80	1.99	2.28	2.27	2.89	2.80	2.64	-6
Domate	0.95	0.87	1.00	0.79	0.65	0.51	0.76	49
Molla	0.65	0.87	0.66	0.60	0.62	0.57	0.57	1
Rrush	1.81	2.23	2.45	1.65	2.45	1.91	1.79	-6
Pula (ferme)	2.25	1.98	1.87	1.94	2.43	2.01	1.72	-14
Qumësht	0.81	0.86	0.87	0.88	0.87	0.84	0.82	-2
Mjaltë	7.2	8.49	8.3	9.22	9.1	9.27	9.73	5
Vezë*	2.08	2.59	2.76	2.48	2.84	2.32	2.94	27

Burimi: Sistemi Informativ i Tregut, përpunuar nga DAESB – MBPZHR, \* Njësia për 30 copë

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur çmimet me pakicë në të cilën vërehen ndryshimet më të dukshme në çmime tek misri, patatet, lakra, domatet, pula (ferme) dhe vezët. Lakra dhe misri pësuan rënie të çmimit prej 17% respektivisht 15%, poashtu rënie jo të vogël në çmim pësuan edhe pula (ferme) me 14%. Në anën tjetër, rritje të lartë të çmimit shënuan domatet me 49%, ndërsa rritje mesatare kemi te vezë me 27% dhe te patatja me 17%. Çmimet e shitjes me pakicë në tregun vendor zakonisht janë më të larta se ato të prodhimit, me përjashtim të mundshëm të disa prodhimeve, furnizimi i të cilave në tregun me pakicë e ka origjinën në masë të madhe nga importi më i lirë.

**Tabela 77: Krahasimi i çmimeve të disa prodhimeve në Kosovë me disa vende të BE-së, 2016 (€/kg)**

Shteti	Gruri	Misri	Patate	Lakra	Molla	Mjaltë	Vezë*
Bullgaria	0.14	0.14	0.19	0.18	0.23	2.55	5.21
Republika Çeke	0.14	0.14	0.19	0.19	0.36	4.18	6.18
Greqia	0.19	0.22	0.49	0.36	0.56	5.84	18.38
Hungaria	0.13	0.13	0.23	0.24	0.26	2.57	5.35
Austria	0.10	0.12	0.15	0.25	0.35	12.00	13.96
Rumania	0.14	0.16	0.31	0.31	0.59	3.37	6.90
Kosova	0.17	0.24	0.32	0.21	0.49	9.87	8.00

Burimi: Eurostat dhe ASK, \* Njësia për 100 copë

Tabela më lartë paraqet çmimet e prodhimeve bujqësore në disa vende të Bashkimit Evropian dhe në Kosovë. Pasi që importi në Kosovë është shumë i lartë, ndryshimet e çmimeve në tregun ndërkombëtar dhe në vendet e rajonit do të kenë ndikim në çmimet në tregun e Kosovës. Duke marrë parasysh të ardhurat e ulëta në Kosovë, rritja e çmimeve sidomos të produkteve bazike ndikon negativisht në standardin jetësor të popullatës në Kosovë.

Sipas tabelës së mësipërme mund të konstatojmë se Kosova ka çmime relativisht të larta në krahasim me vendet e tjera të BE-së. Kjo siç u përmend edhe më herët është si rezultat i sasisë së ulët të prodhimit vendor, kostos së lartë të prodhimit dhe pjesëmarrjes së lartë të importit. Nëse e analizojmë çmimin e grurit, mund të vërejmë se krahasuar me vendet tjera (pos Greqia me 0.19 €/kg), Kosova ka një çmim relativisht më të lartë sesa Bullgaria, Rep. Çeke dhe Hungaria. Çmimin më të ulët të grurit sipas të dhënave në tabelë e ka Austria (0.10 €/kg). Çmimi i Misrit është më i larti në Kosovë krahasuar me shtetet tjera, ndërsa më i ulëti është në Hungari dhe Austri me çmim prej 0.12 €/kg. Çmimi i Patates në Kosovë nuk është i kënaqshëm, krahasuar me Austrinë e cila ka çmimin më të ulët, çmimi i patates në Kosovë është 108% më i lartë, ndërsa në krahasim me Greqinë është 35% më i ulët. Lakra në Kosovë ka çmim mjaft konkurrues me vendet e BE-së, pak më të lartë se Bullgaria dhe Rep. Çeke për 19% respektivisht 12%, ndërsa për 42% më të ulët se Greqia. Bazuar në të dhënat në tabelë mund të vërejmë se çmimi i Mollës në Kosovë është mjaft i lartë krahasuar me vendet tjera si Bullgaria, Hungaria, Austria dhe Rep. Çeke ndërsa vetëm Rumania dhe Greqia kanë çmim më të lartë prej rreth 20%. Sikurse në vitin 2015 edhe në vitin 2016 çmimi i mjaltës në Kosovë ishte më i larti në krahasim me vendet tjera, vërehet vetëm Austria që kishte një çmim të përafërt të mjaltës me Kosovën përderisa vendet tjera kishin çmim dukshëm më të ulët. Çmimi i vezëve në Kosovë është më i lartë se shumica e shteteve në listë përveç Greqisë dhe Austrisë çmimi i të cilave është 130% dhe 75% më i lartë se në Kosovë.

Në përgjithësi, bazuar në të dhënat në tabelën e mësipërme mund të konkludojmë së çmimet në Kosovë janë mjaft të larta duke pasur parasysh standardin e jetesës. Kosova si treg i vogël me prodhim të ulët vendor është shumë e varur nga importi e si rezultat edhe çmimet diktohen nga importi. Për këtë arsye nevojitet hartim i politikave bujqësore të cilat mundësojnë rritje të prodhimitarisë vendore, përmirësim të cilësisë, rritje të aftësive konkurruese dhe në përgjithësi nevojitet promovim dhe mbështetje më e madhe për prodhimet vendore.

## **4.4 Siguria dhe cilësia e ushqimit**

### **4.4.1 Siguria e ushqimit**

#### **Institucionet përgjegjëse dhe korniza ligjore**

Qëllimi kryesor i politikave të EU-së në sigurinë e ushqimit është mbrojtja e shëndetit të konsumatorve duke garantuar funksionim të drejtë të politikave të përbashkëta për mbrojtjen e konsumatorit dhe kjo duhet të jetë pjesë e politikave ekonomike dhe sociale.

Bazuar në nenin 1 të ligjit për Mbrojtje të Konsumatorit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 32 të datës 20.11.2012) të drejtat elementare të konsumatorit që duhet të rregullohen dhe të mbrohen gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave tjera në

tregun e lirë derisa shitësit dhe prodhuesit ose furnizuesit duhet ti marrin të gjitha përgjegjësitë që të veprojnë në shërbim të konsumatorit.

Qëllimi kryesor i politikave të BE-së për sigurinë ushqimore është mbrojtja e interesit dhe shëndetit të konsumatorëve duke garantuar një funksionim të duhur të politikave të përbashkëta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe kjo duhet të jetë pjesë integrale e politikave sociale dhe ekonomike në Kosovë. Sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 32 datë 2012/11/20), të drejtat themelore të konsumatorëve duhet të rregullohen dhe mbrohen gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave të tjera në tregun e lirë ndërsa shitësit, prodhuesit ose furnizuesit duhet të marrin përsipër të gjitha përgjegjësitë për të vepruar në shërbim të konsumatorëve.

Institucionet që bashkëveprojnë mbi sigurinë e ushqimit në Kosovë janë: MBPZHR, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, dhe Ministria e Shëndetësisë. Brenda MBPZHR-së, Instituti Bujqësorë i Kosovës (IBK) dhe Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë, janë të përfshira edhe në hartimin e politikave të ushqimit. Aktualisht roli i MBPZHR-së për sigurinë e ushqimit është ende i pacaktuar. Megjithatë, roli i saj pritet të përcaktohet dhe miratohet nga ligji i ri i hartuar nga MBPZHR-ë. Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike është i ngarkuar edhe me testimin e ushqimit.

Çdo shpërndarje e produkteve me origjinë shtazore apo kafshëve të gjalla duhet të jetë subjekt i inspektimit veterinar të importuar në Kosovë. Inspektimi veterinar bëhet në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe në magazinat doganore. Ka gjithsej nëntë (9) Pikat të Inspektimit Kufitar (PIK) në Kosovë.

AUV është autoriteti kryesor për të siguruar sigurinë e ushqimit në Republikën e Kosovës. Me miratimin e Ligjit për Ushqimin (seksioni 36), AUV është i lidhur drejtpërdrejt me Zyrën e Kryeministrit. Në bazë të nenit 38 të këtij ligji, Agjencia është përgjegjëse për të verifikuar dhe inspektuar ushqimin dhe përbërësit e ushqimit në të gjitha nivelet e zinxhirit ushqimor.

AUV është gjithashtu përgjegjës për të luftuar dhe parandaluar sëmundje të transmetueshme midis kafshëve, për të rregulluar praktikën veterinare mjekësore, inspektimin e produkteve me origjinë shtazore, inspektimin e produkteve të importuara, eksportuara, kalimin kalimtar (tranzit) të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, të rregullojnë detyrat dhe detyrimet e institucioneve të qeverisjes publike qendrore dhe lokale dhe zyrtarëve të emëruar për të punuar në institucionet e përmendura.

Agjencia përbëhet prej pesë Drejtorive:

1. Drejtoria e Shëndetit Publik,
2. Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve,
3. Drejtoria e Inspektoratit (veterinar, fitosanitar dhe sanitar) ku bëjnë pjesë edhe gjashtë (6) zyra regjionale,

4. Drejtoria e Laboratorit, dhe

5. Drejtoria e Administratës.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) është një institucion arsimor dhe shkencor multi-disiplinor përgjegjës për zhvillimin e strategjive të shëndetit në fushën e epidemiologjisë, edukimin dhe promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve, diagnozës laboratorike dhe informacionit shëndetësor.

Shtirja e IKSHPK, është e rregulluar me Ligjin Nr. 02 L-78 mbi shëndetin publik. Në kuadër të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), Fakulteti i Gjeo-shkencës dhe Teknologjisë (Departamenti i Teknologjisë Ushqimore (DTU)) dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamentet e Kimisë dhe Biologjisë) ofrojnë ekspertizë të çmuar në lidhje me sigurinë e ushqimit.

### **Operatorët e Biznesit me Ushqim**

Ekzistojnë tri ligje të miratuara që rregullojnë politikën veterinare: Ligji për Blegtori Nr. 04/L-191 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25/2013/08/07) e cila është baza ligjore për funksionimin e përgjithshëm të sektorit të Blegtorisë në Kosovë, Ligji i dytë Nr. 02/1-10 për Kujdesin e kafshëve dhe i treti është Ligji Nr. 2003/26 për Produkte të Mjekësisë dhe Pajisjet i cili u shfuqizua më 30.09.2010 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Aktualisht AUV funksionon në bazë të Ligjit Nr. 2004/21 mbi Veterinën dhe Udhëzimet Administrative të MA-Nr. 07/2005; MA-Nr. 26/2006 për çështje që lidhen me Pajisje Veterinare.

Vendosja e ushqimit, ushqimit të kafshëve dhe të produkteve të kafshëve në treg është e rregulluar me Ligjin për Veterinarinë i cili rregullon qarkullimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, inspektimin veterinar për import/eksport dhe transportit kalimtarë të kafshëve të gjalla. Ligji gjithashtu përcakton të drejtat dhe detyrat e qeverisë qendrore, komunave dhe personave fizik që punojnë në këtë fushë. Përveç Ligjit për Veterinari, kjo fushë është rregulluar edhe me Ligjin për Ushqimin dhe Rregulloret mbi pakon higjienike.

### **Standardet Ushqimore**

Industria përpunuese është duke u mbështetur vazhdimisht nga MBPZHR, Komisioni Evropian dhe nga donatorët tjerë përmes granteve të ndryshme. Këtu bëhet fjalë për Masën 103. – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Me zbatimin e kësaj mase është synuar: Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive dhe produkteve të reja; Përafrimi me standardet e BE-së dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve, mirëqenien e kafshëve dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe forcimi i lidhjeve me prodhimin primar.



Me avansimin e teknologjisë bashkohore nga prodhuesit dhe përpunuesit janë duke u implementuar standardet ushqimore ndërkombëtare, si dhe janë duke u implementuar rregullat e HACCP dhe ISO standardeve në prodhimin e tyre të përditshëm, të cilat ndikojnë dukshëm në nivelin e higjienës së hapsirave të tyre dhe vetë sigurinë e prodhimeve ushqimore.

#### 4.4.2 Analizat e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve

##### Analizat në laboratorët IBK-së dhe AUV

Bazuar në raportin për shërbime laboratorike të Institutit Bujqësor të Kosovës, shihet se gjatë vitit 2016, janë kryer gjithsej 5,832 analiza të llojeve të ndryshme si: analizat e testimit analitik të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë të produkteve ushqimore dhe imputeve bujqësore, analizat e testimit analitik të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike, analizat e testimit të kontrollit të kualitetit të farërave, analizat fitopatologjike dhe mikrobiologjisë ushqimore dhe analizat fizike dhe kimike të mostrave të tokës dhe ujit për ujitje. Tabela në vijim jep një pasqyrë të analizave për vitet 2015 dhe 2016.

**Tabela 78: Llojet e analizave të kryera në laboratorët e IBK-së për vitet 2015/2016**

Llojet e analizave të kryera	2015	2016
Analizat e testimit analitik të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë të produkteve ushqimore dhe imputeve bujqësore	2,752	2,678
Analizat e testimit analitik të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike	928	940
Analizat e testimit të kontrollit të kualitetit të farërave	281	318
Analizat fitopatologjike dhe mikrobiologjisë ushqimore	953	947
Analizat fizike dhe kimike të mostrave të tokës dhe ujit për ujitje	822	949
<b>Gjithsej</b>	<b>5,736</b>	<b>5,832</b>

Burimi: Instituti Bujqësor i Kosovës – IBK

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë, gjatë vitit 2016, ka kryer aktivitetet e parapara me legjislacionin në fuqi. Në vazhdim do të paraqiten aktivitetet e sektorëve të LUV-ës gjatë vitit 2016 dhe krahasimin e tyre me vitin 2015.

Në sektorin e pranimit të mostrave, janë pranuar gjithsej 20,554 mostra si në vijim:

-Për sektorin e analizave të qumështit janë pranuar 19,521 mostra,

-Për sektorin e kimit ushqimore 559 mostra dhe

-Për sektorin e mikrobiologjisë 474 mostra,

Ndërsa në sektorin e pranimit në pjesën e Laboratorit të shëndetit të kafshëve janë pranuar mostrat:

-Për sektorin e serologjisë janë pranuar 17,533 mostra,

-Për sektorin e patologjisë janë pranuar 59 mostra,

-Për sektorin e bakteriologjisë janë pranuar 59 mostra.

**Tabela 79: Marrja e mostrave në sektorë për vitet 2015/2016**

Sektorët	2015	2016
Sektori i Analizave të Qumështit	19,253	19,521
Sektori i Kimisë Ushqimore dhe Mbetje Veterinare	735	559
Sektori i Mikrobiologjisë së Ushqimit	422	474
<b>Gjithsej</b>	<b>20,410</b>	<b>20,554</b>

Burimi: AUVK

Në sektori e Patologjisë gjatë vitit 2016, janë kryer gjithsej 200 analiza të egzaminimit të mostrave të eshtrave të dhelprave në marker të vaksinës së tërbimit, egzaminimit të mostrave të eshtrave të ujkut në marker të vaksinës së tërbimit, egzaminimit të mostrave të serumit të dhelprave në përgjigje imunologjisë në tërbim me testin ELISA, egzaminimit anatomopatologjik i kufomave të zogjve të pulave, etj. Ndërsa, në vitin 2015 janë testuar 600 mostra. Arsyeja për numër më të madh të testuar të mostrave në 2015, është se projekti i shëndetit të kafshëve kanë sjellë mostra jashtë planit të kontrolleve zyrtare.

**Tabela 80: Analizat e egzaminimit të mostrave për vitin 2016**

Lloji	Numri
Ekzaminimi i mostrave të eshtrave të dhelprave në marker të vaksinës së tërbimit	63
Ekzaminimi i mostrave të eshtrave të ujkut në marker të vaksinës së tërbimit	9
Ekzaminimi i mostrave të eshtrave të kunadhe (shqarshit) në marker të vaksinës së tërbimit	2
Ekzaminimi i mostrave të eshtrave të vidrës në marker të vaksinës së tërbimit	1
Ekzaminimi i mostrave të serumit të dhelprave në përgjigje imunologjisë në tërbim me testin ELISA	59
Ekzaminimi i mostrave të serumit të ujkut në përgjigje imunologjisë në tërbim me testin ELISA	8
Ekzaminimin anatomopatologjik i kufomave të pulave	23
Ekzaminimi anatomopatologjik i kufomave të zogjve të pulave	30
Ekzaminimi i kufomave të dhive	4
Ekzaminimi i trurit të qenit në tërbim me testin IFA	1
<b>Gjithsej</b>	<b>200</b>

Burimi: AUVK

Në sektori i bakteriologjisë, gjatë vitit 2016, janë kryer gjithsej 434 analiza, krahasuar me analizat e vitit 2015, që janë kryer 229 analiza. Këto analiza janë të llojit: izolim, antibiogram, egzaminim mikroskopik, identifikim, testi rapid imunolromatografik, sëmundje parazitare, etj. Vlenë të ceket se këto analiza janë kryer te këto lloje të kafshëve/shpezëve: gjedhi, pula, bletët dhe dhia (kecat), tek të cilët janë marrur mostra të ndryshme, më shumë detaje gjenden në tabelen e mëposhtme.


**Tabela 81: Analizat e kryera për sektorin e bakteriologjisë për vitin 2016**

Lloji i kafshës	Lloji i mostrës	Lloji i analizës	Identifikimi i bakteries, parazitit	Nr. i testeve të kryera
Gjedhi	Veshi- gjak	Izolim	Antraks	32
Gjedhi	Qumësht	Izolim	Staph.aureus E.coli	26
Gjedhi	Qumësht	Antibiogram	Staph.aureus E.coli	26
Bletë	Bletë, korniza me larva	Egzaminim mikroskopik, izolim,identifikim,testi rapid imunokromatografik	Murtaja Evropiane e bletëve	222
Bletë	Bletë, korniza me larva	Egzaminim mikroskopik, izolim,identifikim,testi rapid imunokromatografik	Murtaja Evropiane e bletëve	9
Bletë	Bletë	Sëmundje parazitare	Nozemoze	16
Bletë	Bletë, larva	Sëmundje parazitare	Varoze	16
Pula	Mëlqi, shpretkë, zorrë	Izolim	Salmonella	41
Pula	Zorrë	Egzaminim mikroskopik	Kokcidioze	3
Pula	Pupla	Egzaminim mikroskopik	Dermanyssus	2
Pula	Strisho kloakale	Imunologjike rapid imunokromatografik	New Castle	20
Pula	Strisho kloakale	Imunologjike rapid imunokromatografik	Avian Influenca	20
Dhia (keci)	Zorrë, mëlqi, shpretkë	Izolim	Salmonella	1
<b>Gjithsej</b>				<b>434</b>

Burimi: AUVK

Sektori i serologjisë molekulare, nga 01.01.2016 deri me 31.12.2016 kanë ardhur 17,476 mostra dhe janë kryer 28,291 teste. Një pjesë e mostrave janë analizuar për më tepër se një parameter. Përveç punëve në diagnostikë, janë kryer dhe trajnime, teste të proficiencës dhe teste ndër laboratorikë, kontrolla të cilësisë në punë konform SMC-së.


**Figura 42: Plani i survejancës aktive për vitin 2016**



Burimi: AUVK

Krahasimi i mostrave mes vitit 2015 dhe 2016, në 2015 kanë arritur gjithsej 12,797 mostra, ndërsa në 2016, kanë arritur 36.6% më shumë mostra krahasuar me vitin 2015. Në figurën në vijim janë paraqitur testet për vitet 2015 dhe 2016, në baza mujore.

**Figura 43: Testet për vitet 2015/2016, në baza mujore**



Burimi: AUVK

Spektori i mikrobiologjisë ushqimore gjatë vitit 2016, në këtë sektor janë kryer gjithsej 2,531 teste edhe ato mostra si në vijim: 1,468 mostra në salmoneloze, 467 në listeria monocitogenes, 432 në E.Coli, 93 në enterobacteriace, 11 në totalin e mikroorganizmave aerob, 55 në stafilococci coagulasa – pozitive dhe ne coliforme 5 mostra.

**Tabela 82: Mostrat e arritura për vitet 2015/2016**

Viti/Matriksi ushqimor	Mish dhe produkte të mishit	Qumësht dhe produkte të qumështit	Vezë dhe produkte të vezëve	Të tjera	Totali
2015	230	162	27	5	424
2016	293	141	35	5	474

Burimi: AUVK

Sektori i kimisë ushqimore dhe i mbetjeve veterinarë, në këtë sektor janë realizuar gjithsej 524 mostra, për PFK mish, PFK qumësht, private, freskia e vezëve, aflatoxin B1, aflatoxin M1, PN chloramphenicoli - qumësht UHT dhe PNMM mostrat që testohen.

**Tabela 83: Mostrat e testuara për vitet 2015/2016**

Mostrat e testuara	2015	2016
PFK - Mish	87	-
PFK - Qumësht	52	15
Private	-	2
Freskia e vezëve	-	14
Aflatoxin B1	203	301
Aflatoxin M1	39	56
PN - Chloramphenicoli - qumësht UHT	0	0
PNMM - mostrat që testohen	305	131
Private	9	5
<b>Totali</b>	<b>695</b>	<b>524</b>

Burimi: AUVK

Sektori i analizave të qumështit, në këtë sektor janë testuar 19,523 mostra të qumështit të cilat janë marrur nga fermerët për testimin e cilësisë së qumështit, këto mostra janë testuar me tri aparatura bactoscan, milkoscan dhe fosomatik dhe gjithsej janë kryer 49,348 teste.

**Tabela 84: Analizat e qumështit në bazë të aparaturave për vitet 2015/2016**

Viti	Bactoscan	Milkoscan	Fossomatik	Totali
2015	19,243	18,172	18,051	55,466
2016	17,946	14,701	16,701	49,348
<b>Totali</b>	<b>37189</b>	<b>32873</b>	<b>34752</b>	<b>104814</b>

Burimi: AUVK

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë i AUV-së monitoron dhe diagnostifikon sëmundjet e kafshëve, kryen analizat të ushqimit me prejardhje shtazore, kryen monitorimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit, mbetjeve veterinarë dhe kontaminanteve në ushqim dhe ushqimit të kafshëve.

Gjatë këtij viti në laboratorët e LUV, respektivisht në laboratorin e shëndetit të kafshëve janë sjellur 16,221 mostra. Në laboratorin e sigurisë ushqimore janë sjellur 970 mostra, ndërsa në laboratorin e qumështit janë sjellur 17,176 mostra. Të gjitha mostrat janë analizuar sipas procedurave standarde operative.

Edhe gjatë vitit 2016 AUV ka vazhduar me vlerësimin e kompanive agro-ushqimore si në industrinë e qumështit, mishit, therrtove dhe depove ftohëse.

Pas percjelljes, studimit dhe analizimit të gjendjes nga AUV janë aprovuar leje për operatorë të biznesit me ushqim me origjinë shtazore:

1. Qumështore 1;
2. Thertore të gjedheve 8;
3. Fabrika të përpunimit të mishit 7; dhe
4. Depo Ftohëse 7.

Gjithashtu është miratuar regjistrimi i OBU-ve me prejardhje jo shtazore:

1. Fabrika për përpunimin dhe grumbullimin e pemëve dhe perimeve 21;
2. Fabrika për përpunim të erëzave 6;
3. Fabrika të verës dhe rakisë 5;
4. Furra buke dhe pjekurinave 1;
5. Fabrika për përpunimin e pijeve të gazuara dhe energjetike 2;
6. Fabrika për prodhimin e ëmbëlsirave dhe konditorive 6;
7. Fabrika për prodhimin e ketch-up -it dhe majonezës 1.

### **Aktivitetet në fushën e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve**

Gjatë vitit 2016, kemi pasur shpërthim të sëmundjes Gungore të Gjedhit (Lumpy Skin Disease), kjo sëmundje ka qenë prezent në të gjitha shtetet e rajonit ( Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Greqi, Bullgari, Turqi etj.). Komisioni Evropian ka dhuruar 25,000 doza të vaksinës, ndërsa nga buxheti janë siguruar 235,000 doza të vaksinave. Vaksinimi masiv ka filluar me 15 shtator ndërsa ka përfunduar me 6 Tetor, ku janë vaksinuar 241,000 gjedhe në gjithë teritorin e Republikës së Kosovës.

-Në Programet e vaksinimit kundër sëmundjeve të ndryshme janë vaksinuar gjithsej 370,331 krerë kafshë (kundër LSD janë vaksinuar 241,000 kafshë, kundër brucelozës janë vaksinuar 95,100 kafshë, kundër mortajës klasike janë vaksinuar 27,497 derra dhe kundër antraksit janë vaksinuar 6,734 kafshë).

-Edhe këtë vit, AUV-i ka ndërmarrë aksionin për eliminimin e rriqrave si burim i sëmundjes së etheve hemorragjike, në 70 fshatrat e komunave Malishevë, Suharekë Rahovec, Klinë ku janë spërkatur 55, 276 krerë gjedhe.

-Mbikëqyrja/autorizimi i importit të kafshëve të gjalla (223 leje importi ), ushqimit për kafshë, materialit gjenetike dhe produkteve mjekësore veterinare (PMV) dhe marketing autorizimi- 50 leje importi.

-Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve të gjalla (i gjedheve) në tërë territorin e Kosovës, duke përfshi, identifikime të reja (162,560), lëvizjet (28,473).

### **Inspektimet veterinare**

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, gjegjësisht Inspektorati i AUV-it me qëllim të implementimit të ligjeve në fuqi dhe legjislacionit sekondar, ka kryer aktivitetet si në vijim :

- a) Janë kryer 7,008 inspektime të operatorëve të biznesit me qëllim të arritjes së përputhshmërisë me rregullat e definuar me legjislacion nga ana e inspektoratit të brendshëm.
- b) Janë inspektuar 47, 889 lëndë të inspektuara nga ana e inspektoratit kufitar ( ai veterinar dhe fitosanitar )
- c) Janë lëshuar 162 fletëparaqitje për shkeljet e kryera nga operatorët e bizneseve të dorëzuara në gjykata përkatëse
- d) Janë lëshuar 375 certifikata veterinare për eksport dhe 2,266 fitocertifikata për eksport, të produkteve të ndryshme për eksport në vendet tjera.
- e) Janë marrë 5,353 mostra të produkteve të ndryshme për analiza laboratorike si dhe 978 strisho nga sipërfaqet punuese, stabilimentet dhe pajisjet tek prodhuesit e ushqimit.
- f) Inspektorati i Agjencisë ka sjellë vendime për asgjësime të produkteve ushqimore dhe joushqimore, të dëmshme për konsum human si dhe të rrezikshëm për shëndet publik, shëndet të kafshëve dhe bimëve, janë asgjësuar si në vijim:
- g) Janë asgjësuar 213,489 kg artikuj ushqimor, produkte ushqimore me origjinë shtazore,
- h) Janë asgjësuar 355,547 kg produkte ushqimore me origjinë bimore.
- i) Janë asgjësuar 94,064 litra lëngje

Si pasojë e sëmundjeve të ndryshme janë asgjësuar; 279 gjedhe, 48 dele, 8,000 pula dhe 232 shoqëri bletësh.

### **4.4.3 Legjislacione për veterinën dhe funksionimin e tregut**

Ekzistojnë tri ligje të miratuara që rregullojnë politikën veterinare. Ligji për Blegtori Nr. 04/L-191 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25/2013/08/07) e cila është baza ligjore për funksionimin e përgjithshëm të sektorit të Blegtorisë në Kosovë. Ligji i dytë Nr. 02/1-10 për Kujdesin e kafshëve dhe i treti është Ligji Nr. 2003/26 për Produkte të Mjekësisë dhe Pajisjet i cili u shfuqizua më 30.09.2010 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Vendosja e ushqimit, ushqimit të kafshëve dhe të produkteve të kafshëve në treg është e rregulluar me Ligjin për Veterinarinë i cili rregullon qarkullimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, inspektimin veterinar për import/eksport dhe transportin kalimtarë të kafshëve të gjalla. Ligji gjithashtu përcakton të drejtat dhe detyrat e qeverisë qendrore, komunat dhe personat fizik që punojnë në këtë fushë. Përveç Ligjit për Veterinari,

kjo fushë është rregulluar edhe me Ligjin për Ushqimin dhe Rregulloret mbi pakon higjienike.

### **Legjislacioni për ushqimin e kafshëve**

Politikat e Përbashkëta për Sigurimin e Ushqimit në vendet e BE-së për sigurinë e ushqimit të kafshëve të përcaktuara me Rregullorën e BE-së Nr. 183/2005 mbi higjienën e ushqimit të kafshëve kërkon nga operatorët e biznesit të ushqimit të kafshëve (për prodhimin bazë të ushqimit të kafshëve) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar, eliminuar dhe reduktuar rreziqet lidhur me ushqimin e kafshëve, për të siguruar sigurinë gjatë përgatitjes, prodhimin, pastrimin e ushqimit, paketimin, ruajtjen dhe transportimin e ushqimit të kafshëve.

Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25/2013/08/07) kërkon nga operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë që të sigurojnë që materiali ushqyes i kafshëve i vendosur në tregje të Kosovës, (pavarësisht nëse ato përmbajnë aditivë) të jetë i shëndetshëm, cilësor, i pastërt dhe i tregtueshëm. Nga numri i përgjithshëm i biznesit në këtë fushë, shumica e tyre janë operatorë të shitjes me pakicë (93).

## **4.5 Emetimi i gazrave serrë në Kosovë**

### **4.5.1 Emetimet nga sektori i bujqësisë**

Me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë njerëzit gjithnjë e më shumë janë duke ndikuar në klimën dhe temperaturën e tokës duke djegur lëndët djegëse, duke pakësuar pyjet tropikale dhe duke shtuar numrin e bagëtive në fermat bujqësore. Vlerësimet konfirmojnë se inovacioni, duke përfshirë përparimin në energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, është nxitësi kryesor i reduktimeve të emetimeve në vitet e fundit që njihen si "Gazra Serrë", kur dihet se "Efekti Serrë" është një nga shkaqet kryesore të ngrohjes globale. Sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit (United States Environmental Protection Agency-EPA) gazrat serrë me ndikim më të madh janë: avulli i ujit, dioksidi i karbonit, metani dhe dioksidi i azotit.

Kur flasim për ndryshimet klimatike, projeksionet dhe ndikimet në mjedis, kjo mbetet një sfidë e madhe për vendin tonë për shkak të informatave të kufizuara, dhe ndërprerjeve të tyre në seri kohore, me ç'rast mundësitë për studime të veçanta janë të kufizuara.


Një ndër sektorët që kanë ndikim më të theksuar nga ndryshimet klimatike është edhe bujqësia. Sektori i Bujqësisë, ka pjesëmarrje prej 7% të emetimit të përgjithshëm të gazrave serrë në Kosovë ose rreth 700 Gg (Giga gram) CO<sub>2</sub> ekuivalent, përkatësisht 700 mijë ton CO<sub>2</sub> ekuivalent. Emisionet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant sipas TIER 1.



Ky sektor i takon kategorisë së tretë sipas IPCC 2006, përbëhet nga dy nën sektorë (kategori) tjera. Nën sektori i parë 3A përfshinë emetimin nga bagëtia. Këtu bëjnë pjesë kryesisht emetimet e metanit nga fermentimi enterik (procesi digjestiv i kafshëve) dhe emetimet e oksidit të azotit dhe metanit nga menaxhimi i plehrave të kafshëve. Nga ky nën sektor vijnë rreth 550 Gg CO<sub>2</sub> ekuivalent në vit. Nën sektori i dytë 3C trajton emetimet nga fertilizimi i tokës dhe nga djegia e biomasës.

Kategoritë më të rëndësishme të këtij nën sektori janë emetimet indirekte të oksidit të azotit që lidhen me menaxhimin e plehrave dhe fertilizimin e drithërave. Gjithsej, ky nën sektor emeton rreth 150 Gg CO<sub>2</sub> ekuivalent në vit.

**Figura 44: Burimet kryesore të emetimeve të GS në sektorin e bujqësisë (%)**



Burimi: Inventari i gazrave serrë për vitin 2014, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Kur bëhet fjalë për ndryshimet klimatike që mund të shfaqen në bujqësi si më të theksuara mund të numërohen: prodhimi i zvogëluar dhe humbjet e korrjes së drithërave, rritja e kërkesës për ujitje të kulturave, shtimi i vdekshmërisë në blegtori dhe reduktimi i produktivitetit; rritja e ekspozimit ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve të reja, reduktimi i reshjeve vjetore, zvogëlimi i burimeve të ujit, pakësimi i sasisë së ujërave nëntokësorë, mungesa e ujit të pijshëm; ujit për ujitje dhe industri; pakësimi i sasisë së ujit nëpër lumenj gjatë verës; shfaqja e sëmundjeve të reja në kulturat bujqësore si dhe rritja e temperaturës së ujit gjë që ndikon në uljen e kualitetit të ujit.

Ndërsa sa i përket pylltarisë ndikimet më të theksuara nga ndryshimet klimatike shprehen në: shtimin e numrit të zjarreve pyjore, paraqitjen e një numri të shtuar të sëmundjeve tek bimët, degradimi i tokës dhe erozioni i dheut, zvogëlimi i zonave pyjore nga ndikimi i thatësirave; ndryshimi i lartësive gjeografike për rritjen e llojeve të caktuara të drunjeve, shtimi i insekteve dhe patogjenëve. Minierat e linjtit dhe vendburimet minerale, trajtimi i pamjaftueshëm i ujërave të zeza dhe mungesa e ndërjegjësimit mjedisor të popullatës kontribuon në ndotjen serioze të ajrit dhe ujit dhe degradimin e vazhdueshëm të mjedisit.

Sipas projeksioneve që janë bërë për ndryshimet klimatike parashikohet që Ballkani Perëndimor, do të përfshihet nga një ngrohje rajonale më e lartë se sa mesatarja në botë, sidomos për zonat malore, do të ketë zvogëlim të reshjeve të përgjithshme vjetore, me zvogëlime të dukshme gjatë muajve të verës<sup>8</sup>. Gjithashtu parashikohet rritje në reshjet dimërore, veçanërisht në male, duke rezultuar me përmytje të shpeshta në stinën e pranverës.

Parashikimet tregojnë se në të ardhmen Kosova do të jetë e ndikuar nga ndryshimet klimatike. Proceset klimatike dhe hidrologjike duhet të jenë në mënyrë të vazhduar nën vëzhgim si dhe të analizuar dhe dokumentuara saktësisht. Në Kosovë, përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e të dhënave hidrologjike dhe meteorologjike është Insituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Bazuar në parashikimet e parametrave siç janë: temperaturat e larta, reshjet e reduktuara dhe rritja e popullsisë, në katër-pesë pellgjet ujëmbledhëse të Kosovës mund të ketë zvogëlim të theksuar të ujit deri në vitin 2050<sup>9</sup>.

Burimet e ujit të ripërtëritshëm për person në vendin tonë janë 16% nën mesataren e rajonit<sup>10</sup>, përveç kësaj, reshjet dhe kapacitetet e ruajtjes së ujit janë gjithashtu më pak se gjysma e mesatares së rajonit. Liqenet akumuluese-rezervarët janë një burim uji për qytetet e mëdha, por në zonat rurale vetëm 61% e shtëpive janë në tubacion të sistemit të furnizimit publik, të plotësuar me puse ose burime.

Monitorimi i vazhduar hidrologjik dhe meteorologjik siguron informacione vendimtare për planifikim, ndërtim dhe funksionimin e strukturave menaxhuese të burimeve ujore, për dizajnim të infrastrukturës së lumenjve, ose për marrjen e vendimeve që kanë ndikim pozitiv ekologjik. Monitorimet dhe vrojtimit klimatike, lejojnë identifikimin e ndryshimeve klimatike të theksuara dhe mundësojnë hartimin e planit të punës për menaxhimin e krizave nga ndryshimet klimatike dhe adaptimin ndaj tyre.

Disa stacione klimatike në Kosovë kanë traditë të gjatë. Në të kaluarën të dhënat klimatike nga Prishtina, Mitrovica, Peja, Ferizaji dhe Prizreni janë publikuar rregullisht në vjetarët meteorologjikë që nga viti 1949. Disa nga stacionet janë në operim të vazhdueshëm duke filluar nga fillimet e vitit 1920, dhe janë të regjistruar në rrjetin sinoptik të "Organizatës Botërore të Meteorologjisë".

Ndryshimet e temperaturës, ndikimet klimatike në burimet ujore do të ndikojnë drejtpërdrejtë në sektorin e bujqësisë. Rritja e sektorit është e kufizuar nga pamjaftueshmëria e ujitjes, ku sipërfaqja e ujitur të paktën një herë gjatë periudhës referuese ishte 32,237 ha. Kufizimet e tjera të sektorit përfshijnë fragmentimin e tokës, teknologjinë e vjetruar, si dhe tregun e kufizuar.

Meqenëse Kosova ende nuk është njohur nga organizata e Kombeve të Bashkuara, nuk është nënshkruese e konventave ndërkombëtare siç është Konventa për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Në vitin 2015, Kosova nënshkroi marrëveshjen e stabilizim asocimit me Bashkimin Evropian dhe është duke punuar në harmonizimin e legjislacionit me

---

<sup>8</sup> UNEP. 2015 Outlook on Climate Change Adaptation in the Western Balkan Mountains

<sup>9</sup> Climate change risk profile Kosovo-Sector impacts and vulnerabilities

<sup>10</sup> Climate change risk profile Kosovo-Sector impacts and vulnerabilities- water resources

legjislacionin e BE-së, si pjesë e procesit të përafrimit të BE-së, duke përfshirë reduktimin e fatkeqësive dhe rrezikut mjedisor.

Sa i përket ndryshimeve klimatike politikat e BE-së janë në linjë me kërkesat e Konventës Kornizë për Ndryshimin Klimatik (UNFCCC), prandaj duke adaptuar dhe harmonizuar legjislacionin e BE-së, Kosova në mënyrë indirekte plotëson edhe kërkesat që dalin nga kjo Konventë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është autoriteti përgjegjës për mjedisin dhe politikën e klimës. Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) është institucion qeveritar i cili angazhohet që përmes monitorimit të integruar të mjedisit, sistemit efikas të informimit mjedisor dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit, të ruajë kualitetin e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.


Territori i Republikës së Kosovës karakterizohet me lartësi të ndryshme mbidetare. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e lumit Drini i Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin lartësinë 270 m mbi nivelin e detit, e ajo më e lartë ndodhet në perëndim të Kosovës, në Gjeravicë - 2,656 m. Në aspektin hidrografik, Kosova ndahet në pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Rrjedhat lumore të Kosovës derdhën në tre ujëmbledhës detarë: Deti i Zi, Deti Adriatik dhe Deti Egje. Klima e Republikës së Kosovës në pjesën më të madhe është kontinentale, duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë, me ndikime mesdhetare dhe kontinentale (temperatura mesatare brenda vendit luhartet nga +30°C në verë, në -10°C në dimër). Megjithatë, për shkak të konfiguracionit dhe reliefit të ndryshëm në disa pjesë të vendit, ka ndryshime në temperaturë dhe shpërndarjen e reshjeve.

Në vendin tonë paraqiten të gjitha format e reshjeve atmosferike. Rëndësinë më të madhe e kanë reshjet në formë të shiut nëpër luginat dhe reshjet e borës në viset e larta malore (Bjeshkët e Nemuna dhe Sharr), ku në pjesën lindore të Kosovës, mesatarisht gjatë vitit bien mbi 600 mm ndërsa në pjesën perëndimore mbi 700 mm.

Reshjet e borës janë dukuri e rëndomtë në pjesën e ftohtë të vitit. Në pjesët e ulëta të Kosovës mesatarisht paraqiten 26 ditë me reshje bore, kurse në viset malore mbi 100 ditë. Stacioni i parë për matjen e të reshurave në territorin e Kosovës ka filluar me vërtetime në vitin 1925. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës bënë regjistrimin e reshjeve përmes stacioneve vrojtuese të vendosura në disa lokalitete të Kosovës.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat për temperaturat mesatare të ajrit, të reshurat (mm), dhe numri mesatar i ditëve me shi në Prishtinë, sipas viteve 2002-2016.

**Figura 45: Temperaturat mesatare vjetore në Prishtinë, 2002-2016**




Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Temperaturat mesatare vjetore më të larta në Prishtinë janë shënuar në vitin 2012 (11.9 gradë Celsius), pastaj radhiten vitet 2010 dhe 2013, ku kjo temperaturë mesatare vjetore arriti vlerën 11.7 gradë Celsius dhe vitet 2007 dhe 2014 me 11.6 gradë Celsius.

Ndërsa temperatura mesatare vjetore më të ulëta paraqiten në vitin 2005, kur temperatura mesatare vjetore arriti vlerën prej 10.4 gradë Celsius, pasuar nga viti 2006 me temperaturë mesatare vjetore prej 10.8 gradë Celsius dhe viti 2011 që poashtu kishte vlerë të ulët të temperaturës mesatare vjetore prej 11.0 gradë Celsius.


**Figura 46: Të reshurat në Prishtinë (mm), 2002-2016**



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Si vit me më shumë të reshura sipas viteve u karakterizua viti 2014 me 74.4 mm të reshura. Si vit me sasi të përafërt të të reshurave me vitin 2014 paraqiten viti 2016 me sasi prej 73.3 mm dhe viti 2002 që kishte 70.8 mm shi. Ndërsa si vite me më pak të reshura paraqiten: viti 2011 që kishte vetëm 33.9 mm të reshura, viti 2012 me 45.1 mm. Ngjajshëm me këtë vit ishte edhe viti 2003 me 45.9 mm dhe viti 2015 që kishte të reshura 46.5 mm.

**Figura 47: Numri mesatar i ditëve me shi dhe borë në Prishtinë<sup>11</sup>, 2002-2016**



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Si vit me numrin mesatar të ditëve me më shumë shi dhe borë ishte viti 2004, ku janë të regjistruara 172 ditë me shi dhe borë. Sasi të përafërt të numrit mesatar të ditëve me shi dhe borë kishte në vitin 2010 me 165 ditë të reshura. Sa i përket viteve që kanë pasur numër më vogël mesatar të ditëve me shi dhe borë, është viti 2011 me vetëm 96 ditë me të reshura dhe viti 2008 me numër mesatar të ditëve 106.

<sup>11</sup> Të dhënat e paraqitura për vitin 2015 për numrin e ditëve me shi dhe borëi përkasin periudhës Qershor-Dhjetor

## **5 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural**

### **5.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve**

Mbështetja e sektorit të bujqësisë ka vazhduar edhe në vitin 2016, ky sektor është mbështetur përmes pagesave direkte dhe masave të zhvillimit rural. Mbështetja përmes pagesave direkte është bërë për kultura bujqësore, krerë blegtoral si dhe për inpute ndërsa përmes granteve janë mbështetur investimet në sektorin primar por edhe në industrinë përpunuese dhe zhvillim të turizmit në zona rurale.

Në programin e pagesave direkte në vitin 2016 mbështetja e planifikuar ka qenë 23 mil. € dhe janë mbështetur:

1. Gruri - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me grurë në pronësi ishte 2 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 150 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së grurit ka qenë 6.5 mil €.
2. Farë gruri - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me grurë për prodhimin e farës ishte 5 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 250 €/ha. Fara e varietetit të grurit duhej të ishte në Listën e Farërave të Lejuara. Njësoj sikurse në vitin paraprak, buxheti i planifikuar për subvencionimin e farës së grurit ka qenë 0.1 mil €.
3. Elbi - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me elb në pronësi ishte 1 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 100 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së elbit ka qenë 0.3 mil €.
4. Thekra - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me thekër në pronësi ishte 1 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 100 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së thekrës ka qenë 0.1 mil €.
5. Misri - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me misër në pronësi ishte 1 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 150 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së misrit ka qenë 2.7 mil €.
6. Luledielli - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me luledielli në pronësi ishte 1 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 150 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së lulediellit ka qenë 0.05 mi. €.
7. Perime në fushë të hapur - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me perime në fushë të hapur në pronësi ishte 0.50 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 300 €/ha. Kulturat perimore të kultivuara në fushë të hapur duhej ti përkisnin listës së kulturave që mbështeten përmes programit të pagesave direkte. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së perimeve në fushë të hapur ka qenë 1.5 mil. €.
8. Vreshtat ekzistuese - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me vreshta në pronësi ishte 0.10 ha/fermer, për sipërfaqe të kultivuar prej 0.10 ha deri në 100 ha

mbështetja për fermer ishte 1,000 €/ha, ndërsa kur fermeri kishte më shumë se 100 ha të mbjellë me vreshta mbështetja ishte 400 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e vreshtave ekzistuese ka qenë 2.1 mil. €.

9. Pagesat direkte për pemishtet ekzistuese - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me pemë drufrutore në pronësi ishte 0.50 ha/fermer, ndërsa për pemë manore ishte 0.20 ha/fermer dhe fermeri përfitoi 400 €/ha. Kulturat pemëtare duhej ti përkisnin listës së kulturave që mbështeten përmes programit të pagesave direkte dhe ta plotësonin kriterin e numrit minimal të bimëve-pemëve të mbjellura në 1 ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së pemishteve ekzistuese ka qenë 1 mil. €.
10. Fidanë të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegetative - Sipërfaqja minimale që fermeri duhet të kishte në pronësi ose të marr me qira ishte 0.50 ha/fermer. Përfitues ishin fermerët që kishin mbjellë së paku 5,000 fidanë gjatë vitit 2016 dhe pagesa dalloj varësisht nga numri i fidanëve të mbjella. Fermerët që prodhuan 5,000-40,000 fidan të pemëve drufrutore u mbështetën me nga 0.20 €/fidan, mbi 40,000 fidanë të pemëve drufrutore u mbështetën me nga 0.15 €/fidan dhe fermerët që prodhuan së paku 5,000 fidanë të hardhisë së rrushit u mbështetën me nga 0.10 €/fidan. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e mbjelljes së materialit fidanor ka qenë 0.1 mil. €.
11. Bujqësi organike - Sipërfaqja minimale e pranueshme e mbjellë me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik ishte 0.10 ha/fermer dhe fermeri që posedoi dëshminë se është i certifikuar për prodhim organik përfitoi 200 €/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e prodhimit organik ka qenë 0.1 mil. €.
12. Lopë dhe buallica qumështore - Fermeri është dashur të mbarështojë së paku 5 krerë lopë, buallica qumështore apo të dyja së bashku dhe fermeri përfitoi 70 €/krerë. Buxheti i planifikuar për subvencionim të lopëve dhe buallicave qumështore ka qenë 3.6 mil. €.
13. Dele - Fermeri është dashur të mbarështojë së paku 30 krerë dele në prodhimtari aktive të qumështit dhe përfitoi 15 €/krerë. Buxheti i planifikuar për subvencionim të deleve ka qenë 1.7 mil. €.
14. Dhi - Fermeri është dashur të mbarështojë së paku 20 krerë dhi në prodhimtari aktive të qumështit dhe përfitoi 15 €/krerë. Buxheti i planifikuar për subvencionim të dhive ka qenë 0.15 mil. €.
15. Bletari - Fermeri është dashur të mbarështojë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere). Fermerët që kanë pasur 30-50 koshere, ato kanë mundur ti kenë të vendosura në maksimum 3 bletishte, ata që kishin 50-200 koshere në maksimum në 5 bletishte dhe fermerët që kishin më shumë se 200 koshere ato mund ti kishin të vendosura maksimum në 7 bletishte. Subvencionimi për koshere ishte 15 €, ndërsa në rast se fermerët ishin të certifikuar për prodhimtari organike të mjaltit, pagesa ishte 20

€/koshere. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e sektorit të bletarisë ishte 1.5 mil. €.

16. Qumësht sipas kategorive të cilësisë – Fermeri është dashur të dorëzoj së paku 1,500 litra qumësht në qumështore të licencuar brenda periudhës tremujore (sipas tremujorëve të vitit kalendarik). Mbështetja dalloj varësisht nga kategoria e cilësisë së qumështit prandaj fermeri përfitoi 0.06 €/litër për qumështin e klasës ekstra, 0.04 €/litër për qumështin e klasës së I-rë dhe 0.02 €/litër për qumështin e klasës së II-të. Buxheti i planifikuar për subvencionim të qumështit ishte 1 mil. €.
17. Pula vojse - Fermeri është dashur të mbarështojë së paku 2,000 pula vojse në të gjitha fazat e prodhimit aktive të vezëve. Fermeri përfitoi 0.50 €/pulë vojse kur kishte 2,000 deri në 10,000 pula vojse dhe 0.40 €/pulë vojse kur kishte mbi 10,000 pula. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e pulave vojse ishte 0.21 mil. €.
18. Thëllëza - Fermeri është dashur të mbarështojë së paku 100 thëllëza vojse në të gjitha fazat e prodhimit aktive të vezëve dhe fermeri përfitoi 1 €/thëllëzë vojse. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e thëllëzave vojse ishte 0.02 mil. €.
19. Dosa në riprodhim (derrari) - Fermeri është dashur të mbarështoj së paku 2 dosa për riprodhim aktiv në të gjitha fazat e riprodhimit dhe fermeri përfitoi 20 €/krerë. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e dosave në riprodhim ishte 0.02 mil. €.
20. Therjet e raportuara të gjedhit - Fermerët që mbarështojnë gjedhe të identifikuar me matrikul të Republikës të Kosovës dhe që i therin ato në thertore të licencuara nga AUV për kategoritë e cilësisë A, B dhe C ishin përfitues së bashku me thertoret e licencuara në kategoritë e cekura më lartë. Subvencionimi ishte 30 €/therje për thertore e cila ishte e obliguar që 20 € t'ia paguante fermerit në momentin e therjes dhe 10 € ti mbante për vete për shërbimin e therjes. Buxheti i planifikuar për therjet e raportuara të gjedhit ishte 0.15 mil. €.
21. Akuakulturë - Fermeri është dashur të shesë së paku 2,500 kg peshk brenda 6 muajve në Republikën e Kosovës. Llojet e lejueshme ishin Trofta dhe Krapa dhe fermeri përfitoi 0.20 €/kg. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e akuakulturës ishte 0.1 mil. €

Në vitin 2016 totali i mbështetjes përmes pagesave direkte ishte 26.1 mil. €. Krahasuar me vitin paraprak mbështetja përmes pagesave direkte është rritur për 22%.




**Tabela 85: Pagesat direkte 2012-2016**

	2012	2013	2014	2015	2016
Grurë	3,795,094	5,824,268	5,555,218	6,417,047	7,526,999
Farë gruri	25,020	63,720	107,391	86,063	196,678
Misër	575,459	943,028	1,268,719	2,735,462	2,870,969
Elb	-	-	-	-	25,118
Thekër	-	-	-	-	19,977
Luledielli	73,711	41,439	44,853	20,322	1,316
Vreshta	-	1,124,516	2,290,783	2,046,167	2,117,978
Perime në fushë të hapur	-	-	1,026,735	1,564,692	1,981,617
Pemishte ekzistuese	-	-	-	692,256	1,112,032
Bujqësi organike	-	-	-	-	14,626
Lopë qumështore	2,104,800	2,105,950	2,211,750	3,790,990	4,609,990
Dele dhe dhi	1,327,450	1,159,720	1,210,120	1,921,365	1,933,245
Bletë	358,610	500,660	777,610	1,129,580	2,158,770
Pula vojse	-	240,305	231,648	210,868	346,259
Thëllëza	-	-	-	-	22,083
Dosa	-	-	6,220	11,240	14,040
Qumësht	-	-	491,884	711,644	1,082,829
Therje të raportuara të gjedhit	-	-	-	2,520	15,780
Fidane	-	96,264	75,791	98,522	76,933
<b>Gjithsej</b>	<b>8,260,144</b>	<b>12,099,869</b>	<b>15,298,721</b>	<b>21,438,737</b>	<b>26,127,237</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)


Në periudhën 2012-2016, subvencionet kanë shënuar rritje të vazhdueshme, e kjo si rezultat i mbështetjes së sektorëve të rinj por edhe rritjes në sektorët e mbështetur më parë. Në vitin 2016, përveç pagesave direkte për luledielli dhe atyre për fidanë që shënuan rënie, të gjitha kategoritë e tjera shënuan ngritje në krahasim me vitin 2015. Rritje më të lartë kanë shënuar subvencionet për farë gruri, therje të raportuara të gjedhit dhe bletë. Për dallim nga viti 2015, në vitin 2016 filloi mbështetja për fermerët që merreshin me kultivimin e elbit, thekrës, thëllëzave vojse, prodhimtarisë organike dhe akuakulturë. Në vitin 2016 subvencionet arritën vlerën 26.1 mil. €, prej të cilave rreth 60% kanë qenë për grurë, lopë qumështore dhe misër.

**Figura 48: Pagesat direkte 2012-2016, në 1000 €**

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Në periudhën 2012-2016, shuma totale e pagesave direkte ishte 83.2 mil. €, ku prin gruri, lopët qumështore, misri, vreshtat dhe delet e dhitë. Këta sektorë janë mbështetur që nga fillimi andaj edhe shuma totale është më e madhe për dallim nga sektorët e tjerë të listuar në tabelën e mëposhtme e që kanë filluar të mbështetën më vonë.

**Figura 49: Pagesat direkte sipas sektorëve 2012-2016, në mil. €**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Buxheti i planifikuar për implementimin e programit të zhvillimit rural për vitin 2016 ka qenë 23 mil. €. Pjesë e programit të zhvillimit rural në vitin 2016 kanë qenë këto masa:

- Masa 101: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore (14.5 mil. €);
- Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore (5 mil. €);
- Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve (1.5 mil €);
- Masa 303: Përgaditja dhe zbatimi i strategjive për zhvillim lokal - LIDER (0.2 mil. €);
- Masa 501: Asistenca teknike (0.3 mil. €);
- Masa: Ujitjen e tokave bujqësore (1 mil. €);
- Masa: Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore (0.5 mil. €)

## **5.2 Pagesat direkte/subvencionet**

Në vitin 2016 MBPZHR vazhdoi subvencionimin e fermerëve përmes pagesa direkte për kultura bujqësore, krerë blegtoral si dhe për inpute. Përveç kulturave të subvencionuara edhe më herët, këtë vit filloi edhe subvencionimi i elbit, thekrës si dhe prodhimtaria organike, ndërsa në sektorin e blegtorisë përveç sektorëve që edhe më herët ishin pjesë e programit mbështetës, në kuadër të sektorit të shpezëtarisë filluan të subvencionohen thëllëzat.

### **5.2.1 Pagesat direkte për kulturat bujqësore**

Në vitin 2016, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore ishte 15.9 mil. € apo 17% më e madhe sesa në vitin 2015. Pjesëmarrje më të madhe në totalin e pagesa direkte për kultura bujqësor kishin gruri, misri, vreshtat dhe perimet në fushë të hapur ndërsa kulturat që u mbështetën për herë të parë në vitin 2016 marrin pjesë me më pak se 1% në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore. Numri total i aplikuesve për pagesa direkte për kultura bujqësore ishte 31,303, prej të cilëve 30,452 përfituan duke rezultuar me përqindje të refuzimit prej rreth 3%. Në këtë vit numër më të vogël të aplikuesve kishte vetëm për misër dhe luledielli ndërsa për kulturat e tjera numri i aplikuesve është rritur. Numri i përfituesve është zvogëluar vetëm në rastin e lulediellit. Pagesat direkte për hektar kanë mbetur të njëjta përveç tek vreshtat ku fermerët që kishin mbi 100 ha, në vitin 2015 kanë përfituar 300 €/ha ndërsa në vitin 2016 ata përfituan 400 €/ha. Në vitin 2016, pjesëmarrja e pagesave direkte për kultura bujqësore në totalin e pagesave direkte është 61%.

**Tabela 86: PAGESAT DIREKTE SIPAS SEKTORËVE, 2012-2016**

		2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 në %
Grurë	Numri i aplikuesve	9,604	11,758	11,871	11,032	11,864	8
	Numri i përfituesve	8,841	10,686	10,579	10,298	11,602	13
	Numri i ha të paguar	37,951	46,594	44,442	42,780	50,180	17
	Pagesa për ha	100	125	125	150	150	0
	Shuma totale e paguar	3,795,094	5,824,268	5,555,218	6,417,047	7,526,999	17
Farë gruri	Numri i aplikuesve	10	27	16	17	25	47
	Numri i përfituesve	10	27	16	11	25	127
	Numri i ha të paguar	250	850	511	344	803	133
	Shuma totale e paguar	25,020	63,720	107,391	86,063	196,678	129
Misër	Numri i aplikuesve	2,346	3,858	6,134	8,278	7,985	-4
	Numri i përfituesve	2,209	3,626	5,413	7,574	7,763	2
	Numri i ha të paguar	5,755	9,430	12,687	18,236	19,140	5
	Pagesa për ha	100	100	100	150	150	0
	Shuma totale e paguar	575,459	943,028	1,268,719	2,735,462	2,870,969	5
Elb	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	151	
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	133	
	Numri i ha të paguar	-	-	-	-	251	
	Pagesa për ha	-	-	-	-	100	
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	25,118	
Thekër	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	77	
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	61	
	Numri i ha të paguar	-	-	-	-	200	
	Pagesa për ha	-	-	-	-	100	
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	19,977	
Vreshta	Numri i aplikuesve	-	2,579	2,995	2,914	2,980	2
	Numri i përfituesve	-	2,556	2,995	2,806	2,881	3
	Numri i ha të paguar	-	2,791	2,435	2,456	2,473	1
	Pagesa për ha	-	500/200	1000/300	1000/300	1000/400	
	Shuma totale e paguar	-	1,124,516	2,290,783	2,046,167	2,117,978	4
Luledielli	Numri i aplikuesve	32	31	15	7	2	-71
	Numri i përfituesve	29	29	13	4	2	-50
	Numri i ha të paguar	737	414	449	135	9	-94
	Pagesa për ha	100	100	100	150	150	0
	Shuma totale e paguar	73,711	41,439	44,853	20,322	1,316	-94
Perime në fushë të hapur	Numri i aplikuesve	-	-	1,870	4,717	5,304	12
	Numri i përfituesve	-	-	1,548	4,268	5,188	22
	Numri i ha të paguar	-	-	3,422	5,216	6,605	27
	Pagesa për ha	-	-	300	300	300	0
	Shuma totale e paguar	-	-	1,026,735	1,564,692	1,981,617	27
Pemishte ekzistuese	Numri i aplikuesve	-	-	-	1,796	2,908	62
	Numri i përfituesve	-	-	-	1,578	2,794	77
	Numri i ha të paguar	-	-	-	1,731	2,780	61
	Pagesa për ha	-	-	-	400	400	0
	Shuma totale e paguar	-	-	-	692,256	1,112,032	61
Bujqësi organike	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	7	
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	3	
	Numri i ha të paguar	-	-	-	-	73	
	Pagesa për ha	-	-	-	-	200	
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	14,626	


Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Gruri

Në vitin 2016 shuma e pagesave direkte për grurë ka qenë 7.5 mil. € apo 17% më e lartë në krahasim me vitin paraprak. Kjo rritje është si rezultat se numri i hektarëve të subvencionuar është rritur për 7,400 ha. Numri i fermerëve që kanë aplikuar është rritur për 8% ndërsa i atyre që kanë përfituar për 13% e që rezulton më përqindje më të ulët të refuzimit. Numri i fermerëve të refuzuar ishte 262 apo 2.2% i aplikuesve, e që në vitin 2015 kjo përqindje ishte 6.7%. Mesatarja e hektarëve për të cilët një fermer ka përfituar ishte 4.3 ha.

Regjioni i Prishtinës (32%) prin me sipërfaqe të grurit të subvencionuar, pasuar nga Mitrovica (18%), Peja (15%), Gjakova (12%) dhe regjionet e tjera me 23%.

**Figura 50: Pagesa direkte për grurë 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar për grurë sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Totali i numrit të fermerëve që kanë aplikuar për pagesa direkte për grurë ishte 11,864, nga të cilët 97.8% kanë përfituar. Përqindja më e lartë e refuzimit ka qenë në Regjionin e Prizrenit me 4.5%, ndërsa më e ulëta në regjionin e Mitrovicës me vetëm 0.8%. Sipërfaqja mesatare më e lartë për të cilën ka përfituar një fermer ishte në regjionin e Ferizajit (5 ha) ndërsa më e ulëta në regjionin e Prizrenit (3.9 ha)

**Tabela 87: Pagesat direkte për grurë sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	3,797	3,702	16,116	2,417,451
2	Prizren	464	443	1,740	260,937
3	Pejë	1,616	1,576	7,379	1,106,786
4	Mitrovicë	2,222	2,204	9,128	1,369,238
5	Gjakovë	1,483	1,446	6,192	928,754
6	Ferizaj	964	948	4,726	708,842
7	Gjilan	1,318	1,283	4,900	734,993
	<b>Gjithsej</b>	<b>11,864</b>	<b>11,602</b>	<b>50,180</b>	<b>7,526,999</b>


Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Farë gruri

Në vitin 2016, shuma totale e pagesave direkte për farë gruri ishte 197 mijë €, kjo shumë është rritur më shumë se dyfishi i vitit 2015. Shuma e pagesës ka qenë 250 €/ha dhe kanë përfituar të gjithë ata fermerë të cilët pas dy kontrolleve nga inspektorët fitosanitar janë cilësuar se i kanë plotësuar kriteret e vendosura në thirrjen për aplikim. Nuk ka pasur fermerë që janë refuzuar, të gjithë ata që kanë aplikuar edhe kanë përfituar.

Sa i përket shpërndarjes në regjione, 69% e sipërfaqes së subvencionuar është në regjionin e Pejës, 16% në atë të Gjakovës dhe pjesa tjetër në Prishtinë, Ferizaj dhe Mitrovicë. Nuk ka pasur aplikues në regjionin e Prizrenit dhe Gjilanit

**Figura 51: Pagesat direkte për farë gruri 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar për farë gruri sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Gjithsej janë subvencionuar 803 ha më farë gruri, sipërfaqja mesatare për të cilën një fermerë ka përfituar subvencione për farë gruri ishte 32 ha, sipërfaqja më e lartë ishte në Regjionin e Pejës me 34.8 ha të subvencionuar ndërsa sipërfaqe mesatare më e vogël për një përfitues ishte në regjionin e Mitrovicës me vetëm 6.5 ha. Në regjionin e Ferizajit, përkatësisht në Shtime 1 fermer kishte përfituar për 42.5 ha.

**Tabela 88: Pagesa direkte për farë gruri sipas regjionit, në vitin 2016**


Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	2	2	67	16,798
2	Prizren	-	-	-	-
3	Pejë	16	16	556	137,338
4	Mitrovicë	2	2	13	3,146
5	Gjakovë	4	4	124	30,025
6	Ferizaj	1	1	42	9,372
7	Gjilan	-	-	-	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>25</b>	<b>803</b>	<b>196,678</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Misri

Sipërfaqja e subvencionuar me misër në vitin 2016 është rritur për 5% e kjo ka rezultuar me rritje të njëjtë të shumës totale të subvencioneve për misër e që arriti në 2.9 mil. €. Shuma e pagesës vazhdoi të jetë 150 €/ha sikurse edhe në vitin 2015. Numri i fermerëve aplikues ka rënë për 4% ndërsa i atyre përfitues është rritur për 2%. Përqindja e fermerëve të refuzuar është 2.8% apo 5.7 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2015. Sipërfaqja mesatare për të cilën një fermerë ka përfituar ishte 2.5 ha.

**Figura 52: Pagesat direkte për misër 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me misër sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Numri i hektarëve të mbjellë me misër e që janë subvencionuar në vitin 2016 ishte 19,140 ha, me mesatare prej 2.5 ha/fermer, e kjo ka variuar nga 2 ha në regjionin e Prizrenit deri në 2.8 në regjionin e Pejës. Nga totali i fermerëve aplikues 97.2% kanë përfituar dhe kjo përqindje ka qenë pothuajse e njëjtë në të gjitha regjionet me dallim shumë të vogël, 1.5 pikë përqindje në regjionin e Prizrenit që përqindja e fermerëve përfitues ka qenë 98.7%.

**Tabela 89: Pagesa direkte për misër sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	1,835	1,782	4,184	627,531
2	Prizren	236	233	473	70,884
3	Pejë	1,842	1,777	4,986	747,860
4	Mitrovicë	1,278	1,255	2,908	436,259
5	Gjakovë	1,330	1,294	3,093	463,976
6	Ferizaj	728	710	1,947	292,070
7	Gjilan	736	712	1,549	232,391
	<b>Gjithsej</b>	<b>7,985</b>	<b>7,763</b>	<b>19,140</b>	<b>2,870,969</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Elbi

Elbi ka filluar të subvencionohet për herë të parë në vitin 2016 me nga 100 €/ha. Kanë aplikuar gjithsej 151 fermerë nga të cilët 133 kanë përfituar. Shuma totale e pagesave direkte për elb ishte 25 mijë €. Përqindja e fermerëve të refuzuar ishte 11.9%, dhe kjo ka ndryshuar nga regjioni në regjion, ku më së shumti fermerë janë refuzuar në regjionin e Prizrenit (59% e aplikuesve), ndërsa më së paku në atë të Pejës. Sipërfaqe mesatare për të cilën një fermerë ka përfituar ishte 1.9 ha, e që më e larta ishte në Mitrovicë dhe Ferizaj me nga 2 ha secila dhe më e ulëta në Prizren me 1.2 ha/fermerë.


**Tabela 90: Pagesa direkte për elb sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	47	44	85	8,463
2	Prizren	17	7	9	866
3	Pejë	42	40	75	7,459
4	Mitrovicë	28	26	52	5,226
5	Gjakovë	5	5	8	766
6	Ferizaj	9	8	16	1,598
7	Gjilan	3	3	7	740
	<b>Gjithsej</b>	<b>151</b>	<b>133</b>	<b>251</b>	<b>25,118</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Nga 251 ha të kultivuar me elb dhe për të cilët fermerët përfituan subvencione, 34% e tyre janë në regjionin e Prishtinës, 30% në regjionin e Pejës, 21% në regjionin e Mitrovicës dhe 15% në katër regjionet e tjera. Duke qenë se subvencionimi i elbit ka filluar për herë të parë këtë vit, kontrolli në teren është realizuar në masën 100%. Shuma e paguar në total ka qenë e ulët në raport me buxhetin e planifikuar për pagesa direkte për elb duke qenë se ka pasur më pak aplikues e në disa komuna nuk ka pasur fare të interesuar për kultivim të elbit.

**Figura 53: Sipërfaqja e subvencionuar me elb sipas regjionit, në vitin 2016**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)



## Thekra

Në vitin 2016, shuma totale e pagesave direkte për thekër ishte rreth 20 mijë €. Kjo kulturë filloi të subvencionohet për herë të parë në këtë vit dhe kontrolli në teren është kryer në masën 100%. Secili fermerë aplikues që i ka përmbushur kriteret e paraqitura në thirrjen për aplikim është subvencionuar me nga 100 €/ha. Në total kanë aplikuar 77 fermerë nga 19 komuna të Kosovës ndërsa kanë përfituar 61 prej tyre. Duke qenë se është viti i parë i subvencionimit, përqindja e fermerëve të refuzuar ka qenë e lartë përkatësisht 20.8%, e kjo përqindje më e larta ka qenë në regjionin e Prizrenit (56%) ndërsa më e ulëta në regjionin e Pejës (7%). Mesatarja për fermerë përfitues është 3.3 ha, mesatarja më e lartë ka qenë në regjionin e Pejës (4.7 ha) dhe më e ulëta në regjionin e Prizrenit (1.4 ha).


**Tabela 91: Pagesa direkte për thekër sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	11	8	27	2,728
2	Prizren	16	7	10	982
3	Pejë	29	27	126	12,580
4	Mitrovicë	-	-	-	-
5	Gjakovë	6	6	16	1,637
6	Ferizaj	11	10	16	1,579
7	Gjilan	4	3	5	471
	<b>Gjithsej</b>	<b>77</b>	<b>61</b>	<b>200</b>	<b>19,977</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Nga 200 ha sa janë subvencionuar në total, 126 ha kanë qenë në regjionin e Pejës, pasuar nga Prishtina, Gjakova, Ferizaji, Prizreni dhe Gjilani, ndërsa nuk ka pasur fare aplikues nga regjioni i Mitrovicës.

**Figura 54: Sipërfaqja e subvencionuar me thekër sipas regjionit, në vitin 2016**




Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Vreshta

Në vitin 2016 shuma totale e pagesave direkte për vreshta u rrit për 4%, kjo si rezultat i asaj se numri i ha të subvencionuar është rritur për 1% por edhe shuma e subvencionimit për hektar për fermerët që kanë mbi 100 ha është rritur nga 300 €/ha sa ishte në vitin 2015 në 400 €/ha. Numri i aplikuesve është rritur për 2% ndërsa numri i përfituesve për 3%. Përqindja e fermerëve të refuzuar ishte 3.3%, e që ishte për 0.4 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin paraprak. Gjithsej u subvencionuan 2,473 ha, në shumë totale prej 2.1 mil €.

Nga gjithsej sipërfaqja e subvencionuar me vreshta 99.5% është në regjionin e Gjakovës dhe të Prizrenit ndërsa vetëm 0.5% në regjionet e tjera.

**Figura 55: Pagesat direkte për vreshta 2013-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me vreshta sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Përqindja e fermerëve të refuzuar ishte 3.3% në total, ndërsa përqindje më e madhe ka qenë në regjionin e Prishtinës dhe Ferizajit por që nuk ndikon në situatën e përgjithshme sepse në këto dy regjione ka pasur numër të vogël të aplikuesve dhe përfituesve. Sipërfaqja mesatare për të cilën një fermer ka përfituar ishte 0.9 ha, ndërsa më e larta ishte në regjionin e Gjakovës më 1.1 ha, e kjo si rezultat i asaj që në këtë regjion është edhe e koncentruar prodhimtaria e rrushit.

**Tabela 92: Pagesa direkte për vreshta sipas regjionit, në vitin 2016**


Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	12	9	3	3,160
2	Prizren	882	842	310	309,740
3	Pejë	9	8	8	7,760
4	Mitrovicë	1	1	0	330
5	Gjakovë	2,074	2,020	2,151	1,796,738
6	Ferizaj	2	1	0	250
7	Gjilan	-	-	-	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>2,980</b>	<b>2,881</b>	<b>2,473</b>	<b>2,117,978</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Luledielli

Sipërfaqja e kultivuar me luledielli nga viti në vit po zvogëlohet, andaj edhe shuma e pagesave direkte është zvogëluar nga viti në vit. Në vitin 2016 janë subvencionuar vetëm rreth 9 ha në shumë prej 1,316 €. Në krahasim me vitin paraprak numri i hektarëve të subvencionuar është zvogëluar për 94%. Ka qenë vetëm 1 aplikues nga regjioni i Ferizajit që ka përfituar për 7 ha dhe 1 nga regjioni i Prishtinës që ka përfituar për 2 ha.

**Figura 56: Pagesat direkte për luledielli 2012-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me luledielli sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

**Tabela 93: Pagesat direkte për luledielli sipas regjionit, në vitin 2016**


Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	1	1	2	266
2	Prizren	-	-	-	-
3	Pejë	-	-	-	-
4	Mitrovicë	-	-	-	-
5	Gjakovë	-	-	-	-
6	Ferizaj	1	1	7	1,050
7	Gjilan	-	-	-	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>1,316</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Perime në fushë të hapur

Nga viti 2014, kur perimet filluan të subvencionohen për herë të parë, aplikuesit si dhe numri i hektarëve të mbështetur u rrit në vazhdimësi. Në vitin 2016 shuma totale e pagesave direkte për perime në fushë të hapur ishte rreth 2 mil. €, apo 27% më e madhe sesa në vitin 2015. Numri i aplikuesve u rrit për 12% ndërsa ai i përfituesve për 22% duke rezultuar me rënie në përqindjen e fermerëve të refuzuar për 7.3 pikë përqindje (nga 9.5% sa ishte në vitin 2015 në 2.2% në vitin 2016). Sa i përket shpërndarjes regjionale pjesa më e madhe e sipërfaqes së subvencionuar ishte në regjionin e Gjakovës, Mitrovicës, Pejës dhe Prishtinës ndërsa të tri regjionet tjera kishin pjesëmarrja 14% së bashku.

**Figura 57: Pagesa direkte për perime në fushë të hapur 2014-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me perime në fushë të hapur sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Numri i fermerëve të refuzuar ishte më i larti në regjionin e Gjakovës ndërsa më i ulëti në regjionin e Ferizajit, ndërsa përqindja më e lartë e fermerëve të refuzuar ishte në regjionin e Prishtinës (3.7%) ndërsa më e ulëta në regjionin e Mitrovicës (1.2%). Sipërfaqja mesatare për të cilën një fermer përfitoi subvencione për perime në fushë ta hapur ishte 1.3 ha.

**Tabela 94: Pagesat direkte për perime në fushë të hapur sipas regjionit, në vitin 2016**


Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	832	801	1,014	304,182
2	Prizren	384	374	312	93,582
3	Pejë	536	522	954	286,173
4	Mitrovicë	573	566	1,426	427,680
5	Gjakovë	2,530	2,483	2,301	690,330
6	Ferizaj	146	143	183	55,023
7	Gjilan	303	299	415	124,647
	<b>Gjithsej</b>	<b>5,304</b>	<b>5,188</b>	<b>6,605</b>	<b>1,981,617</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Pemishtet ekzistuese

Në vitin e dytë të subvencionimit pagesat direkte për pemishte ekzistuese janë rritur për 61%, duke arritur në 1.1 mil. €. Përqindja e fermerëve të refuzuar ka rënë dukshëm në krahasim me vitin 2015 në vetëm 4% të fermerëve aplikues. Pagesa për hektarë ka mbetur e njëjtë në shumë 400 €/ha sikurse edhe në vitin paraprak. Sipërfaqja mesatare për të cilën një fermer ka përfituar ishte 1 ha, e kjo ka ndryshuar varësisht regjionit nga 0.8 deri në 1.3 ha. Sa i përket shpërndarjes regjionale, më së shumti hektarë janë subvencionuar në regjionin e Prishtinës, pasuar nga Peja, Mitrovica, Gjilani, Ferizaji, Gjakova dhe Prizreni.

**Figura 58: Pagesa direkte për pemishte ekzistuese 2015-2016, në 1000 € (majtas); Sipërfaqja e subvencionuar me pemishte ekzistuese sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Sipërfaqja mesatare për të cilën një fermer ka përfituar ishte më e larta në regjionin e Gjilani (1.3 ha), ndërsa më e ulëta në regjionin e Ferizajit (0.8 ha). Sa i përket përqindjes të fermerëve të refuzuar, më e larta është në regjionin e Prizrenit (7.3%) ndërsa më e ulëta në regjionin e Mitrovicës (1.5%). Numri i hektarëve të subvencionuar në vitin 2016 ishte 2,780 ha apo 1,049 ha më shumë sesa në vitin 2015.

**Tabela 95: Pagesat direkte për pemishte ekzistuese sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	1,113	1,070	1,027	410,624
2	Prizren	179	166	149	59,632
3	Pejë	364	350	414	165,484
4	Mitrovicë	400	394	342	136,908
5	Gjakovë	187	177	220	88,176
6	Ferizaj	398	381	289	115,484
7	Gjilan	267	256	339	135,724
	<b>Gjithsej</b>	<b>2,908</b>	<b>2,794</b>	<b>2,780</b>	<b>1,112,032</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Bujqësi organike

Mbështetja e bujqësisë organike përmes pagesave direkte ka filluar për herë të parë në vitin 2016, në vlerë 200 €/ha. Kanë aplikuar 7 fermerë, prej të cilëve vetëm 3 kanë përfituar, 2 në regjionin e Pejës, përkatësisht në komunën e Istogut dhe 1 në regjionin e Gjakovës, përkatësisht në komunën e Rahovecit. Janë subvencionuar 73 ha në vlerë totale prej 14,626 €.


**Tabela 96: Pagesat direkte për bujqësi organike sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Sipërfaqja e subvencionuar (ha)	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	-	-	-	-
2	Prizren	-	-	-	-
3	Pejë	3	2	71	14,224
4	Mitrovicë	1	-	-	-
5	Gjakovë	3	1	2	402
6	Ferizaj	-	-	-	-
7	Gjilan	-	-	-	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>73</b>	<b>14,626</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Nga gjithsej 73 ha të subvencionuar, 97% janë në Regjionin e Pejës dhe pjesa tjetër në atë të Gjakovës. Ka pasur aplikues vetëm nga tri regjione, dhe pavarësisht asaj se kishte numër të vogël të aplikuesve, në përqindje mbi 50 % janë refuzuar.

**Figura 59: Sipërfaqja e subvencionuar me kultura organike sipas regjionit, në vitin 2016**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

### **5.2.2 Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht**

Në vitin 2016, shuma totale e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë ishte 10.2 mil. € apo 31% më e madhe sesa në vitin 2015. Pjesëmarrje më të madhe në totalin e pagesa direkte për blegtori kishin lopët qumështore, bletët, delet e dhitë, dhe qumështi sipas klasave të cilësisë ndërsa kategoritë e tjera marrin pjesë me më pak se 4% në totalin e pagesave direkte për blegtori. Numri total i aplikuesve për pagesa direkte për blegtori ishte 13,475, prej të cilëve 13,042 përfituan duke rezultuar me përqindje të refuzimit prej rreth 3%. Në këtë vit numër

më të vogël të aplikuesve kishte vetëm për dele dhe dhi ndërsa për kulturat e tjera numri i aplikuesve është rritur. Numri i përfituesve është zvogëluar vetëm në rastin e deleve dhe dhive. Pagesat direkte për krerë kanë mbetur të njëjta përveç tek bletët që në vitin 2015 pagesa ishte 10 €/koshere ndërsa në vitin 2016 u rrit në 15 €/koshere. Në vitin 2016, pjesëmarrja e pagesave direkte për blegtori në totalin e pagesave direkte është 39%.

**Tabela 97: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2012-2016**


		2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015 në %
Lopë qumështore	Numri i aplikuesve	5,584	5,803	6,052	6,827	7,981	17
	Numri i përfituesve	5,231	5,075	5,472	6,451	7,650	19
	Numri i krerëve të paguar	42,096	42,119	44,235	54,157	65,857	22
	Pagesa për krerë	50	50	50	70	70	0
	Shuma totale e paguar	2,104,800	2,105,950	2,211,750	3,790,990	4,609,990	22
Dele dhe dhi	Numri i aplikuesve	1,533	1,370	1,442	1,366	1,325	-3
	Numri i përfituesve	1,449	1,252	1,295	1,287	1,273	-1
	Numri i krerëve të paguar	132,745	115,972	121,012	128,091	128,883	1
	Pagesa për krerë	10	10	10	15	15	0
	Shuma totale e paguar	1,327,450	1,159,720	1,210,120	1,921,365	1,933,245	1
Dosa	Numri i aplikuesve	-	-	72	124	137	10
	Numri i përfituesve	-	-	65	106	121	14
	Numri i krerëve të paguar	-	-	311	562	702	25
	Pagesa për krerë	-	-	20	20	20	0
	Shuma totale e paguar	-	-	6,220	11,240	14,040	25
Bletë	Numri i aplikuesve	1,120	1,086	1,504	2,018	2,378	18
	Numri i përfituesve	779	985	1,394	1,918	2,353	23
	Numri i koshereve të paguara	35,861	50,066	77,761	112,958	143,918	27
	Pagesa për koshere	10	10	10	10	15	50
	Shuma totale e paguar	358,610	500,660	777,610	1,129,580	2,158,770	91
Pula vojse	Numri i aplikuesve	-	61	64	86	86	0
	Numri i përfituesve	-	58	59	57	78	37
	Numri i krerëve të paguar	-	567,996	526,966	466,064	783,531	68
	Pagesa për krerë	-	0.50/0.40 /0.30	0.50/0.40 /0.30	0.50/0.40	0.50/0.40	
	Shuma totale e paguar	-	240,305	231,648	210,868	346,259	64
Thëllëza	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	7	
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	6	
	Numri i krerëve të paguar	-	-	-	-	22,083	
	Pagesa për krerë	-	-	-	-	1	
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	22,083	
Qumësht	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	1,552	
	Numri i përfituesve	-	-	769	1,040	1,552	49
	Numri i litrave të paguara	-	-	-	-	-	
	Pagesa për litër	-	-	0.06/0.04 /0.02	0.06/0.04 /0.02	0.06/0.04 /0.02	
	Shuma totale e paguar	-	-	491,884	711,644	1,082,829	52
Therje të raportuar të gjedhit	Numri i aplikuesve	-	-	-	1	9	800
	Numri i përfituesve	-	-	-	1	9	800
	Numri i krerëve të paguar	-	-	-	84	526	526
	Pagesa për krerë	-	-	-	30	30	0
	Shuma totale e paguar	-	-	-	2,520	15,780	526

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Lopë qumështore

Pagesat direkte për lopë qumështore në vitin 2016 ishin 4.6 mil. € dhe ka shënuar rritje për 22% në krahasim me vitin 2015. Numri i aplikuesve është rritur për 17% ndërsa numri i përfituesve për 19%. Përqindja e fermerëve të refuzuar është për 1.4 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2015. Në aspektin e shpërndarjes regjionale, numri më i madhe i lopëve qumështore të mbështetura ishte në regjionin e Pejës me 24%, pasuar nga Prishtina me 19%, Gjakova dhe Mitrovica me nga 14% secila, Gjilani me 12%, Ferizaji me 9% si dhe Prizreni me 8%.

**Figura 60: Pagesat direkte për lopë qumështore 2012-2016, në 1000 € (majtas); Numri i lopëve qumështore të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Numri total i lopëve qumështore të subvencionuara në vitin 2016 ishte 65,857 krerë. Numri mesatar i lopëve për të cilat një fermerë përfitoi ishte 8-9 krerë, e kjo mesatare ishte më e larta në regjionin e Gjilanit dhe nuk kishte dallim të madh në mes të regjioneve në numrin mesatar të krerëve të subvencionuar. Përqindja e fermerëve të refuzuar ishte 4.1%, ndërsa më e larta ishte në regjion të Ferizajit me 4.5%.

**Tabela 98: Pagesat direkte për lopë qumështore sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i krerëve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	1,516	1,442	12,684	887,880
2	Prizren	676	642	5,502	385,140
3	Pejë	1,843	1,771	15,595	1,091,650
4	Mitrovicë	1,172	1,146	9,168	641,760
5	Gjakovë	1,147	1,105	9,241	646,870
6	Ferizaj	752	703	5,546	388,220
7	Gjilan	875	841	8,121	568,470
	<b>Gjithsej</b>	<b>7,981</b>	<b>7,650</b>	<b>65,857</b>	<b>4,609,990</b>


Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)



## Delet dhe dhitë

Delet dhe dhitë kanë vazhduar të subvencionohen me nga 15 €/krerë edhe në vitin 2016. Shuma totale e pagesave ka qenë 1.9 mil. € apo 1% më e lartë sesa në vitin 2015. Nga shuma totale e mbështetjes 92% janë subvencione për dele dhe vetëm 8% për dhitë.

**Figura 61: Pagesat direkte për dele dhe dhi 2012-2016, në 1000 €**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Subvencione për dele kanë përfituar gjithsej 1,069 fermerë që përbëjnë 96% të fermerëve të cilët kanë aplikuar, ndërsa sa i përket numrit të fermerëve të refuzuar më së shumti ka pasur në regjionin e Prishtinës, pasuar nga Ferizaji dhe Mitrovica. Numri mesatar i deleve për të cilat një fermerë ka përfituar ka qenë 111 krerë dhe kjo ka ndryshuar varësisht nga regjioni, mesatarja më e ulët ka qenë në regjionin e Mitrovicës me 81 krerë ndërsa ajo më e larta në regjionin e Prizrenit me 140 krerë.

**Tabela 99: Pagesat direkte për dele sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i krerëve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	193	182	16,920	253,800
2	Prizren	215	209	29,156	437,340
3	Pejë	194	190	15,534	233,010
4	Mitrovicë	131	124	10,034	150,510
5	Gjakovë	126	124	16,120	241,800
6	Ferizaj	111	102	12,726	190,890
7	Gjilan	141	138	17,645	264,675
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,111</b>	<b>1,069</b>	<b>118,135</b>	<b>1,772,025</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Shuma totale e pagesave direkte për dhitë ka qenë 161,220 € apo 10% më e madhe sesa në vitin 2015. Numri i fermerëve përfitues të pagesave direkte për dhi ka qenë më i vogël krahasuar me delet, nga totali i aplikuesve prej 214 fermerë, 204 kanë përfituar dhe numri më i madh ka qenë në regjionin e Prishtinës dhe atë të Gjilanit. Sa i përket numrit të fermerëve të

refuzuar, më shumë ka pasur në regjionin e Prishtinës dhe Pejës ndërsa më pak në regjionet e tjera.

**Tabela 100: Pagesat direkte për dhi sipas regjionit, në vitin 2016**


Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i krerëve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	58	55	2,662	39,930
2	Prizren	21	21	1,184	17,760
3	Pejë	33	30	1,346	20,190
4	Mitrovicë	22	21	1,290	19,350
5	Gjakovë	21	20	1,853	27,795
6	Ferizaj	18	17	720	10,800
7	Gjilan	41	40	1,693	25,395
	Gjithsej	214	204	10,748	161,220

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Regjioni i cili karakterizohet me numrin më të madh të deleve të subvencionuara është regjioni i Prizreni (25%), pasuar nga Gjilani (15%), Prishtina dhe Gjakova me nga 14% dhe regjionet e tjera me 32%. Regjioni që ka pasur numër më të vogël të deleve të subvencionuara ka qenë regjioni i Mitrovicës.

Sa i përket numrit të dhive të subvencionuara prin regjioni i Prishtinës me 25% pasuar nga Gjakova me 17%, Gjilani me 16%, Peja dhe Mitrovica me nga 12% secila dhe regjionet e tjera me 18%.

**Figura 62: Numri i deleve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (majtas); Numri i dhive të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**




Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Dosat

Sektori i dërrërisë ka filluar të subvencionohet për herë të parë në vitin 2014. Përmes pagesave direkte janë subvencionuar dosat në riprodhim dhe fermerët kanë përfituar nga 20 €/krerë. Në vitin 2016 totali i mbështetjes për dosat ka qenë rreth 14 mijë € apo 25% më shumë sesa në vitin 2015. Numri më i madh i dosave të subvencionuar ka qenë në regjionin e Gjilanit (38%), pasuar nga regjioni i Mitrovicës me 24% dhe Prishtinës me 21%, ndërsa pjesa tjetër prej 17% në katër regjionet tjera (Pejë, Gjakovë, Ferizaj dhe Prizren).

**Figura 63: Pagesat direkte për dosa 2014-2016, në 1000 € (majtas); Numri i dosave të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Nga totali i fermerëve aplikues 11.7% janë refuzuar dhe kanë qenë kryesisht nga regjioni i Gjilanit, Mitrovicës, Pejës dhe Prishtinës, nuk ka pasuar të refuzuar në regjionin e Prizrenit, Ferizajit dhe të Gjakovës. Numri total i dosave të subvencionuara ka qenë 702 krerë.

**Tabela 101: Pagesat direkte për dosa sipas regjionit, në vitin 2016**


Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i krerëve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	37	36	147	2,940
2	Prizren	2	2	8	160
3	Pejë	22	21	85	1,700
4	Mitrovicë	15	8	166	3,320
5	Gjakovë	4	4	15	300
6	Ferizaj	2	2	12	240
7	Gjilan	55	48	269	5,380
	<b>Gjithsej</b>	<b>137</b>	<b>121</b>	<b>702</b>	<b>14,040</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Bletaria

Mbështetja për sektorin e bletarisë është rritur në vazhdimësi duke arritur në rreth 2.2 mil. € në vitin 2016. Krahasuar me vitin 2015 shuma totale e subvencioneve për bletë është rritur për 91% ndërsa krahasuar me mesataren e katër viteve të fundit shuma e subvencioneve për bletë është trefishuar e kjo si rezultat i rritjes së numrit të koshereve të subvencionuara por edhe rritjes së pagesës për një koshere nga 10 € në sa ishte që nga fillimi në 15 €/koshere. Shpërndarja e subvencioneve në regjione në rastin e bletëve nuk ka pasuar dallime të mëdha, mbështetja në regjionet e Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Mitrovicës dhe Gjakovës ka variuar nga 13% deri në 20% varësisht nga regjioni, ndërsa regjioni i Ferizajit dhe Gjilanit kanë përfituar më pak, përkatësisht të dy së bashku 18%.

**Figura 64: Pagesat direkte për bletë 2012-2016, në 1000 € (majtas); Numri i koshereve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Numri mesatar i koshereve për të cilat ka përfituar një fermerë ishte 61 koshere dhe nuk ka pasur dallime të mëdha në mes të regjioneve. Përqindja e fermerëve të refuzuar është ulur nga 5% sa ishte në vitin 2015 në vetëm 1% në vitin 2016. Sa i përket numrit të fermerëve të refuzuar përqindja më e lartë në krahasim me mesataren ishte vetëm në Ferizaj dhe Gjilan.

**Tabela 102: Pagesat direkte për bletë sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i koshereve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	510	506	29,036	435,540
2	Prizren	291	288	18,935	284,025
3	Pejë	453	448	26,210	393,150
4	Mitrovicë	380	377	25,160	377,400
5	Gjakovë	286	286	18,313	274,695
6	Ferizaj	212	208	12,203	183,045
7	Gjilan	246	240	14,061	210,915
	<b>Gjithsej</b>	<b>2,378</b>	<b>2,353</b>	<b>143,918</b>	<b>2,158,770</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)


## Shpezëtaria

Në kuadër të sektorit të shpezëtarisë përmes pagesave direkte mbështeten pulat vojse dhe thëllëzat. Mbështetja për pulat vojse ka filluar që nga viti 2013, ndërsa mbështetja për thëllëzat filloi për herë të parë në vitin 2016.

## Pula vojse

Pagesat direkte për pula vojse në vitin 2016 arritën në 346 mijë € e që na krahasim me vitin 2015 ato u rritën për 64% përderisa numri i pulave vojse të subvencionuara u rrit për 68%. Në vitin 2016 numri i aplikuesve mbeti i njëjtë ndërsa numri i përfituesve u rrit për 37%, që rezultojnë më rënie të përqindjes së fermerëve të refuzuar. Numri më i madh i pulave vojse të subvencionuara ishte në regjionin e Gjakovës (37%) pasuar nga Prishtina me 26%, Prizreni me 11% dhe regjionet e tjera me 26%.

**Figura 65: Pagesat direkte për pula vojse 2013-2016, në 1000 € (majtas); Numri i pulave vojse të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Nga totali i numrit të aplikuesve janë subvencionuar 91%, ndërsa pjesa tjetër prej 9% janë refuzuar për shkak të mos përmbushjes së kriterëve dhe këta fermerë kanë qenë nga regjionin e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjakovës dhe Ferizajit, ndërsa nuk ka pasur të refuzuar në regjionin e Mitrovicës dhe Gjilanit.

**Tabela 103: Pagesat direkte për pula vojse sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i krerëve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	23	21	202,999	89,373
2	Prizren	16	14	87,012	39,651
3	Pejë	11	10	68,600	32,650
4	Mitrovicë	5	5	38,980	17,540
5	Gjakovë	17	16	290,495	124,643
6	Ferizaj	10	8	75,050	32,205
7	Gjilan	4	4	20,395	10,198
	<b>Gjithsej</b>	<b>86</b>	<b>78</b>	<b>783,531</b>	<b>346,259</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Thëllëzat

Mbështetja e thëllëzave përmes pagesave direkte ka filluar për herë të parë në vitin 2016 dhe subvencioni ka qenë 1 €/krerë. Kanë aplikuar 7 fermerë dhe vetëm një prej tyre në regjionin e Mitrovicës është refuzuar. Numri total i thëllëzave të subvencionuara ka qenë 22,083 krerë. Nuk ka pasur fare aplikues nga regjionet: Pejë, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan.


**Tabela 104: Pagesat direkte për thëllëza sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i krerëve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	2	2	16,840	16,840
2	Prizren	1	1	570	570
3	Pejë	-	-	-	-
4	Mitrovicë	4	3	4,673	4,673
5	Gjakovë	-	-	-	-
6	Ferizaj	-	-	-	-
7	Gjilan	-	-	-	-
	Gjithsej	7	6	22,083	22,083

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Nga totali i thëllëzave të subvencionuara 76% kanë qenë në regjionin e Prishtinës, përkatësisht në komunën e Podujevës dhe Drenasit, 21% në regjionin e Mitrovicës dhe 3% në atë të Prizrenit. Numri mesatar i thëllëzave për të cilat një fermerë ka përfituar ishte 3,680 krerë, e kjo mesatare ishte më e larta në regjionin e Prishtinës me 8,420 krerë dhe më e ulëta në regjionin e Mitrovicës me 570 krerë, ndërsa në regjionin e Prizrenit kjo mesatare ishte 1,558 krerë.

**Figura 66: Numri i thëllëzave të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016**




Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Qumësht sipas cilësisë

Mbështetja e qumështit sipas klasave të cilësisë filloi të implementohet për herë të parë në vitin 2014. Në vitin 2016 totali i pagesave direkte për qumësht sipas cilësisë ishte rreth 1.1 mil. €, e që shënoi rritje 52% krahasim me vitin 2015. Numri i përfituesve në vitin 2016 u rrit për 49% në krahasim me vitin paraprak dhe nuk kishte fermerë të refuzuar. Pjesa më e madhe e qumështit të dorëzuar ka qenë në regjionin e Pejës dhe Gjakovës që është një indikator tregues se industria përpunuese e qumështit është më e zhvilluar në këto regjione krahasuar me regjionet e tjera. Nga totali i numrit të përfituesve, këto dy regjione kanë pjesëmarrje 65%, pasuar nga Prishtina (11%), Mitrovica dhe Peja me nga 9% secila, Gjilani me 4% dhe Ferizaji me 2%.

**Figura 67: Pagesat direkte për qumësht sipas cilësisë 2014-2016, në 1000 € (majtas); Numri i fermerëve përfitues për qumësht sipas cilësisë sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Në vitin 2016, gjatë periudhës prej 4 tremujorëve kanë përfituar gjithsej 1,552 fermerë nga regjione të ndryshme. Këta fermerë kanë përfituar për qumështin e dorëzuar në qumështore të licencuara. Mesatarja e numrit të përfituesve gjatë një tremujori ka qenë rreth 388 përfitues ndërsa shuma mesatare e marr nga një përfitues brenda një tremujori ka qenë rreth 700 €. Numri më i madh i përfituesve ka qenë në tremujorin e katërt, ku kanë përfituar 455 fermerë ndërsa më i ulëti në tremujorin e parë me 338 fermerë.

**Tabela 105: Pagesat direkte për qumësht sipas cilësisë në regjione, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i fermerëve përfitues	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	204	124,979
2	Prizren	202	95,190
3	Pejë	523	429,215
4	Mitrovicë	127	94,273
5	Gjakovë	370	272,484
6	Ferizaj	51	27,222
7	Gjilan	75	39,466
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,552</b>	<b>1,082,829</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

### **Therjet e raportuara të gjedhit**

Pagesat direkte për subvencionimin e gjedheve për herë të parë filluan në vitin 2015, ku ishte vetëm një thertore që aplikoi për 84 krerë të therur. Për dallim nga viti i parë i subvencionimit, në vitin 2016 aplikuan 9 thertore, dhe numri i krerëve të therur të raportuar ishte më shumë se 6-fishi i numrit të raportuar në vitin 2015. Shuma totale e pagesave direkte për therje të raportuara të gjedhit ishte 15,780 €, prej të cilave 10,520 € janë pagesa që kanë shkuar tek fermerët ndërsa thertores 5,260 €.

**Tabela 106: Pagesa direkte për therje të raportuara të gjedhit në vitin 2016**

Numri i aplikuesve	9
Numri i përfituesve	9
Numri i krerëve të therur	526
Pagesa për krerë të therur	30
Pagesa për fermerin për krerë të therur	20
Pagesa për therëtoeren për krerë të therur	10
Shuma totale e paguar	15,780

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)




### 5.2.3 Mbështetja e inpueteve në bujqësi

#### Mbështetja e fidanëve

Shuma totale e pagesave direkte për fidanë në vitin 2016 ishte rreth 77 mijë €, krahasuar me vitin 2015 kishte rënie për 22%. Numri më i madh i fidanëve të subvencionuar është në regjionin e Gjakovës (38%), pasuar nga Gjilani (33%), Peja (23%) dhe regjionet e tjera me 6% së bashku. Në regjionin e Prishtinës dhe Mitrovicës nuk ka pasur fare aplikues.

**Figura 68: Pagesat direkte për fidanë 2013-2016, në 1000 € (majtas); Numri i fidanëve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2016 (djathtas)**



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Në vitin 2016, numri i aplikuesve dhe përfituesve u zvogëlua për 10.5%, ndërsa edhe këtë vit sikurse në vitin 2015 nuk kishte fermerë të refuzuar. Numri më i madh i përfituesve është në regjionin e Gjilanit por duke qenë se mesatarja e fidanëve për të cilat një fermer ka përfituar është më e ulët, me numrin e fidanëve të subvencionuar prin regjioni i Gjakovës.

Mesatarja e fidanëve për të cilat një fermer ka përfituar ishte rreth 25 mijë fidanë, më e ulëta ishte në regjionin e Ferizajit (5,644 fidanë) ndërsa më e larta në regjion të Gjakovës (55,167 fidanë).

**Tabela 107: Pagesat direkte për fidane sipas regjionit, në vitin 2016**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr i fidanëve të subvencionuara	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	-	-	-	-
2	Prizren	1	1	22,000	4,400
3	Pejë	5	5	97,520	19,504
4	Mitrovicë	-	-	-	-
5	Gjakovë	3	3	165,500	23,750
6	Ferizaj	1	1	5,644	1,129
7	Gjilan	7	7	140,750	28,150
	<b>Gjithsej</b>	<b>17</b>	<b>17</b>	<b>431,414</b>	<b>76,933</b>


Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

## Agro kreditë dhe fondi garantues

Sektori bujqësor në Kosovë përkundër vështirësive, favorizimit dhe shpalljes si prioritet qeveritar për ekonominë e vendit, ende ka nevojë të madhe për financim - edhe për agro-kredi. Sektorit bujqësor i janë nevojitur vite të tëra të rimëkëmbjes dhe normalizimit përkundër kësaj, zhvillimi i këtij sektori nuk është ende në nivelin e dëshiruar, pavarësisht përkrahjes së vazhdueshme si nga ana e qeverisë (me grante dhe subvencione) ashtu edhe nga donatorë të jashtëm.

Bujqësia vazhdon të ketë qasje të ulët në financimin e përgjithshëm bankar me vetëm 4.2% për vitin 2016 (0.3 pikë përqindje më të ulët se në vitin paraprak), sektor që më së paku është kredituar nga institucionet financiare në Kosovë. Kamatat në kredi dhënie për sektorin bujqësor janë të larta në krahasim me kreditë e sektorëve tjerë dhe me vendet e regionit, megjithëse viti 2016 u karakterizua me rënie të normës së interesit për 1.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak apo për 4.9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2014, e që do të jetë stimulim pozitiv për fermerët.

**Figura 69: Norma e interesit në Kredi Bujqësore, %**



Burimi: BQK

Agro kreditë njihen si kredi jopërformuese, për këtë arsye kreditimi ka një kosto të lartë nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare (IMF) për fermerët. Ky nivel i ulët i kreditimit vë në pah qasjen konservatore të sistemit bankar kundrejt sektorit të bujqësisë. Mungesa e sistemit të sigurimeve në bujqësi po ashtu ndikon mjaft në qasjen e fermerëve në kredi respektivisht në kredi të volitshme.

Me qëllim të shtimit të efektivitetit në fermë, fermerët kanë nevojë të zgjerojnë më shumë nivelin e financimit të investimeve të tyre në: blerje të pajisjeve dhe makinerive bujqësore të teknologjisë së re, blerje të inventarit, rregullim dhe zgjerim të fermave, tokave, blerja e bagëtive për rritjen e fondit të tyre, blerje të inputeve, krijimi i pikave grumbulluese, depo-frigo ruajtëse dhe shumë paisje tjera bujqësore. Investimet e tilla në fermë, u mundësojnë fermerëve rritjen e produktivitetit dhe njëkohësisht përgatitjen për sezonin e ri bujqësor.

Përmes investimeve të ndryshme në këtë sektor, do të mundësohet përmirësimi i mirëqenies në zonat rurale, shtimi i prodhimit vendor gjë që do të ndikoj në zëvendësimin e produkteve të importit dhe krijimit të mundësive për eksport.

Bankat që mbështesin financiarisht me kredi sektorin e bujqësisë në Kosovë janë: Banka për Biznes, Banka Ekonomike, Raiffeisen Bank (RBKO), Procredit Bank (PCB), TEB Bank, NLB Prishtina dhe Banka Kombëtare Tregtare, ndërsa Institucionet Mikrofinanciare janë: Qelim Kosovë, Timi Invest, Start, Perspektiva 4, Mështekna, Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), KosInvest Word Vision, KGMAMF, KEP Trust, Finca dhe Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK).

Lider në shumën e Agrokredive të disbursuara është PCB, TEB dhe RBKO, pasuar nga Institucionet Mikrofinanciare: KRK, AFK, Finca etj. Në tabelë shihet që më së shumti kredi janë disbursuar në vitin 2016 dhe 2015. Shuma totale e kredive të disbursuara në vitin 2016 është për 0.4% më e madhe sesa në vitin 2015, e kjo rritje është shumë e vogël në krahasim me rritjen prej 20% që ishte në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Numri i kredive të dhëna që nga fillimi i vitit 2010 deri në vitin 2016 është rreth 135 mijë kredi me një shumë totale prej 461.8 mil. €. Pra, për këto 7 vite, çdo muaj janë disbursuar mesatarisht rreth 1,600 kredi me një shumë mesatare prej 5.5 mil. €.


**Tabela 108: Agrokreditë 2010-2016**

Agro Kredi 2010 - 2016	Kredi të disbursuara	Numri i kredive të disbursuara	Shuma e kredive të disbursuara / Banka dhe IMF (€)	Shuma totale e kredive të disbursuara (mn €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në krahasim me kreditë tjera (%)
2010	4 - 10,772	24,528	37,600 - 28,600,000	58.0	12 - 45	12.0 - 32.6	0.06 - 67.02
2011	3 - 7,198	20,865	8,600 - 27,390,000	56.2	16 - 33	12.0 - 32.8	0.02 - 60.83
2012	7 - 5,645	18,961	11,000 - 27,550,000	57.2	16 - 27	12.0 - 28.1	0.01 - 59.00
2013	3 - 3,608	17,578	15,300 - 24,600,000	60.6	15 - 45	10.5 - 26.2	0.02 - 64.00
2014	14 - 3,638	16,360	18,400 - 18,500,000	67.3	13 - 50	9.0 - 26.5	0.7 - 58.6
2015	20 - 4,270	17,308	31,600 - 29,000,000	81.1	13 - 42	9.3 - 26.6	0.5 - 51.4
2016	9 - 5,008	19,086	25,500 - 17,000,000	81.4	12 - 42	8.0 - 26.9	0.5 - 60.0
Gjithsej		134,686	2,781.28	461.8			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë


Me shumën e kredive të disbursuara kryesojnë: PCB, TEB, RBKO, kurse nga MFI-të: KRK, AFK, Finca dhe KEP. Nga të dhënat në tabelë dhe figurë, shihet qartë që viti 2015 dhe 2016, dallojnë me dhënie të kredive kurse viti 2011 për dallim nga viti 2016, është më i ulët për 31%.

**Figura 70: Shuma totale e kredive të disbursuara (mil. €)**



Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë

**Figura 71: Numri i kredive të disbursuara**



Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë

Afati i dhënies së kredive bujqësore ndryshon nga 12 deri 50 muaj, varësisht prej destinimit të kredisë. Maturiteti maksimal ishte prej 13 deri 50 muaj në vitin 2014, kurse ai minimal 16 deri në 27 muaj në vitin 2012.

Në vitin 2016 afati i dhënies së kredive ishte 12-42 muaj dhe norma e interesit ndryshoi nga 8% deri në 26.9%, varësisht nga shuma e kredisë dhe afati i kthimit. Prodhuesit bujqësor vazhdojnë të kenë pakënaqësi për normat e interesit, të cilat nuk e stimulojnë zhvillimin e këtij sektori.

Kolaterali zakonisht nuk kërkohet për shuma të vogla të kredisë ndërsa për shuma mesatare dhe të mëdha, bankat dhe IMF kërkojnë kolateral prej 100% e deri në 388% të shumës së kredisë. Vitet paraprake karakterizohen me normë të ulët të kolateralit, duke vazhduar në vitin 2012 me normën më të lartë, ndërsa në vitet e fundit ka pasur normalizim të dukshëm. Në përgjithësi si standard për kolateral kërkohet prej huadhënësit nga 100% deri 150% e vlerës së kredisë.

Grejs periudha apo periudhë e shtyrjes së pagesës, varion nga 3 deri në 12 muaj, megjithëse në disa publikime figuron 18 muaj, varësisht nga rastet ku grejs periudha është fleksibile. Ndër vite vërehet që grejs periudha ishte më e ulët kurse në vitet e fundit ka ngritje të saj. Shlyerja e përqindjes më të madhe të kredive bëhet pas sezonit të korrjes.

Huamarrja në banka dhe institucione mikrofinanciare, normat e interesit ndryshojnë varësisht nga shuma e kredisë dhe maturiteti i saj, sa më e madhe është shuma dhe sa më e shkurtë është kohëzgjatja e kredisë, aq më e ulët është kamata apo norma e interesit si dhe e kundërta.

Në vazhdim do t'i paraqesim pozicionet e institucioneve financiare (në botimet e mëhershme i gjeni nga viti 2006) sipas viteve:

Viti 2016, prin me numër të kredive të disbursuara nga PCB, TEB, KRK, AFK dhe Finca, me shumë të kredive të disbursuara janë: KRK, AFK, Finca dhe TEB, ndërsa me përqindjen e pjesëmarrjes së Agrokredive në krahasim me kreditë tjera janë: Perspektiva, KRK, KGMAMF dhe Afk. Pra në dy-tri vitet e fundit shifet ngritja e aktiviteteve në TEB dhe Finca.

Sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së kredive të këqija tek agrokreditë, mund të themi se janë në nivelin e pranueshëm brenda limiteve të përcaktuara nga shumica e bankave dhe institucioneve financiare. Krahasuar me vendet e rajonit, jemi në një nivel shumë të kënaqshëm.

Ndër vite te Bankat, maksimumi i kredive të këqija ishte 5.4%, ndërsa te Institucionet Mikrofinanciare luhatet në mes 9.4% dhe 23.8%, përjashtim ka vetëm një Institucion Mikrofinanciar që kreditë e këqija ishin rreth 85%, për dhjetë vitet e fundit.

### **Fondi garantues**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) u jep përkrahje investimeve në bujqësi, duke garantuar për kreditë e fermerëve. Në fund të vitit 2012, falë bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ku vlen të theksohet iniciativa e Autoritetit të Zhvillimit të Kredisë - DCA nga USAID-i dhe MBPZHR, për të ulur normën e interesit për kredi (rreth 3%) duke garantuar në 50% të vlerës së kredive bujqësore.

Për të ofruar garanci të kredisë në marrëveshje me gjashtë bankat kryesore të Kosovës në lëshimin e kredive, njëherit duke e rritur qasjen për kredi në bujqësi dhe agrobiznese, ky fond kontribuon në vlerë të përgjithshme me 26 mil. \$ (rreth 23.5 mil. €), ku MBPZHR ka pjesëmarrje me 2.5 mil. €. Programi i USAID-it, ofron mundësi të reja në Bujqësi për një periudhë katër vjeçare, me qëllim të krijimit të kushteve më të volitshme kreditore në sektorin e bujqësisë e që do të krijonte një zhvillim të qëndrueshëm bujqësor, rritje të eksportit, krijim të vlerës së shtuar dhe krijim të vendeve të reja të punës.

Fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bujqësore (NVM) do të përballen me procedura të lehtësuara për marrje të kredive për shkak se DCA, ka siguruar një garanci të

rrezikut 50% për kreditë e lëshuara nga këto banka me kohëzgjatje 12-60 muaj dhe me shuma nga 5,000 deri në 250,000 € për fermerët dhe agrobizneset e kualifikuara. Programi është dizajnuar për të rritur kreditimin në sektorin e bujqësisë, duke parë vështirësitë aktuale në këtë segment.

Për secilën bankë është paraparë analiza e disa indikatorëve të kredive sipas 4 periudhave bankare. Përveç të dhënave fillestare, janë marrë parasysh edhe indikatorët për aplikim të fondit garantues.

Nëse shikojmë të dhënat e njëres nga bankat në Kosovë pa DCA, vërejmë se shuma e kredisë mesatare gjatë periudhave është afërsisht 16,000 €, ndërsa me DCA kjo shumë është dyfishuar ose është akoma më e lartë. Vërehet një ndryshim edhe në kohëzgjatjen mesatare të kredive, e cila ndryshon nga 36 muaj pa DCA në 48 muaj me DCA.

Duke pasur një fond garantues, bankat lejojnë kredi me norma interesi më të ulëta dhe si rezultat i kësaj ato kanë ndryshuar nga 13.6% pa DCA, në 9.5% me fond garantues për periudhën e llogaritur (2013/2014).

Për sigurim të kredisë, bankat kërkojnë kolateral për shumën mbi 25,000 € (me DCA). Për shembull, në periudhën Prill-Shtator 2015, kredia mesatare ishte afërsisht 22,000 € ndërsa kolaterali rreth 60,000 €, me aplikimin e DCA-së, raporti mes shumës mesatare të kredisë dhe kolateralit është më i vogël (40,000 € me 55,000 €).

Kur analizojmë të dhënat e një bankë që lëshon shumë më pak kredi krahasuar me bankat që kanë numër të madh të kredive, vërejmë raporte të ngjashme mes indikatorëve para DCA-së dhe atyre pas DCA-së. Edhe këtu shuma e kredisë mesatare është shumë më e lartë pas aplikimit të DCA-së, kohëzgjatja e kredisë rritet, ndërsa vërehet dukshëm ulja e normës së interesit mesatarisht për 4% nga norma standarde e interesit.

Nga faktorët e përmendur më lartë, mund të konkludojmë se aplikimi i DCA-së është një hap pozitiv i cili çon përpara dhe lehtëson kredi dhënien për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobizneseve, duke u nisur nga vet fakti që edhe vendet e rajonin kanë nisur ta aplikojnë. Të dhënat e fundit që i posedojmë, 4 banka i kanë shfrytëzuar plotësisht këto mjete, me 894 kredi nga shuma totale 86% e Fondit Garantues është shfrytëzuar.

Për vitin 2015, vërehet një pasqyrë e re e hua dhënies me zbritje të kamatës nga ana e bankave, por jo edhe nga institucionet mikrofinanciare. Falë angazhimit dhe bashkëpunimit të BQK, MBPZHR, USAID etj, është arritur ulje e interesit bankar në kredi dhënie për sektorin bujqësor dhe lehtësim në dhënien e tyre.

Projekti arrin në fund të vitit 2016, me 88.8% të shumës së gjithmbarshme të realizuar, me shumë mesatare të disbursuar 25,257 \$, në total me 913 kredi. Në tabelat prezantuara më lartë vërehet efekti pozitiv i projektit ku është pasqyruar rënia e kamatës të kredive bujqësore në këto katër vite.

### 5.3 Sigurimet në fushën e bujqësisë

Prodhuesit bujqësorë në Kosovë ashtu si edhe në gjithë botën përballen me rreziqe të shumta që ndikojnë në të ardhurat dhe mirëqenien e tyre familjare. Këto janë kryesisht rreziqet që lidhen me: kushtet atmosferike, dëmtuesit, sëmundjet e shumë faktorë tjerë. Për këtë arsye, sigurimi në bujqësi është një mjet i domosdoshëm i menaxhimit të rrezikut për bujqësinë moderne që promovon zhvillimin e sektorit bujqësor më konkurrues përmes investimeve të reja kapitale, adaptimin e teknologjive të fundit dhe risive në prodhimin, përpunimin dhe marketingun. Përfitimet që rrjedhin nga sigurimi efektiv në bujqësi do të ketë ndikim të gjerë pozitiv në sektorët tjerë, që në mënyrë zingjyrore janë të lidhura me zhvillimet në bujqësi.

Para 30 vitesh në territorin e Kosovës, sigurimit në bujqësi dhe blegtori i kushtohej një rëndësi mjaft e madhe, pasi që kooperativat bujqësorë ishin të obliguara të siguronin prodhimin e tyre. Gjithsejtë 60% e buxhetit të atëhershëm të kompanive të sigurimeve ishin të dedikuara për sigurimet në bujqësi. Agrokosova asokohe kishte pistat dhe aeroplanët bujqësor që ishin në Dobrajë, Klinë, Gjakovë (Bec) dhe Skenderaj, të cilat mbusheshin me preparate të caktuara dhe bëhej spërkatja në vende të ndryshme. Po ashtu ka ekzistuar edhe sistemi raketor anti breshër (Anti-hail rockets), që ka mbrojtur prodhimtarinë bimore nga dëmtimet e shkaktuara nga breshëri dhe i njëjti ka ekzistuar deri pas luftës. Është me rëndësi të ceket edhe ekzistimi i 'Fondit preventiv' i cili në masë të madhe ka ndikuar në zvogëlimin e rrezikut për siguresin si p. sh. Parandalimi i vërshimeve duke bërë thellimin e kanaleve apo shtretërve të lumenjve ekzistues, furnizimi me rrjeta si dhe ofrimi i ndihmave tjera të natyrës së ngjashme.

Sigurimi në bujqësi nuk është i zhvilluar aktualisht në Kosovë. Sigal është kompani e licencuar e sigurimeve që është duke vepruar në Kosovë. Bordi i Drejtorëve të Sigal-it ka miratuar futjen e një pilot projekti për sigurimin e lopëve qumështore dhe varësisht nga rezultatet do të përcaktohet edhe me zgjerimin në kategori tjera bujqësore. Sigal është në partneritet me Raiffeisen Bank dhe meqenëse banka merr në konsideratë sigurimin për lejimin e kredisë, kjo do të jetë një garancë e rëndësishme në vendimet për dhënien e kredisë. Sigal do të lëshojë sigurimin për vdekshmërinë dhe therjen e detyrueshme të lopëve qumështore. Për të marrë sigurimin, lopët duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermave dhe pronari duhet të ketë një kontratë me një përpunues të qumështit për shitjen e prodhimit të tij. Fermeri duhet të ketë 5 ose më shumë lopë. Sigurimi do të jetë i lidhur me financimin e kredive përmes Raiffeisen Bank. Sigal sheh pengesat kryesore për sigurimin në bujqësi në ekspertizën teknike të kufizuar në Kosovë dhe statistikat e pamjaftueshme, ku do të mund të siguroheshin të dhënat e përditësuara në ferma (lëvizjet në fermë), dhe përlllogaritjet lidhur me humbjet në fermë në raste të fatkeqësive natyrore.

Sipas informatave që janë marrë nga Banka Qendrore e Kosovës, nga dymbëdhjetë Kompanitë ekzistuese të Sigurimit që merren me sigurime në bujqësi janë të licencuara: "Kosova e re", "Sigma", "Sigal" dhe "Siguria".

Këto kompani janë të organizuara në kuadër të Shoqatës së Sigurimeve dhe në mesin e tyre ekziston një gatishmëri rreth trajnimit të stafit për produktin 'Sigurimi në bujqësi dhe blegtori' si dhe në promovimin e saj.

Procedurat e autorizimit të kompanive bazohen në kuadër të Ligjit për Sigurime Nr. 05/L-045 Neni 7/9, BQK pranon kërkesat nga kompanitë që vijnë për licencim të cilat i shqyrton brenda 15 ditësh ndërsa i aprovon brenda 90 ditësh. Tarifat bëhen në suaza të kontratave vullnetare nga ana e kompanive siguruese varësisht prej kushteve të veçanta apo të përgjithshme të kontratës. Kompanive i është ofruar asistencë teknike nga projekti NOA-USAID-i, për kalkulimin e primit dhe vlerësimin e humbjeve. Në rast kontesti në bazë të policës së sigurimit apo fletë mbulesës, përgjigjet BQK-ja. Përpjekje për përkrahjen dhe avancimin e kësaj çështje ka bërë edhe IFC, EFSE etj.

Bazuar në trendin e zhvillimeve të sigurimit të llojit në fjalë, kompanitë e sigurimeve paksa me hezitim janë duke u orientuar për këtë lloj produkti, duke qenë të vetëdijshme se ka shumë përgatitje teknike dhe se nuk sigurojnë profit të madh, kështu që shfaqin mosinteresim dhe largohen nga ky lloj i sigurimit.

Për përmirësimin e situatës ekzistuese pritet përkrahje apo participim në 'Sigurime në Bujqësi dhe Blegtori' nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

Nga IFC aktualisht janë duke u marr hapa konkret që në bashkëpunim me MBPZHR të fillohet me implementimin e sigurimeve në bujqësi.

### **Dëmet në bujqësi**

MBPZHR-ë është e interesuar që krahas mbështetjes së fermerëve me subvencione dhe grante të përkrahë edhe sigurimet në bujqësi, konkretisht kompensimin e primit në kompanitë e sigurimeve për fermerët që dëshirojnë të sigurojnë prodhimtarinë bimore dhe blegtorale. MBPZHR-ë përmes programit të ofrimit të granteve për fermerë, mund të lejojë që një pjesë e grantit të përdoret për të mbuluar koston e primit të sigurimit bujqësor, me qëllim të mbrojtjes së investimeve publike.

Në kuadër të lehtësimit të gjendjes së fermerëve në rast të goditjes nga fatkeqësitë elementare natyrore me vendim të sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR, ka nxjerrë vendimin për krijimin e Komisionit për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, breshëri dhe fatkeqësitë tjera natyrore në bujqësi. Ky komision ka vepruar që nga viti 2011, përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtarë dhe kryetari) dhe ka për detyrë që në bashkëpunim me zyrtarët e drejtorive komunale për bujqësi dhe zyrtarëve të zyrave regionale të bëjnë verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, breshëri dhe fatkeqësitë natyrore. Komisioni përgatitë raporte me shkrim dhe raporton te Sekretari i Përhershëm i MBPZHR.

Deri më tani nuk ekziston vijë e veçantë buxhetore për kompensimin e dëmeve. Sipas të dhënave që janë marrë nga Departamentit i Shërbimeve të Administratës Qendrore, për



“dëmet natyrore” (pa specifikuar se cilat janë ato dëme), vetëm në vitin 2013 për 16 fermerë është paguar shuma totale prej 17,600.00 €. Ndërkaq, në mungesë të fondit nuk janë realizuar pagesat për vitin 2014 dhe 2015.


Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar të dhënat e përgatitura nga Komisioni për Kompensimin e Dëmeve në bujqësi në MBPZHR (të dhënat e deklaruara nga palët e dëmtuara dhe të konfirmuara nga Komisioni) për vitet 2012 deri 2016.

**Tabela 109: Identifikimi i dëmeve në bujqësi sipas viteve:**

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Breshëri</b>	5,500	1,258,000	2,165,000	783,000	61,000
<b>Era</b>	120,000	107,000	22,500	100,000	403,540
<b>Vërshime</b>	48,000	78,000	702,000	11,000	428,320
<b>Zjarre</b>	706,000	182,000	185,000	161,000	127,530
<b>Të tjera</b>	1,019,574	289,116	137,249	88,886	1,461,128
<b>Shuma totale / €</b>	<b>1,899,074</b>	<b>1,914,116</b>	<b>3,211,749</b>	<b>1,143,886</b>	<b>2,481,518</b>

Burimi: MBPZHR

**Figura 72: Dëmet në bujqësi**



Burimi: MBPZHR

Nga grafiku dhe tabela, dallohet viti 2012 me 706 mi €, dëme nga zjarri, viti 2013 me 1.26 milion €, dëme nga breshëri ndërsa viti 2014 dallohet me 2.16 milion €, dëme nga breshëri dhe 702 mijë €, dëme nga vërshimet. Viti 2015 vazhdon me dëme nga breshëri për 783 mijë € pra shumë më pak se viti paraprak dhe rënie të dëmeve natyrore në përgjithësi. Viti 2016 karakterizohet me dëme prej ngricave që është me vlerë rreth 1 milion €, dhe dëme nga era dhe vërshimet me vlerë mbi 400 mijë €.

## 5.4 Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive

Bujqësia si një sektor i cili kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit synon që përmes mbështetjes/investimeve në fermat apo ekonomitë bujqësore të përmirëson gjendjen e sektorit të bujqësisë e njëkohësisht të rris edhe prodhimtarinë, cilësinë, kualitetin dhe vlerën e prodhimit bujqësor.

Gjatë vitit 2016, AZHB-ja ka bërë zbatimin e një pjese të PZHR-së duke përfshirë masat dhe nën-masat për sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR-së të vitit 2016.

Këto masa dhe nën masa të Zhvillimit Rural të cilat janë implementuar gjatë vitit 2016, kanë qenë si në vijim:

**Masa 101 – Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore,** kjo masë përfshinë sektorin e pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull dhe vishnje), sektori i pemëve të imëta (dredhëz, mjedër, manaferrë, boronicë dhe aroni), sektori i serrave përfshirë patatet dhe depo për ruajtjen e perimeve, sektori i mishit (trashja e viçave dhe brojlerëve), sektori i qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi), sektori i rrushit si dhe sektori i pulave vojse.

**Masa 103 – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore,** kjo masë përfshinë sektorin e përpunimit të qumështit, sektorin e përpunimit të mishit, sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve si dhe sektorin e prodhimit të verës.

**Masa 302 – Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale,** përfshinë nënmasat si:

302.1 Bletaria, prodhimi/përpunimi dhe marketingu i mjaltit;

302.2 Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre;

302.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre;

302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre;

302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë.

**Masa – Skema për ujitjen e tokave bujqësore;**

**Masa 303 – Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale – qasja Leader,** përfshinë nënmasën,

303.2 Aktiviteti i parë “Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura” duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre dhe Aktiviteti i dytë “Zbatimi i SZhL-ve të GLV-ve të përzgjedhura” ku promovojnë dhe zbatojnë projekte të vogla në përputhje me SZhL-të.

Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë, gjegjësisht Divizioni për Miratim të Projekteve të Zhvillimit Rural gjatë vitit 2016, ka bërë zbatimin e një pjese të Programit për Zhvillim Bujqësor dhe Rural 2016.

Realizueshmëria e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural ka rrjedhur sipas aktiviteteve dhe planit të paraparë bazuar në buxhetin e ndarë për vitin 2016, i cili ishte 23,161,150 €.

**Tabela 110: Buxheti i paraparë i PZHR për vitin 2016**

<b>Masa dhe nënmasa</b>	<b>Vlera në €</b>
<b>Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore</b>	<b>14,500,000</b>
101.1 Sektori pemë drufrutore	2,500,000
101.1.1 Sektori i pemëve të imta (manore)	2,500,000
101.2 Sektori serra	3,000,000
101.2.1 Depo për ruajtje të perimeve	1,200,000
101.3 Sektori i mishit (trashja e viçave)	1,600,000
101.3.1 Sektori i mishit (rritja e brojlereve)	500,000
101.4 Sektori i qumështit (lopët)	1,600,000
101.4.1 Sektori i qumështit (dele dhe dhi)	500,000
101.5 Sektori i rrushit	800,000
101.6 Sektori i vezëve	300,000
<b>Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore</b>	<b>5,000,000</b>
103.1 Sektori i përpunimit të qumështit	1,200,000
103.2 Sektori i përpunimit të mishit	1,400,000
103.3 Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve	1,600,000
103.4 Sektori i përpunimit të verërave	800,000
<b>Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve</b>	<b>1,500,000</b>
302.1 Sektori, bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	500,000
302.2 Sektori përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe këpurdhave të grumbulluara	200,000
302.3 Sektori përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudha dhe qumështi i deleve, dhive)	200,000
302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	200,000
302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	400,000
<b>Masa: Ujitje e tokave bujqësore</b>	<b>2,000,000</b>
<b>303.2 Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale- qasja Leader”aktiviteti i parë - “funktionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2015 dhe Rrzh.</b>	<b>161,150</b>
<b>Totali</b>	<b>23,161,150</b>

Burimi: AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë)

Si çdo vit edhe për këtë vit pas kontrollave në teren nga AZHB, vazhdon edhe procesi i vlerësimit dhe refuzimit të aplikacioneve.

Bazuar në të dhënat e disponueshme për vitin 2016, numri i aplikacioneve të miratuara duke ju referuar buxhetit të ndarë për këtë vit është 483 aplikacione dhe vlera e miratuar për këto aplikacione shënon 22,503,405.98 €, ku përfshihen masat 101, 103, 302, 303 me nënmasat e tyre si dhe masa për ujitjen e tokave bujqësore.

**Tabela 111: Numri i aplikacioneve dhe vlera e miratuar në €, PZHR për vitin 2016**

Masat dhe nënmasat	Nr. i aplikacioneve të miratuara	Vlera e miratuar në €
<b>Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore</b>		
101.1 Sektori pemë drufrutore	54	2,738,403.82
101.1.1 Sektori i pemëve të imta (manore)	53	3,127,842.74
101.2 Sektori serra	61	3,122,356.05
101.2.1 Depo për ruajtje të perimeve	13	746,135.90
101.3 Sektori i mishit (trashja e viçave)	35	1,738,043.75
101.3.1 Sektori i mishit (rritja e brojlerëve)	10	567,870.60
101.4 Sektori i qumështit (lopët)	34	1,572,851.60
101.4.1 Sektori i qumështit (dele dhe dhi)	14	705,332.21
101.5 Sektori i rrushit	61	577,003.55
101.6 Sektori i vezëve	6	338,498.85
<b>Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore</b>		
103.1 Sektori i përpunimit të qumështit	4	706,551.10
103.2 Sektori i përpunimit të mishit	8	1,475,880.93
103.3 Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve	12	2,106,402.03
103.4 Sektori i përpunimit të verërave	3	372,948.00
<b>Masa: Ujitje e tokave bujqësore</b>	7	965,614.40
<b>Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve</b>		
302.1 Sektori, bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	56	641,960.35
302.2 Sektori përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	7	125,402.70
302.3 Sektori përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudha dhe qumështi i deleve, dhive)	11	216,998.20
302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	9	123,468.80
302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	14	453,990.40
<b>303 Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale-qasja Leader</b>		
303.2 Funkcionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2015 dhe Rrzh.	11	79,850.00
<b>Totali</b>	<b>483</b>	<b>22,503,405.98</b>

Burimi: AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë)

Vlera e aplikuar për masat dhe nënmasat ndryshon nga viti në vit, vlenë të ceket se këtë vit nënmasat kanë shënuar vlerë të aplikimit të përafërt me vitet e kaluara e në disa raste vlera ishte edhe më e ulët. Tabela në vijim tregon më shumë për vlerën e aplikuar të secilës nënmasë për periudhën 2012-2016.

**Tabela 112: Tabela krahasuese mbi vlerën e aplikuar për vitet 2012-2016**

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Nën Masat	Vlera e aplikuar €	Vlera e aplikuar €	Vlera e aplikuar €	Vlera e aplikuar €	Vlera e aplikuar €
Sektori i serrave-perime në ambient të hapur	4,271,212.41	18,686,220.78	11,857,967.73	35,983,748.23	20,356,073.20
Depo për ruajtje të perimeve					2,536,919.58
Sektori pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull, vishnje)	5,849,077.48	7,439,019.20	6,274,381.00	9,872,955.18	6,970,694.98
Sektori vreshtari-rrushit	802,066.77	719,912.67	842,474.00	1,755,181.50	1,413,465.71
Sektori pemë të imëta (dredhëz mjedër, manaferr, boronicë)	711,727.14	3,158,275.12	2,926,206.80	14,319,799.00	24,047,050.90
Sektori i vezëve	1,041,892.80	2,301,024.60	1,036,950.00	2,844,626.76	1,831,242.40
Sektori i qumështit (lopë qumështore)	7,762,296.70	19,998,425.66	9,300,574.00	17,939,989.91	14,084,277.62
Sektori i qumështit (dele dhe dhi)					3,024,572.69
Sektori i mishit-viça për majmëri		3,853,403.38	8,218,692.77	26,423,145.87	15,219,485.03
Sektori i mishit-brojler					4,901,501.91
Sektori i drithërave			3,147,193.00		
GLV-të	181,685.64	835,849.70		83,520.00	83,790.00
Sektori i pemëve-Infr.pemishtë	1,914,257.74	855,851.39			
Pilot masa-zonat më pak të zhvilluara		3,021,820.34			
Bletari (302.1)		3,011,201.23	1,457,313.00	4,419,184.41	4,341,415.48
Përpunim i barishtave, fruta mali, kërpudha (302.2)		838,235.25	289,577.00	512,471.67	513,690.20
Përpunim në fermë (302.3)				3,114,905.61	507,927.97
Artizanate (302.4)					429,025.95
Zhvillim rural (302.5)					1,799,801.81
Mekanizem bujqësor		15,969,766.20			
Ujitja e tokave bujqësore		3,742,695.86	1,599,851.00	2,895,028.33	2,285,771.19
Përpunimi dhe marketingu (103)		20,503,366.58	15,695,756.00	26,936,648.22	4,505,745.63
Përpunimi i qumështit					9,665,863.71
Përpunimi i mishit					14,890,799.06
Përpunimi pemëve dhe perimeve					1,366,606.00
Përpunimi i verës					
<b>Total</b>	<b>22,534,216.68</b>	<b>104,935,067.96</b>	<b>62,646,936.30</b>	<b>147,101,204.69</b>	<b>134,775,721.02</b>

Burimi: AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë)

#### 5.4.1 Ristrukturimi i potencialit fizik

Bujqësia në vendin tonë rradhitet ndër sektorët më të rëndësishëm, e cila ofron mundësi punësimi dhe gjenerim të të ardhurave, andaj edhe përkrahja në kuadër të këtij sektori është duke u realizuar në përshtatshmëri me buxhetin e ofruar.

Në Kosovë aktualisht një pjesë shumë e vogël e fermave mund të konkurojë në tregjet e jashtëme. Shkak për këtë janë përmasat e vogla të shumicës së bizneseve bujqësore, fragmentimi i tokës së tyre, ndërtesat dhe pajisjet e vjetra, mungesa e mjeteve financiare për investime, niveli i ulët i njohurive lidhur me teknologjinë bashkëkohore të prodhimit dhe mos përbushja e standardeve të BE-së tek shumica prej tyre.

Bazuar në faktin se shumica e prodhimeve konsumohet drejtpërdrejt nga familja në fermë, lind nevoja për përkrahje të investimeve në asetet fizike të fermave që kanë orientim komercial dhe janë në gjendje të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme.

Hartimi i masës “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore” vjen si nevojë e faktorëve të cekur më lartë, kjo masë e cila përfshinë sektorët si: sektorin e pemëve, sektorin e perimeve që përfshinë patatet, sektorin e qumështit dhe sektorin e mishit, sektorin e rrushit si dhe sektorin e vezëve.

Objektivat e përgjithshme në kuadër të masës 101 “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore” janë:

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë Kosovare dhe zëvendësimi i importit;
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- Përkrahja e bujqëve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së;
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

Ndër objektivat e veçanta të cilat duhet të përmbushen në kuadër të masës 101, për sektore të caktuara janë cekur në vijim.

Sektori i pemëve dhe sektori i perimeve përfshirë patatet:

- Rritja e prodhimit të pemëve dhe perimeve (përfshirë patatet), për qëllime komerciale;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern;
- Zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje për fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve bujqësore.

Sektori i qumështit dhe sektori i mishit:

- Rritja e prodhimit në fermat e specializuara;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;

- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik dhe mos-ndotjes së ujërave mbitokësore dhe nëntokësore;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre.

#### Sektori i rrushit:

- Rritja e prodhimit të rrushit të tryezës dhe rrushit të verës;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të fidanëve cilësor dhe mekanizimit modern;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre.

#### Sektori i vezëve:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre;

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për nënmasat në kuadër të masës 101, investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore. Vlera e aplikuar për këtë nënmasë ishte 94,385,233.97 €, ndërsa vlera e miratuar ishte 15,243,339.07 € kurse, totali i numrit të aplikacioneve të miratuara ishte 341 nga gjithsej 1,298 aplikacione.

**Tabela 113: Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për masën 101**

Masa 101	Nr. i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €
101.1 Sektori pemë drufrutore	96	6,970,694.98
101.1.1 Sektori i pemëve të imta (manore)	405	24,047,050.90
101.2 Sektori serra përfshirë patatet	250	20,356,073.20
101.2.1 Depo për ruajtje të perimeve	19	2,536,919.53
101.3 Sektori i mishit (trashja e viçave)	163	15,219,485.03
101.3.1 Sektori i mishit (rritja e brojlerëve)	43	4,901,501.91
101.4 Sektori i qumështit (lopët qumështore)	177	14,084,227.62
101.4.1 Sektori i qumështit (dele dhe dhi)	42	3,024,572.69
101.5 Sektori i rrushit	80	1,413,465.71
101.6 Sektori i vezëve	23	1,831,242.40
<b>Totali</b>	<b>1,298</b>	<b>94,385,233.97</b>

Burimi: AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë)

#### 5.4.2 Zhvillimi i sektorit të përpunimit

Për të qenë konkurrues në një treg gjithnjë e më të hapur, industria ushqimore duhet ende të punojë në modernizimin e teknologjive, rritjen e konkurrueshmërisë si dhe të ndikojë në zëvendësimin e importit të ushqimit me prodhime vendore të cilësisë së lartë dhe gjithashtu në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të sigurt. Industria ushqimore ka për detyrë të krijojë grumbullim të sigurt, transportim dhe deponim të lëndëve të para, zvogëlim të mbeturinave dhe të garantoj sigurinë e ushqimit.

Me qëllimi të përmbushjes së nevojave të cekura më lartë në industrinë agro-ushqimore MBPZHR, ka hartuar masën 103 “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore” e cila përkrahë investimet në industrinë e përpunimit të ushqimit në katër nënsektorë si: përpunim i qumështit dhe prodhimeve të qumështit, përpunim i mishit dhe prodhimeve të mishit, përpunim i frutave dhe perimeve si dhe prodhim të verës. Kjo masë është projektuar për ta plotësuar Masën 101, me synim të rritjes së furnizimit me produkte bujqësore të sigurt dhe pa ndikime negative në mjedis.

Objektivat e përgjithshme në kuadër të masës 103, investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore janë:

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë Kosovare dhe zëvendësimi i importit përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive dhe produkteve të reja;
- Përkrahja e ndërmarrjeve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve, mirëqenien e kafshëve dhe gjurmueshmërinë e zinxhirit të ushqimit dhe menaxhimin e mbeturinave;
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet zhvillimit të fermave;



- Forcimi i lidhjeve me prodhimin primar;
  - Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.
- Ndër objektivat e veçanta të cilat duhet të përmbushen në kuadër të masës 103, për sektore të caktuara janë cekur në vijim.

#### Përpunimi i qumështit:

- Implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e qumështit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- Modernizimi i linjave të përpunimit të qumështit dhe objekteve të tjera përcjellëse;
- Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e qumështit;
- Përmirësimi i marketingut të qumështit dhe prodhimeve të tij;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

#### Përpunimi i mishit:

- Implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e mishit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- Futja e linjave të reja të përpunimit të mishit;
- Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e mishit;
- Modernizimi i thertoreve duke përfshirë therjet e specializuara (për ripërtypësit e vegjël);
- Përmirësimi i marketingut të mishit dhe produkteve të mishit;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

#### Përpunimi i pemëve, perimeve dhe prodhimi i verës:

- Implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (higjiena, siguria ushqimore, cilësia, etj.);
- Përmirësimi i teknologjisë së përpunimit, si dhe modernizimi i objekteve të tjera përcjellëse (depot ruajtëse / ftohëse) duke futur pajisje/teknologji të reja;
- Diversifikimi i prodhimeve;
- Përmirësimi i marketingut;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

Sa i përket masës 103, nga totali i vlerës së aplikuar për këtë masë 29,062,408.40 € me rreth 84 aplikacione, janë miratuar gjithsej 27 aplikacione me vlerë 4,661,782.06 €, ku dominon sektori i pemëve dhe perimeve.

**Tabela 114: Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për masën 103**

Masa 103	Nr. i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €
103.1 Sektori i përpunimit të qumështit	13	4,505,745.63
103.2 Sektori i përpunimit të mishit	27	9,665,863.71
103.3 Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve	38	14,890,799.06
103.4 Sektori i përpunimit të verërave	6	1,366,606.00
<b>Totali</b>	<b>84</b>	<b>29,062,408.40</b>

Burimi: AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë)

## 5.5 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

### 5.5.1 Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore në MBPZHR, ka vazhduar edhe këtë vit me bashkërendimin e aktiviteteve në nivel qendror dhe lokal duke përkrahur dhe ofruar këshilla dhe trajnime në këta sektor:

- Prodhimtari bimore dhe blegtorale
- Agro-përpunimi
- Mbrojtje të mjedisit
- Tema trajnuese nga pylltaria
- Çështje ekonomike dhe mbajtjen e shënimeve në ferma
- Çështje ligjore, punë të rrezikshme në bujqësi për moshat nën 18 vjeç
- Broshura, mesazhe dhe video incizime për praktikën e mira bujqësore
- Vizita studimore brenda dhe jashtë vendit
- Marrje e mostrave të tokës, etj.

Aktivitetet e zhvilluara në Qendrat Këshilluese Informative (QKI) komunale të shërbimeve këshillimore, janë organizuar për të përkrahur fermerët me këshilla teknike në sektorët e blegtorisë, bletarisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë.

Gjithsej, 5,248 fermer janë përkrahur me këshilla teknike, 518 fermer janë përkrahur me përgatitjen e projekteve për grante ndërsa, numri i aplikacioneve të pranuar nga qendrat këshilluese informative për subvencione në bujqësi ishte 26,662.

Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike ka zbatuar tri projekte në kuadër të shërbimeve këshilluese, si:

“Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshilluese”, i cili financohet nga buxheti i Kosovës;

“Ndihmë në forcimin e Shërbimeve Këshillimore të MBPZHR-së dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve teknike të ofruara nga laboratorët e MBPZHR-së”, i financuar nga Bashkimi Evropian si dhe

“Projekti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural”, komponenta e parë: “Transferimi i njohurive në sektorin agro-rural” të financuar përmes kredisë së marrë nga MBPZHR-ja, në Bankën Botërore.

Në kuadër të projektit “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshilluese”, janë organizuar 400 këshillime me tema të ndryshme, duke përfshirë 34 komuna ku kanë përfituar 5,516 fermerë.

**Tabela 115: Numri i pjesëmarrësve në trajnime**

Sektori	Temat	Nr. i këshillave	Nr. i pjesëmarrësve
Blegtori dhe veterinar	11	120	1,387
Pemëtari dhe vreshtari	4	30	411
Perimkulturë dhe lavërtari	5	30	318
Mbrojtje e bimëve	6	28	288
Ujitje	1	20	222
Agropërpunim	2	37	406
Mbrojtje të ambientit	2	28	343
Punët e rrezikshme në bujqësi për fëmijët nën 18 vjet	2	20	436
Pylltari	4	18	177
Bletari	4	36	933
Agroekonomi	2	33	595

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Projekti për “Ndihmë në forcimin e Shërbimeve Këshilluese të MBPZHR-së dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve teknike të ofruara nga laboratorët e MBPZHR-së” ka për qëllim përkrahjen e MBPZHR-së në krijimin e sistemit operativ këshillëdhënës të Kosovës për bujqësi dhe zhvillim rural. Në kuadër të këtij projekti janë zyrtarizuar sipas ligjit, 31 qendra këshilluese informative në komuna dhe po punohet në hapjen edhe të 3 qendrave në komunat tjera të mbetura. Janë organizuar trajnime për certifikimin e këshilltarëve privat, ku nga 133 të cilët kanë aplikuar janë përzgjedhur 106 në bazë të kriterëve të kërkuara, është mbajtur trajnim 10 ditor më 5 module për këshilltarët privat të cilët janë pajisur edhe me certifikata mbi modulet e përfunduara.

Projekti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural” – Komponenti e parë: “Transferimi i njohurive në sektorin agro-rural”, ky projekt përfshinë 3 fusha:

Trajnimin e aplikuesve potencial për aplikim në programin e granteve, në kuadër të kësaj fushe janë trajnuar me këshilla individuale 931 fermer, nga të cilët 182 femra dhe 749 meshkuj.

**Tabela 116: Numri i fermerve të trajnuar sipas gjinisë**

Nr. i Komunave	Nr. i fermerve të trajnuar	Pjesëmarrësit sipas gjinisë	
		Femra	Meshkuj
34	931	182	749

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

**Trajnimit e trajnerëve për të mbështetur procesin e aplikimit për grante**, objektivi i kësaj fushe ishte trajnimi i zyrtarëve të MBPZHR-së, komunave, Grupeve Lokale të Veprimit (GLV), OJQ-ve dhe ofruesve privat. Janë zhvilluar 65 ditë trajnime, ku kanë marrë pjesë 85 pjesëmarrës të cilët janë nënshtruar testit final dhe janë pajisur me certifikata.

Modulët e trajnimit janë zhvilluar për këto tema:

- Investimet në fermë, prodhimtaria blegtorale
- Investimet në fermë, prodhimi i frutave dhe perimeve
- Investimet në agro-përpunim
- Investimet në marketingun bujqësorë
- Investimet në diversifikimin e ekonomive rurale
- Studimet e fizibilitetit dhe biznes planet (3 ditë)
- Financimi i investimeve dhe kreditë komerciale
- Aplikimi për grante
- Aftësitë e komunikimit
- Kriteret e modernizimit të konsulentëve, dhe
- Testi final i trajnimit

**Trajnimit për përmirësimin e efikasitetit të Stafit të Ekstensionit (Metodologjia e Ekstensionit)**, qëllimi i kësaj fushe ka qenë trajnimi i stafit të ekstensionit të MBPZHR-së, këshilltarëve komunal për bujqësi dhe zhvillim rural dhe personelit privat të ekstensionit. Në trajnime kanë marrë pjesë 82 pjesëmarrës (nga të cilët 17 femra) dhe janë zhvilluar këto module:

- Prodhimtaria Primare dhe Prodhimtaria Blegtorale
- Planifikimi, Menaxhimi dhe Analiza e Fermës
- Pas të Korrat dhe Marketingu Bujqësor
- Agro - Përpunimi dhe Diversifikimi Rural, dhe
- Transporti i Prodhimit Bujqësor dhe Tregtia Bujqësore.

## 5.5.2 Grupet lokale të veprimit

Grupet Lokale të Veprimit (GLV), u themeluan me financim nga BE-ja, që përbëhen nga 25 anëtarë, me një pjesëmarrje 50:50 të organizatave ose personave publik dhe privat, në përbërjen e anëtarëve të këshillit 30%, duhet të jenë femra. Krahas GLV-ve, është themeluar edhe Rrjeti për Zhvillim Rural të Kosovës (RrZhRK), në mënyrë që të kontribuoj në zhvillimin më të mirë ekonomik të viseve rurale, si dhe të shërbej si platformë në ofrimin e asistencës teknike dhe shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet GLV-ve, këto dy grupe së bashku me DPZHR/AM, AZHB, OJQ të ndryshme dhe ekspertët privat, kanë bërë përgatitjen e masës 303 me nën masat e saj 303.1 dhe 303.2.

Buxheti i alokuar për nën-masat për vitin 2016 është 161,150 €

Nën-masa 303.2. "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale" përfshinë dy aktivitete:

-Aktiviteti i parë është funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre.

-Aktiviteti i dytë është zbatimi i SZHL të GLV-t përzgjedhura ku promovojnë dhe zbatojnë projekte të vogla në përputhje me SZHL, si dhe nënmasa 303.1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të territorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura".

**Tabela 117: Fondet e planifikuara për zbatimin e nën masave për vitin 2016**

Nën-masat	Buxheti në %	Buxheti në €
303.1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të territorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura"		
Për komunat prej 10,000 - 50,000 banor deri në 5,000 €	56	89,000
Për komunat prej 50,000 - 90,000 banor deri në 7,000 €		
Për komunat prej 90,000 - 150,000 banor deri në 9,000 €		
Për Rrjetin e Zhvillimit Rural 7,000 €		
303.2. Nënmasa "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale" - Aktiviteti 1 dhe Aktiviteti 2	44	71,250
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>161,150</b>

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Që nga funksionalizimi i zyrës operative RrZhRK ka zhvilluar disa aktivitete të cilat kanë për qëllim identifikimin e nevojave të GLV-ve, përcaktimin dhe përgatitjen e projekteve të cilat kanë mbuluar kryesisht zonat rurale dhe janë implementuar disa projekte të anëtarëve të GLV-ve, ku rrjeti ka mbajtur përgjegjësin e organizimit të sesioneve informuese, e në disa raste rrjeti i ka mbështetur edhe për organizime të përbashkëta të panairove.

RrZhRK dhe GLV-të kanë koordinuar takime dhe aktivitete të ndryshme me MBPZhR-në dhe me donatorët siç janë GIZ, ADA Austriake, FAO, USAID dhe KE, ku në bazë të prioriteteve dhe projekteve të identifikuar anëtarët e GLV-ve, janë mbështetur me dokumentet e nevojshme në mënyrë që të sensibilizohen dhe të promovohen projektet e tyre.

Gjatë vitit 2016, zyrat operative të GLV-ve, kanë kryer një seri aktivitetesh, të cilat do ti përshkruajmë më poshtë:

Grupi Lokal i Veprimit “Gjeravica” së bashku me Komunën e Deçanit janë përfitues të projektit “Valorizimi i Produkteve Eko në Zonat Ndërkufitare” me vlerë 189,829.50 €, në kuadër të programit ndërkufitar me Malin e Zi, i cili financohet dhe menaxhohet nga zyra e BE-së në Kosovë.

Grupi Lokal i Veprimit “GLV Vitia” në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Organizatën "IKC" dhe Organizatën Helvetas me projektin "Aftësitë për Punësim Rural (APR)" kanë mbajtur edicionin e gjashtë të Panairit “Ti ruajmë vlerat tona tradicionale”.

Në kuadër të projektit me organizatën Helvetas/APR dhe në bashkëpunim me komunën e Vitisë, komunitetit të kësaj komune i kanë ofruar trajnime në fushat e bletarisë, blegtorisë dhe përpunimit të qumështit, pemëtarisë dhe frutave të imëta, produkteve pyjore jo drusore, kultivimit të perimeve dhe kultivimit në serra, drunjëve dekorativ, produkteve shtëpiake, përgatitjes së planeve të biznesit dhe projekt propozimeve, etj.

Rrjeti gjithashtu ka bashkëpunime të vazhdueshme me donatorin GIZ me projektin “Konkurrueshmëria e sektorit privat në zonat rurale” (COSiRA), si dhe me organizatën Helvetas/S4RE për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të GLV-ve, si dhe në bazë të nevojave të komunave zhvillimin e zonave rurale.

RrZhRK në bashkëpunim me MBPZHR ka organizuar “Trajnimin e trajnerëve për mbështetje të procesit të aplikimit për grante”, që është kredi nga Banka Botërore për MBPZHR-në i cili implementohet nga konsorciumi P.A.N.G.E.A nga Roma (Itali), CIHEAM nga Bari (Itali) dhe ESG nga Prishtina (Kosovë). Ky projekt menaxhohet nga Projekti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe në vete ka 12 module për trajnim.

### **5.5.3 Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor**

Shërbimi Këshillimor vazhdon ti jep rëndësi të veçantë promovimit përmes webfaqes e cila është në funksion nga Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, ku ofron shërbime, të dhëna statistikore dhe këshilla nga të gjitha fushat.

Shpërndarja e mesazheve për fermerët, janë përfunduar fushat provuese për grurë në 7 komuna (Drenas, Lipjan, Pejë, Gjakovë, Istog, Ferizaj dhe Gjilan), si dhe janë përgatitur 12 video incizime për shërbimet këshilluese duke përfshirë praktikën më të mira bujqësore dhe janë postuar në webfaqe për shërbim të fermerëve.

Janë përgatitur edhe 5 fletëpalosje për fermerë:

- Mbajtja e shënimeve në fermë
- Higjiena në përmirësimin e kualitetit të qumështit

- Teknikat e mbjelljes së fidanëve
- Zhvillimi i biznesit rural dhe aktivitete alternative në zonat rurale
- Roli dhe rëndësia e grupeve lokale të veprimit

Janë organizuar vizita të ndryshme për fermer brenda Kosovës, në shtetet e regjionit si dhe në shtetet e BE-së, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve dhe ngritjes së kapaciteteve.

Gjatë vitit 2016, janë realizuar 2 vizita studimore me prodhuesit dhe agro-përpunuesit (aplikues për grante në bujqësi ), në Republikën e Maqedonisë dhe në Itali.

Përfitues në këto vizita studimore janë 28 prodhues dhe përpunues nga komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Po ashtu DSHKT, ka pajisur këshilltarët komunal për bujqësi dhe zhvillim rural me pajisje që të jenë më kompetent në teren gjatë kryerjes së punëve të tyre dhe në mbështetje të fermerëve me këshilla, pajisjet me të cilat janë furnizuar këshilltarët janë si më poshtë:

- EC metër (për matjen e kripëzimit)
- pH metër (për matjen e pH në tokë)
- pH metër (për matjen e pH në ujë)
- Termo / Hygro metër
- Refraktometër (për matjen e sheqerit në frytë)
- Penetrometër (testi i fortësisë së fryteve)
- Zmadhues – lipë (thjerrëz për zmadhim)
- Sonda për marrjen e mostrave të dheut

#### **5.5.4 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve**

Zonat rurale kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e vendit dhe paraqesin një potencial të madh për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, për krijimin e vendeve të punës si dhe krijimin e të hyrave shtesë.

Masa 302 “Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve” ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës dhe ruajtjen e atyre ekzistuese. Përkrahja e aktiviteteve të reja ekonomike duhet të shpijë në uljen e varfërisë në zonat rurale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Objektivat e përgjithshme në kuadër të masës 302, diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve janë:

- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre nëpërmjet diversifikimit;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për parandalimin e shpërnguljes së popullatës së zonave rurale dhe zonave malore;

- Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale;

Si objektiva të veçanta të cilat duhet të përmbushen me qëllim të realizimit të kësaj mase janë:

- Rritja e të ardhurave të popullatës në zona rurale;
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla, duke u bazuar në burimet lokale;
- Ruajtja dhe zhvillimi i aktiviteteve artizanale tradicionale;
- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural.

Sa i përket masës 302, e cila përmban 5 nënmasa apo sektorë, vlera e aplikuar për gjithsej 303 aplikacione për vitin 2016, ishte 7,591,861.41 €, ndërsa, vlera e miratuar ishte 1,561,820.45 € duke përfshirë gjithsej 97 aplikacione.

**Tabela 118: Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për masën 302**

Masa 302	Nr. i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €
302.1 Sektori, bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	211	4,341,415.48
302.2 Sektori përpunimit të barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	20	513,690.20
302.3 Sektori përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kerpudha dhe qumështi i deleve, dhive)	17	507,927.97
302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	18	429,025.95
302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	37	1,799,801.81
<b>Totali</b>	<b>303</b>	<b>7,591,861.41</b>

Burimi: AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë)

### 5.5.5 Ujitja e tokave bujqësore

Pasi që të reshurat mungojnë gjatë stinës së verës, ndërsa në stinët e tjera të reshurat janë të mjaftueshme, imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore. Pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes nuk mund të arrihet zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme.

Si objektiva të përgjithshme për masën ujitja e tokave bujqësore janë:

- Rritja e produktivitetit të prodhimeve bujqësore;
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore;

Objektivat të veçanta për realizimin e kësaj mase janë:

- Modernizimi i sistemit për ujitje dhe kullim, duke zvogëluar humbjet në sasinë e ujit të përdorur, dhe



- Përmirësimi i lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes.

Masa për ujitjen e tokave bujqësore për vitin 2016, numëron gjithsej 7 aplikacione të miratuara me vlerë 965,614.40 €.

## **5.6 Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare**

Eksporti vazhdon të jetë një nga nxitësit kryesorë të rritjes së vendeve të punës në bujqësinë dhe industrinë ushqimore në Kosovë. Reformat e Politikës së Përbashkët Bujqësore gjatë dekadës së fundit, kanë nxitur sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore të vendit në përmirësimin e orientimit të tij drejt tregjeve Evropiane dhe vendeve të tjera jashtë BE-së, duke u bërë kështu konkurrues me vendet e regjionit e më gjërë. Gjatë kësaj periudhe, sektori agro-ushqimor i prodhuesve Kosovarë ka përfituar gjithashtu nga zgjerimi i zinxhirit të vlerës duke bërë që disa nga ta të jenë edhe fitues të medaljeve për kualitet të produktit.

Si rezultat i kësaj, vlera e eksportit të produkteve agro-ushqimore është dyfishuar dhe Kosova dalëngadalë ka siguruar pozitën e një furnizuesi konkurrues në disa nivele të zinxhirit të vlerave të produkteve bujqësore.

Në mesin e produkteve ushqimore, prodhuesit Kosovarë eksportojnë por në sasi ende shumë të vogël këto produkte:

Frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve apo të pjeprave; Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tjera të bimëve; Pijet, alkoolet dhe uthullat; Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; Kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; Bimët industriale apo medicinale; Birrë e bërë nga malti; Miell prej grurit të fortë; Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëltuese apo aromatizuese shtesë; kafe, çaj, mate dhe erëza.

Siç shihet, në kapitullin 4.2 shkëmbimi tregtar për produkte bujqësore në Kosovë paraqitet me bilanc tregtar negativ, përkundër masave të ndërmarra dhe rritjes së eksportit. Vendi ynë nga periudha e pasluftës është karakterizuar me import të lartë dhe eksport shumë të ulët.

Varshmëria e madhe për produktet bujqësore nga importi vlerësohet se ka potencial të zvogëlohet, pasi që 80 % e produkteve mund të prodhohen në vendin tonë, me këtë rast edhe mundësitë për eksport mund të rriten. Ky fakt mbështetet në studime dhe vlerësime të ndryshme që janë bërë në sektorin e bujqësisë dhe gjithashtu në kapacitetet dhe teknologjinë bashkohore në industrinë e përpunimit të ushqimit.

Politikat tregtare tradicionale që kanë të bëjnë me zbatimin e tarifave, kuotave, apo subvencionim të eksportit etj., tani nuk shihen si opsion për një zhvillim të qëndrueshëm të prodhimit dhe të tregtisë potenciale. Në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm të politikave të tregtisë ndërkombëtare bujqësore, edhe politikat tregtare të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe Ministrisë së Bujqësisë shkojnë drejtë një

integrimi sistematik të bujqësisë të orientuar drejt sistemit tregtar të tregut botëror. Me integrimin e bujqësisë në OBT - marrëveshje në Marrakesh në 1994, mekanizmat e mbështetjes janë shkëputur nga produktet e tregtuara dhe opsionale të ri-shoqëruara për mbështetjen e eko-sistemit-shërbimeve, zhvillimin rural dhe të tjera. Diçka që paraqitet dukshëm në politikën tregtare sot është zgjidhja e mosmarrëveshjeve tregtare, mundësia e masave kundërbalancuese në rastet anti-dumping, dhe promovimin e tregtisë në përgjithësi. Gjithashtu, në qendër të diskutimit të politikave të tregtisë tani janë Licencimi dhe pranimi i ndërsjellët i standardeve fitosanitare dhe standardeve të tjera teknike.

Regjimet aktuale të tregtisë mbulojnë:

- Parimi i Tarifave ngritur mbi importet arrin në 10%. Prapë, kjo ka të bëjë vetëm me 26% e të gjitha importeve bujqësore në vitin 2013, pasi që importet nga vendet e BE-së dhe të CEFTA-s janë përjashtuar me marrëveshjet përkatëse.
- Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në, duke hapur mundësi për tregti me vendet e BE-së në përputhje me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.
- CEFTA: Në vitin 2006 me marrëveshjet e ndryshme bilaterale të tregtisë u transferuan në një marrëveshje të përbashkët.
- Një Marrëveshje e tregtisë së lirë me Turqinë, e nënshkruar në vitin 2013, duke çuar në tregtinë e lirë dhe zhdukjen graduale të tarifave për të gjitha produktet industriale dhe 846 pozita të tarifave të produkteve bujqësore gjatë një periudhe prej dhjetë vitesh.
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Ministria e Tregtisë janë të përkushtuara në aktivitetet:
- Përmirësimi i disponueshmërisë së të dhënave dhe analiza e rrjedhjes së tregtisë për një monitorim më të mirë të zhvillimeve të tregut.
- Themelimi dhe mbështetja e komisioneve të veçanta ndërministrorë që kanë të bëjnë me aspektet e prodhimit bujqësor dhe të tregtisë.
- Mbështetja e konkurrencës ndërkombëtare të industrive bujqësore dhe përpunuese përmes masave të lidhura me tregtinë siç janë fuqizimi i emrave të markave, etiketimi, përmirësimi i masave sanitare, fitosanitare dhe veterinare.
- Monitorimi dhe sigurimi i mbështetjes në rastet e masave antidumping.
- Mbështetja e regjistrimit të përmirësuar të tregtisë dhe kapaciteteve të administrimit (p.sh. Udhëzimet Ndërkombëtare të Tregtisë për Kosovën)

Baza Legjislative:

- Ligji për Tregtinë e Jashtme Nr.04 / L-048
- Ligji për Tregtinë e Brendshme Nr.04 / L-005
- Ligji për Masat Mbrojtëse të importit Nr 4-L / 047
- Ligji për masat antidumping dhe kundërbalancuese Nr. 03-L / 097
- Ligji për markat tregtare Nr 02-L / 54

- Ligji i ri për TVSH Nr. 05/L-037
- Ligji Nr. 04-L/163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Regjimi tatimor në Kosovë

Kosova ka të zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të BE-së në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përshtatshëm me atë të BE-së.

Ndërtimi i sistemit tonë është duke u mbështetur në zhvillimin ekonomik sipas konceptit të:

- Ekonomisë së tregut të lirë,
- Parimeve të shtetit ligjor dhe
- Liberalizimit të tregut.

Sa i përket sektorit të bujqësisë politikat fiskale janë një ndër instrumentet kryesore politike të cilat kanë ndikuar direkt në zhvillimin e sektorit dhe avancimin e sektorit.

Rregulloret të cilat kanë ndihmuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë përmes aplikimit të këtyre politikave fiskale për lirimin nga dogana dhe lirimin nga TVSH për të gjitha agroinputet bujqësore përjashtuar insekticidet. Rregulloret Nr. 2004/13, Nr. 2004/35, Nr 2006/4, Nr.2007/12 dhe Nr 2007/31.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04-L/163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor është shfuqizuar rregullorja Nr. 2007/31.

Udhëzimi Administrativ Nr 05/2013 për Aplikimin e Normës së Sheshtë të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për Prodhuesit Bujqësor është një nga bazat ligjore të politikave tregtare bujqësore të Kosovës me qëllim të lehtësimit të tregut për prodhime bujqësore.

Objektivi final i politikave tregtare bujqësore të Kosovës është në linjë me politikën e saj të përgjithshme bujqësore: përdorim optimal i potencialit të prodhimit bujqësor, duke siguruar punësim dhe të ardhura, ndërsa në të njëjtën kohë duke e lejuar një shumëllojshmëri të gjerë të ushqimit të shëndetshëm dhe të përbalueshëm për konsumatorët. Konkretisht e gjithë kjo orienton drejt harmonizimit me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së (CAP) dhe anëtarësimin e plotë në OBT.

Harmonizimi i politikave tregtare me PPB sipas rregulloreve:

EC.No. 1305/2013 ..... zhvillimi rural

EC.No. 1306/2013 ..... financimi i PPB

EC. No. 1307/2013 ..... pagesat direkte

EC. No 1308/2013 ..... Organizimi i tregut të përbashkët ( masat tregtare).

Hapat e ardhshën në harmonizimin e PPB:

- anëtarësimi në OBT (MTI është në fazën e përgatitjes për aplikim)
- zbatimi i standardeve të sigurisë dhe cilësisë së produktit, (global g.a.p, haccap, iso, etj).
- krijimi i lehtësirave procedurale për regjistrim, licencim dhe certifikim të kompanive bujqësore,
- hartimi i legjislacionit nacional për organizimin e tregut për produkte bujqësore

Vlerësohet se “Pako fiskale 1” ka dhënë rezultate dhe sot kemi më shumë prodhime vendore në treg. Si rezultat i kësaj reforme është rritur qarkullimi i bizneseve vendore. Hartimi i “Pako fiskale 2” pritet së shpejti të jetë në funksion të zhvillimit të sektorit të bujqësisë, posaçërisht të sektorit të prodhimit, duke i liruar nga taksat doganore inputet që përdoren në prodhim, me qëllim që të nxisim rritjen e prodhimit vendor dhe uljen e varësisë nga importet.

## **6 Shtojcat**

### **6.1 Lista e ligjeve dhe akteve ligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural**

#### **6.1.1 Legjislacioni kombëtar në fuqi**

Ligji Nr. 04/L-253 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 32/15 Maj 2014)

#### **6.1.2 Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2016**

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 01/2016 për Kompensimin Financiar për Shërbimet Veterinare në Teren, dt. 14.01.2016

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) NR. 02/2016 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2016 të dt. 01.03.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) NR. 03/2016 për Pagesa Direkte në Bujqësi për Vitin 2016, të dt. 17.03.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 04/2016 për Licencimin e Prodhuesve dhe Ripaketuesve të Plehrave Artificiale, të dt. 14.06.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 05/2016 të dt. 04.07.2016 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 01/2016 Për Kompensimin Financiar për Shërbimet Veterinare në Teren.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) NR. 06/2016 për Substancat Aktive Farmakologjike dhe Klasifikimi i Tyre Lidhur me Limitin Maksimal të Mbetjeve në Produkte Ushqimore me Prejardhje Shtazore të dt. 02.08.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) NR. 07/2016 për ndalimin e përdorimit të substancave të caktuara në blegtori që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe beta-agonistëve, të dt. 16.09.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-NR. 08/2016 të dt. 16.09.2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - NR. 02/2016 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2016 të dt. 01.03.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 09/2016 të dt. 16.09.2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - NR. 03/2016 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2016 të dt. 17.03.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 10/2016 Kriteret për Mbështetje të Strategjive Zhvillimore Lokale – Qasja Leader për Vitin 2016 të dt. 26.10.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-NR. 11/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-NR. 02/2016 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2016 të dt. 10.11.2016

Udhëzimi Administrativ (MBPZHR)-NR. 12/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR. 07/2011 për Regjistrin e Fermerëve, të dt. 12.12.2016.

Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-NR. 13/2016 për performancën e metodave analitike dhe interpretimin e rezultateve, dt. 15.12.2016.

## 6.2 Statistikat mbi çmimet

**Tabela 119: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2010, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.19	0.18	-0.01	-5
Misri	0.22	0.13	-0.09	-41
Patate	0.29	0.21	-0.08	-28
Lakra	0.18	0.16	-0.02	-11
Speca	0.59	1.46	0.87	147
Fasulje	1.80	0.74	-1.06	-59
Domate	0.62	0.38	-0.24	-39
Molla	0.49	0.21	-0.28	-57
Rrush	0.80	0.56	-0.24	-30
Pula (ferme)	1.94	1.19	-0.75	-39
Qumësht	0.29	0.68	0.39	134
Mjaltë	7.42	3.82	-3.6	-49
Veze*	2.13	1.44	-0.69	-32

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; njësia 30 copë

**Tabela 120: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2011, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.25	0.26	0.01	4
Misri	0.29	0.20	-0.09	-31
Patate	0.30	0.26	-0.04	-13
Lakra	0.17	0.29	0.12	71
Speca	0.58	0.28	-0.3	-52
Fasulje	1.95	0.87	-1.08	-55
Domate	0.50	0.32	-0.18	-36
Molla	0.49	0.28	-0.21	-43
Rrush	0.93	0.73	-0.2	-22
Pula (ferme)	2.12	1.46	-0.66	-31
Qumësht	0.31	0.68	0.37	119
Mjaltë	8.11	4.39	-3.72	-46
Veze*	2.51	2.50	-0.01	0

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; \*njësia 30 copë

**Tabela 121: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2012, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.26	0.33	0.07	27
Misri	0.30	0.35	0.05	17
Patate	0.32	0.22	-0.1	-31
Lakra	0.24	0.07	-0.17	-71
Speca	0.58	0.36	-0.22	-38
Fasulje	2.47	1.02	-1.45	-59
Domate	0.71	0.29	-0.42	-59
Molla	0.54	0.71	0.17	31
Rrush	0.93	1.01	0.08	9
Pula (ferme)	2.12	1.92	-0.2	-9
Qumësht	0.32	0.65	0.33	103
Mjaltë	8.52	4.81	-3.71	-44
Veze*	2.91	1.53	-1.38	-47

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; njësia 30 copë

**Tabela 122: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2013, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.22	0.20	-0.02	-9
Misri	0.31	0.21	-0.1	-32
Patate	0.43	0.24	-0.19	-44
Lakra	0.17	0.19	0.02	12
Speca	0.78	0.78	0	0
Fasulje	2.63	0.87	-1.76	-67
Domate	0.56	0.23	-0.33	-59
Molla	0.53	0.35	-0.18	-34
Rrush	0.85	0.46	-0.39	-46
Pula (ferme)	2.27	1.16	-1.11	-49
Qumësht	0.33	0.61	0.28	85
Mjaltë	8.83	4.71	-4.12	-47
Veçë*	2.69	2.72	0.03	1

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; njësia 30 copë

**Tabela 123: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2014, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.20	0.20	0.00	0
Misri	0.28	0.21	-0.07	-25
Patate	0.34	0.30	-0.04	-12
Lakra	0.19	0.19	0.00	0
Speca	0.68	0.42	-0.26	-38
Fasulje	2.92	1.14	-1.8	-61
Domate	0.68	0.31	-0.37	-54
Molla	0.55	0.29	-0.26	-47
Rrush	1.02	0.55	-0.47	-46
Pula (ferme)	2.33	1.20	-1.13	-48
Qumësht	0.33	0.62	0.29	88
Mjaltë	9.00	5.02	-3.98	-44
Veçë*	2.78	1.22	-1.56	-56

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; njësia 30 copë

**Tabela 124: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2015, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.19	0.18	-0.01	-5
Misri	0.23	0.17	-0.06	-26
Patate	0.33	0.30	-0.03	-9
Lakra	0.23	0.19	-0.04	-17
Speca	0.81	0.47	-0.34	-42
Fasulje	2.68	1.17	-1.51	-56
Domate	0.54	0.36	-0.18	-33
Molla	0.48	0.33	-0.15	-31
Rrush	0.91	0.44	-0.47	-52
Pula (ferme)	2.06	1.56	-0.5	-24
Qumësht	0.30	0.60	0.3	100
Mjaltë	9.77	4.99	-4.78	-49
Veçë*	2.23	1.42	-0.81	-36

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; njësia 30 copë



**Tabela 125: Çmimet në zinxhirin e vlerës 2016, €/kg**

Produktet	Çmimi vendor	Çmimi i importit	Ndryshimi (€)	Ndryshimi (%)
Gruri	0.17	0.16	-0.01	-4
Misri	0.24	0.18	-0.06	-23
Patate	0.32	0.32	0.00	1
Lakra	0.21	0.23	0.02	8
Speca	0.67	0.39	-0.28	-42
Fasulje	2.46	0.91	-1.55	-63
Domate	0.60	0.34	-0.26	-44
Molla	0.49	0.32	-0.17	-34
Rrush	0.84	0.52	-0.32	-38
Pula (ferme)	2.04	0.96	-1.08	-53
Qumësht	0.30	0.58	0.28	92
Mjaltë	9.87	5.47	-4.40	-45
Veze*	2.40	1.36	-1.04	-43

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; \*njësia 30 copë

### 6.3 Statistikat krahasuese

**Tabela 126: Popullsia në vendet kandidate dhe ato kandidate potenciale sipas viteve**

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Shqipëria</b>	.	2,831,741	.	2,898,782	2,895,947	2,892,303	2,886,026
<b>B. Hercegovina</b>	3,844,046	3,843,183	3,839,265	3,835,645	3,830,911	.	.
<b>U.Europian (28 vendet)</b>	503,170,618	502,964,837	504,060,345	505,166,839	506,944,075	508,293,358	510,056,011
<b>Mali i Zi</b>	619,001	619,850	620,308	620,893	621,521	622,099	622,218
<b>IRJ e Maqedonisë</b>	2,052,722	2,057,284	2,059,794	2,062,294	2,065,769	2,069,172	2,071,278
<b>Serbia</b>	7,306,677	7,251,549	7,216,649	7,181,505	7,146,759	7,114,393	7,076,372
<b>Turqia</b>	72,561,312	73,722,988	74,724,269	75,627,384	76,667,864	77,695,904	78,741,053
<b>Kosova</b>	2,208,107	1,794,180	1,798,645	1,815,605	1,820,631	1,804,944	1,771,604

Burimi: ASK

**Tabela 127: Numri i vizitorëve të jashtëm në regjionet e Kosovës sipas regjionet**

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjakovë	646	646	734	647	739	547	1,003	1,267	2,345
Gjilan	937	937	779	755	886	737	794	712	1,109
Mitrovicë	546	546	827	4,458	557	616	532	385	646
Pejë	3,763	3,763	3,152	260	2,588	1,326	5,761	12,694	12,649
Prizren	2,412	2,412	2,334	20,832	2,695	3,799	3,520	9,779	9,101
Prishtinë	26,781	26,781	25,428	1,635	37,897	42,083	49,041	53,057	56,291
Ferizaj	1,233	1,233	1,128	1,762	3,428	966	662	1,344	1,569
<b>Gjithsej</b>	<b>36,318</b>	<b>36,318</b>	<b>34,382</b>	<b>30,349</b>	<b>48,790</b>	<b>50,074</b>	<b>61,313</b>	<b>79,238</b>	<b>83,710</b>

Burimi: Agjencia e Statistikës së Kosovës: Turizmi dhe hoteleria